

**PËRMBLEDHJE E  
VENDIMEVE TË  
KOMISIONERIT PËR  
MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI**

**2020**

## Përmbajtja

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË RACËS.....	6
1. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendra T'reja, kundër Deputetit të Kuvendit, M.M. ....	6
2. B.SH., kundër Bashkisë Devoll. ....	6
3. A.C., kundër Policisë Bashkiake Tiranë dhe Bashkisë Tiranë .....	8
4. Rrjeti i Organizatave Rome dhe Egjiptiane, kundër Deputetit të Kuvendit M.M. ....	11
ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL .....	13
5. Çështje ex-officio e nisur kundër ish Deputetit F.N. ....	13
ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE .....	15
6. A.C., kundër Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë. ....	18
7. H.B., kundër Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a.....	17
8. G.K., kundër Bashkisë Gjirokastrë .....	20
9. T.M., kundër Bashkisë Berat .....	23
10. A.A., kundër Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.....	30
11. G.Xh., kundër Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Kavajë sh.a.....	33
12. K.L., kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastrë.....	31
13. F.K., kundër Ujësjetllës Mat sh.a.....	34
14. L.P., kundër Bashkisë Gjirokastrë .....	37
15. L.SH., kundër Bashkisë Mallakastër .....	40
16. S.K., kundër Shërbimit Spitalor Skrapar .....	42
17. M.M., kundër Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe Zyrës Vendore Arsimore Dibër (ZVA Dibër) .....	45
18. A.R., kundër Ujësjetllës Mat sh.a. ....	48
19. F.F., kundër Ujësjetllës Mat sh.a. ....	51
20. SH.M., kundër Bashkisë Përmet.....	54

21. E.Z., kundër Bashkisë Bashkisë Mallakastër .....	63
22. L.Gj., kundër E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe E.D., Kryetar i Bashkisë Berat .....	65
23. Sh.Q., kundër Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) .....	67
24. L.Ç., kundër Bashkisë Gjirokastrë.....	70
25. E.O., kundër Bashkisë Kavajë. ....	73
26. O.S., kundër Bashkisë Përmet. ....	76
27. A.Ç., kundër Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a.....	80
28. P.I., kundër Bashkisë Mallakastër. ....	84
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE .....</b>	<b>87</b>
29. Grup personash kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Tiranë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) Korçë dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE).....	87
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE.....</b>	<b>82</b>
30. SH.M., kundër Drejtorisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I., me detyrë drejtuese e Shërbimit të Anatomisë Patologjike .....	91
31. R.G., kundër Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc.....	85
32. E.N., kundër Zyrës Vendore Arsimore Klos dhe Shkollës 9-Vjeçare “Tahir Hoxha” Klos .....	88
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQERORE.....</b>	<b>93</b>
33. V.A., kundër B.P., dhe A.R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. ....	93
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË PËRKATËSISË PRINDËRORE .....</b>	<b>96</b>
34. M. Ç., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPP) dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë (DVP Vlorë).....	106
35. S.S., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, A.(B.)H., dhe E.M., Oficerë të Policisë Gjqësore pranë Drejtorisë së Policisë Durrës, M.Rr., Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, në Ministrinë e Brendshme.....	99
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË.....</b>	<b>112</b>
36. D.T., kundër shoqërisë Spiecapag – Shqipëria. ....	112
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË MOSHËS .....</b>	<b>105</b>

37. M.H., kundër V.B., Drejtore e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.....	115
38. K.K., kundër Bashkisë Kavajë.....	119
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE.....</b>	<b>122</b>
39. S.S., kundër: Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier dhe Shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier.....	122
40. M.T., kundër Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.....	126
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR .....</b>	<b>132</b>
41. Çështja ex-officio mbi ngjarjen e ndodhur në datën 04.02.2020 në Teatrin ArTurbina.....	132
42. S. K., kundër operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k., .....	135
43. Për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me gjuhën e përdorur, në programin, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V” të datës 24.07.2020 të publikuar në faqen web të televizionit Top-Channel. ....	137
44. I.Ç., kundër S.J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.....	140
45. K.F., kundër Zyrës Vendore Arsimore Korçë-Pustec dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë. ....	143
46. B.K., kundër Zyrës Vendore Arsimore Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.....	147
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË .....</b>	<b>150</b>
47. E.D., B.D., B.Gj., A.Gj., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k. ....	150
48. Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptare kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.,.....	145
<b>ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR ÇDO SHKAK TJETËR.....</b>	<b>162</b>
49. H.H., kundër Galerisë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë.....	162
50. F.GJ., kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).....	165
51. H.H., kundër E.SH., Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve.....	168
52. I.Xh., dhe J.K., kundër Shoqërisë Bconnect sh.p.k .....	171
53. M.Gj., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel (I.E.V.P Burrel) .....	175

## Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit nr.10221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrinë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që ti shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për ta udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që ta japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen *web* të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendimarrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit.

Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**PhD Robert Gajda**



Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection  
from Discrimination

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË RACËS<sup>1</sup>

### 1. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendra T'reja, kundër Deputetit të Kuvendit, M.M.

**VENDIM NR. 62, DATË 17.06.2020**

**Shkaku:** Raca  
**Forma:** Diskriminim në formën e “shqetësimit”  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Deputeti M.M., është shprehur duke përdorur gjuhë diskriminuese ndaj komunitetit rom, në Kuvendin e Shqipërisë, në datën 17.09.2019.

#### **FAKTET**

Subjektet ankuese informojnë Komisionerin se: *“Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë, të datës 17.09.2019, Deputeti i Kuvendit dhe njëkohësisht dhe Zëvendëskryetar i Kuvendit, M.M., gjatë fjalës së tij përdori fjalë diskriminuese ndaj komunitetit Rom. Ai është shprehur se: “T’ia heqim Unazës 100 metra dhe t’ua japim këtyre deputetëve që të kenë dhe ata një farë dinjiteti, sepse po bëhen si arixinjtë me çadra”. Ky term është me përmbajtje raciste dhe përçmon komunitetin Rom.”*

Në përfundim të ankesës së paraqitur, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendra T'reja kanë kërkuar konstatimin e diskriminimit të komunitetit rom nga ana e M.M.

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 17, 18 & 22;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;

<sup>1</sup>Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin *“racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”*, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b).

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a).

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se pavarësisht faktit nëse diskutimi i bërë në Konferencën e Kryetarëve nga ana e M.M., nuk mund të ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes (në formën e përçmimit dhe denigrimit) apo diskriminimin e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e shqetësimit, anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

### **VENDIMI**

Konstatimi i diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit rom nga ana e M.M., për shkak të racës, në formën e shqetësimit.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, M.M., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit rom.



## 2. B.SH., kundër Bashkisë Devoll.

**VENDIM NR. 84, DATË 10.08.2020**

**Shkaku: Raca**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

B.Sh., ka punuar në pozicionin e sanitares pranë Shkollës 9-vjeçare “Dritëro Agolli”, Devoll. Ajo është larguar puna pa asnjë motivacion. Ajo pretendon diskriminim për shkak të racës nga Bashkia Devoll.

### ***FAKTET***

B.Sh., ka punuar në pozicionin e sanitares pranë Shkollës 9-vjeçare “Dritëro Agolli”, Devoll. Ajo është emëruar në detyrë nga ana e Kryetarit të Bashkisë Devoll. B.Sh., sqaron se është interesuar dhe ka kërkuar kopje të kontratës së saj të punës pranë Bashkisë Devoll, por nuk i është mundur një e tillë. Ankuesja pretendon se shpesh herë ka marrë kërcënime nga punonjës të Bashkisë Devoll, për largim nga puna. Ajo është përpjekur të identifikojë arsyen e këtyre reagimeve, e cila sipas saj ka qenë përbuzje, pasi ajo i përkiste komunitetit rom.

Ankuesja shprehet se është ankuar, pranë Avokatit të Popullit dhe menjëherë pas këtij ankimimi, ankuesja pretendon se Drejtoresha e Shkollës i është shprehur se do ta largojnë nga puna, duke theksuar faktin se për këtë ajo nuk ka përgjegjësi, pasi nuk është punëdhënësjë e saj. B.Sh., sqaron se në datën 30.04.2020, ajo ka marrë dijeni zyrtarisht mbi zgjidhjen e kontratës së saj të punës me Bashkinë Devoll.

### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 & 49;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,

### ***KONKLUSIONE***

Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nga ana e Bashkisë Devoll, që është edhe punëdhënësi i B.Sh., Në aktin e largimit nga puna të Kryetarit

të Bashkisë Devoll, të B.Sh., nuk përcaktohet asnjë motivacion për zgjidhjen e kontratës së saj të punës. Ndërkohë që, në shkresën zyrtare të dërguar pranë Komisionerit, ky subjekt justifikohet me faktin se ankuesja është larguar nga puna, pasi nuk ka përmbushur detyrat e saj funksionale. Bashkia Devoll nuk ka depozituar në cilësi provë asnjë akt që të provonte sa më sipër. Aq më tepër, ky subjekt nuk ka dërguar asnjë prej akteve të kërkuara dy herë zyrtarisht nga Komisioneri. Referuar vërtetimit të lëshuar nga Shoqata Distutni Albania rezulton se ankuesja B.Sh., i përket komunitetit rom të qytetit të Korçës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vuri në dukje faktin se refuzimi për të bashkëpunuar, duke mos dërguar aktet e kërkuara zyrtarisht, në mënyrë të përsëritur, konsiderohet papërgjegjshmëri e rëndë dhe i tërheq vëmendjen Bashkisë Devoll.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit, të B.Sh., për shkak të racës, nga ana e Bashkisë Devoll.

Konstatimin e mosdiskriminimit, të B.Sh., për shkak të racës, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Dritëro Agolli” Devoll.

Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Devoll, për punësimin e B.Sh., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të ngjashëm me të, në një shkollë tjetër.

### 3. A. C., kundër Policisë Bashkiake Tiranë dhe Bashkisë Tiranë

**VENDIM NR. 133, DATË 08.10.2020**

**Shkaku:** Raca, etnia dhe gjendja ekonomike  
**Forma:** Diskriminim i tërthortë  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi është ndaluar nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, për shkak se ka qënë duke transportuar disa mbetje të riciklueshme (hekur), me mjetin e tij të llojit biçikletë me tre rrota, drejtë një pike grumbullimi. Nga ana e Policisë Bashkiake, i është sekuestruar mjete, si dhe materialet e vendosura në të, pa i dhënë asnjë dokument zyrtar apo akt administrativ lidhur me veprimet e ndërmarra prej tyre.

#### ***FAKTET***

Patrulla e Policisë Bashkiake Tiranë është njoftuar nga salla operative për një ndërhyrje dhe dëmtim të kontenierëve të mbetjeve urbane në Bulevardin “Zogu I”. Nga ana e tyre gjatë patrullimit është konstatuar ankuesi, i cili me mjetin e modifikuar me tre rrota (karrocë), tip biçikletë, po transportonte mbetje të riciklueshme (hekur), drejtë një pike grumbullimi pranë zonës së ish Stacionit të Trenit në Tiranë. Nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, i është bllokuar mjete biçikletë, si dhe materialet e vendosura në të, për t’i transportuar më pas drejtë Landfilldit të Tiranës.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët dhe provat e administruara, punonjësit e Policisë Bashkiake, pasi kanë kryer procedurat e bllokimit të mbetjeve të riciklueshme dhe mjetin e transportit të tyre, kanë përpiluar një Raport Shërbimi për të evidentuar ngjarjen e ndodhur, por pa vënë në dispozicion të ankuesit asnjë dokumentacion apo akt administrativ, siç parashikohet në VKB-në Nr. 156, datë 21.12.2018, të Këshillit Bashkiak Tiranë. Sipas këtij vendimi të Këshillit Bashkiak Tiranë, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuar në këtë vendim, në rastin kur ndaj tyre është marrë një masë administrative. Pas ndalimit të ankuesit, nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake është njoftuar Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit të cilët kanë ardhur në ndihmë të tyre, duke marrë dhe transportuar drejtë Landfilldit të Tiranës, materialet e riciklueshme së bashku me biçikletën e modifikuar.

#### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)

- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 2, 3, 4, 6, 7, 11, 12, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për policinë bashkiake e të komunës”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Planit të Përbashkët “Për parandalimin e ndotjes së mjedisit, identifikimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm, të ushtruar nga individë apo subjekte private, në fushën e mbledhjes, përpunimit të materialeve të riciklueshme, në territorin e Bashkisë Tiranë”;
- Rregullore e brendshme “TIP” e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës, miratuar me Urdhrin Nr. 18.04.2003.
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 1, datë 05.02.2007 “Për rregullimin e administrimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit”;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”.

## **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Nuk ekzistonte një procedurë standarde ligjore për konstatimin, bllokimin dhe shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve të riciklueshme, me anë të së cilës Policia Bashkiake Tiranë të veprojë për të ushtruar funksionet e saj;
- Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë ndërmarrë hapa për hartimin e procedurës standarde, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake mënyrën e veprimit rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane;
- Mungesa e një procedure standarde, ka përballur pikërisht anëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian me situata të pafavorshme si në rastin konkret;
- Bashkia Tiranë nuk arriti të provonte se kishte ndërmarrë hapa konkret në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, sa i përket formalizimit të grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme duke i mohuar kështu edhe mundësinë për të siguruar mjetet minimale të jetesës.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike, të

shtetasit A.C., nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë.

Referuar pikës 1 të këtij vendimi, të merren masa nga Policia Bashkiake Tiranë, për pajisjen me një akt administrativ të vlefshëm shtetasin A.C., në lidhje me sekuestron e vendosur në bazë të raportit të shërbimit.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, për hartimin e një procedure standarde, lidhur me konstatimin dhe bllokimin e mjeteve të transportit dhe mbetjeve të riciklueshme.

Të merren masa nga Bashkia Tiranë për zbatimin e Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, në pjesën që parashikon mbi formalizimin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme.

Në kuadër të plotësimit të masave konkrete, në realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, rekomandohet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, të kryej një studim mbi situatën dhe pozicionin e grumbulluesve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme në Republikën e Shqipërisë.

#### 4. Rrjeti i Organizatave Rome dhe Egjiptiane, kundër Deputetit të Kuvendit M.M.,

##### VENDIM NR. 63, DATË 17.06.2020

**Shkaku:** Raca  
**Forma:** Diskriminim i në formën e “shqetësimit”  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë, të datës 17.09.2019, Deputeti i Kuvendit dhe njëkohësisht dhe Zëvendëskryetar i Kuvendit, M.M., gjatë fjalës së tij ka përdorur shprehje diskriminuese ndaj komunitetit Rom, duke u shprehur se: *‘T’ia heqim Unazës 100 metra dhe t’ua japim këtyre deputetëve që të kenë dhe ata një farë dinjiteti, sepse po bëhen si arixinjtë me çadra’.*

#### **FAKTET**

Referuar proceverbalit të mbajtur në Konferencën e Kryetarëve, në mbledhjen e datës 17.09.2019, M.M., ka marrë fjalën dhe është shprehur ndër të tjera se: *“Zoti Kryetar, dua të flas jashtë rendit të ditës, nuk e di nëse është në tagrin e Konferencës së Kryetarëve, a të bëjmë ndonjë vendim, a të biem dakord të gjithë parimisht, për 15 apo 20 deputetët e rinj, të cilët kanë nevojë të mbështeten. Më duket se deri në vitin 2009 ka qenë ligji që deputetët dhe funksionarët e lartë publik përfitonin një kredi me interes të ulët. A ekziston mundësia që të bëhet një vendim Kuvendi apo qeverie, nëse keni ndrojtje, nga populizmi thoni që e ka propozuar M.M., që këta deputetë të marrin kredi? Ata nuk janë aksionerë as në PPP-të dhe as në tendera, por e kanë të nevojshme të mbështeten me një kredi, siç kam marrë unë, por edhe ju në vitin 1997, 1992 dhe në vitet e tjera me radhë. Nuk besoj se është hipokrizi për të ndihmuar 15 apo 20 deputetë, prandaj duhet ta bëjmë një vendim. Pra, bëhet fjalë për 1 miliard lekë të vjetër, që janë më pak se 1 milion euro. T’ia heqim Unazës 100 metra dhe t’ua japim këtyre deputetëve që të kenë edhe ata një farë dinjiteti, sepse po bëhen si arixinjtë me çadra. Unë besoj se gjithsecili deputet që është futur tani ka një farë rëndësie për mbarëvajtjen e këtij vendi, edhe për ekzistencën në këmbë të këtij parlamenti, ishalla po na hapen negociatat. Pra, nuk na kushton asgjë t’i mbështesim për të blerë një shtëpi.”*

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 17, 22 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.)
- Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Neni 2.

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 2, 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

## **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Deklarata në fjalë e M.M., paraqet rëndësi të veçantë, edhe për shkak të cilësisë së veçantë të M.M., jo vetëm si politikan, por edhe pasi ai vijon të ushtrojë detyrën e Nënkretarit të Kuvendit të Shqipërisë. Për më tepër, edhe pse mbledhja e Konferencës së Kryetarëve është realizuar me dyer të mbyllura, procesverbali i mbajtur gjatë seancës është publik dhe lehtësisht i aksesueshëm, duke bërë që deklaratat të kenë një përhapje të gjerë në opinionin publik.
- Termi *arixhi*<sup>2</sup> është një nga mënyrat se si komuniteti rom identifikohet në zona të ndryshme të Shqipërisë. Përdorimi i këtij termi përmban një konotacion negativ, përçmues dhe denigrues kundrejtë komunitetit rom, duke shfaqur doza diskriminimi dhe përforcon stereotipe kundrejtë këtij komuniteti.
- Referuar rastit në fjalë, ku M.M., kërkon që, për t’i kthyer dinjitetin deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë duhet të mos jetojnë s’i arixhinjtë në çadra, vendos anëtarët e komunitetit rom në pozita inferiore dhe denigruese. Në këtë kuptim, përdorimi i zhargonit të vjetër popullor, nga M.M., përforcon stereotipet e krijuara ndaj pakicës kombëtare rome dhe i vendos ata në pozita të pafavorshme e përçmuese në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit nëse diskutimi i bërë në Konferencën e Kryetarëve nga ana e M.M., nuk mund të ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes (në formën e përçmimit dhe denigrimit) apo diskriminimit e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e shqetësimit, anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit rom nga ana e M.M., për shkak të racës, në formën e shqetësimit.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, M.M., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit rom.

---

<sup>2</sup> Në fjalorin e Gjuhës Shqipe ky term përdoret si: [Cigan](#) endacak. Çadrat e arixhinjve.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL

### 5. Çështje ex-officio e nisur kundër ish Deputetit F.N.

**VENDIM NR. 81, DATË 10.08.2020**

**Shkaku:** Orientimi seksual  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni i publikuar në media, me urdhërin Nr. 58, datë 22.05.2020, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me gjuhën e përdorur në rrjetet sociale nga ana e ish deputetit F. N.

#### **FAKTET**

Duke marrë shkas nga flamujt e vendosur në ambientet e jashtme të Bashkisë Tiranë, F.N., në ditën ndërkombëtare kundër Homofobisë, ka publikuar një status në rrjetin social Facebook, ku i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, E.V., duke u shprehur se: *“Që je b..th..q kjo është puna jote ... Që gjithë karrierën tënde e ke bërë bazuar te vlerat e b..., edhe kjo është puna jote. Që të shkoi jeta duke i lëpirë b... Edi Ramës edhe kjo prapë është puna jote . Që të gjesh veten shpirtërisht dhe të kesh simbol të vlerave tua këto ngjyra prapë është puna jote.. Por mbaje dhe vendose te shpia jote ... Sepse ky institucion shtetëror përfaqëson qytetarët e Tiranës, dhe aty vendoset vetëm flamuri kombëtar dhe jo ngjyrat e by... tënde ...”*.

Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e F.N., nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument lidhur me shprehjet e përdorura në adresë të komunitetit LGBTI.

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 17, 22 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, miratuar në datë 31 mars 2010.



- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

### **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- F.N., nëpërmjet shprehjeve: “... Që të gjesh veten shpirtërisht dhe të kesh simbol të vlerave tua këto ngjyra prapë është puna jote.. Por mbaje dhe vendose te shpia jote ... Sepse ky institucion shtetëror përfaqëson qytetarët e Tiranës, dhe aty vendoset vetëm flamuri kombëtar dhe jo ngjyrat e by... tënde ...”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ka prodhuar përhapjen ose nxitjen e urrejtjes, në formën e denigrimit dhe përçmimit, kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Fakti që, më datë 16.05.2020, në ambjentet e jashtme të Bashkisë Tiranë janë vendosur flamujt që përfaqësojnë ditën ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe komunitetin LGBTI, vendosja e tyre, nga ana e F.N., është interpretuar si fyerje e institucioneve shtetërore.
- Shprehjet e përdorura në adresë të komunitetit LGBTI nga F.N., krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar në lidhje me çështjet e orientimit seksual, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj këtij komuniteti.
- Komisioneri vlerëson se shprehjet dhe gjuha e përdorur nga F.N., janë rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Sa më sipër papërgjegjshmëria e lirisë së fjalës e përdorur nga F.N., paragjykon dinjitetin dhe cënon sigurinë e personave për shkak të orientimit seksual. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standarti të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standarti të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç është “dinjiteti njerëzor”, pa qenë e nevojshme identifikimi i një krahasuesi.

### **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit LGBTI, në formën e shqetësimit, për shkak të orientimit seksual, nga ana e F.N.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, F.N., të marrë masa të menjëhershme duke hequr statusin e publikuar të datës 16.05.2020, në rrjetin social Facebook.



Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, F.N., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit LGBTI.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

### 6. A.C., kundër Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër

**VENDIM NR. 30, DATË 13.03.2020**

**Shkaku: Bindje politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

A.C., ka punuar në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastër, që prej datës 21.10.2016. Ankuesja pretendon se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Gjirokastër, i cili është përfaqësues i forcës politike “Partia Socialiste”, ajo u ekspozua ndaj një trajtimi diskriminues për shkak të bindjes politike.

#### **FAKTET**

Në kushtet kur, në zgjedhjet vendore të vitit 2018, fituese rezultoi subjekti politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila nuk ishte me në koalicion me subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, Kryetari i ri, i Bashkisë Gjirokastër u zgjodh F.G., anëtar dhe përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Me ardhjen në detyrë, në qershor 2018, të Kryetarit të ri të Bashkisë Gjirokastër, F.G., ankuesja pretendon se ndaj saj ka filluar diskriminimi, për shkak të bindjes politike. Për sa më sipër, në një takim informal që ka patur me F.G., në datën 5 gusht 2019, asaj i është komunikuar verbalisht fakti se do të lëvizë nga pozicioni i punës, fakt të cilin A.C., e ka kundërshtuar.

Në datën 06.08.2019, ankuesja pretendon se është larguar për pushime drejt Sarandës, ndërkohë që Drejtori i Kabinetit të Bashkisë Gjirokastër e ka marrë në telefon, ku i kërkon çelësin e zyrës së saj. Në vijim, A.C., shprehet se është vënë në dijeni të faktit se zyra e saj është hapur me forcë, me justifikimin se kryetarit i duhet një dosje, që administrohej nga Znj. A.C. Ajo shprehet se nga zyra e saj ishin tërhequr edhe dosje e dokumente të tjera, të cilat ajo i kishte në ngarkim.

Përveç sa më sipër, A.C., shprehet se gjatë periudhës, që ajo ishte me leje vjetore, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Urdhërin me objekt krijimin e Komisionit Disiplinor për pezullimin dhe lirimin e saj nga shërbimi civil. Komisioni Disiplinor, i ngritur nëpërmjet këtij urdhëri, ka vendosur pezullimin e ankueses nga detyra. Pas kthimit nga leja vjetore, ankuesja ka depozituar kallëzim penal kundër Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, lidhur me çështjen e hapjes forcërisht të derës së zyrës së saj. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka

vendosur për mosfillimin e procedimit penal. Pas kundërshtimit të këtij vendimi të prokurorisë, nga ana e ankueses, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, kjo e fundit është shprehur me vendim, nëpërmjet së cilit detyron Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet, që do të përcaktohen në vendimin gjyqësor.

Pas paraqitjes në punë, ankuesja pretendon se ka regjistruar në zyrën e protokollit një Akt-Konstatimi, lidhur me faktin se zyra, ku ajo punonte ishte hapur me forcë, si dhe ka kryer kallëzim pranë organeve të rendit publik.

### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 & 49;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), neni 5;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10.

### ***KONKLUZIONE***

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se ankuesja ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, trajtim, i cili kishte lidhje me bindjet politike të saj. Ky trajtim konsistonte në një sërë veprimesh të kryera në titullari i këtij institucioni, të cilat kishin si qëllim anashkalimin në punë të ankueses, duke synuar që proceset e punës, që konsistonin në përfshirjen në mënyrë të domosdoshme të A.C., që ishte Drejtore e Burimeve Njerëzore, të kryheshin në mungesë të saj. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se fillimi i procedurës disiplinore është kryer gjatë periudhës që, ankuesja ishte me leje vjetore, të cilën e ka kryer në mënyrë të imponuar dhe pa dëshirën e saj, si dhe masa e marrë ndaj saj nuk ka qenë në proporcion me shkeljet e kryera, në kushtet kur vlerësimet e punës së A.C., kanë qenë gjithmonë shumë të mira dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore paraprake, të pashuar.

Komisioneri doli në përfundimit se Komisioni Disiplinor e kishte vendosur masën disiplinore ende pa shqyrtuar shkeljet e ankueses dhe pasojat që kanë ardhur nga to, fakt ky që dëshmon se Komisioni ka qenë i udhëzuar për të vepruar në këtë mënyrë. Komisioneri gjykoi se në rastin konkret kishim të bënim me udhëzim konkret të titullarit të institucionit, për Komisionin Disiplinor, për të vendosur masat e mësipërme disiplinore për A.C.



## ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të A.C., për shkak të bindjes politike, nga F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastrër, në formën e udhëzimit për të diskriminuar.

Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga Bashkia Gjirokastrër, për rikthimin në punë të ankueses, në një pozicion analog me pozicionin e mëparshëm të punës, që ajo ka mbajtur pranë këtij institucioni.

## 7. H.B., kundër Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a.,

### VENDIM NR. 35, DATË 15.04.2020

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune në detyrën si Përgjegjëse e Task-Forcës, pranë Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Mallakastër. Pas emërimit të G.N., si Administrator i Shoqërisë është larguar nga puna, për shkak të bindjeve politike.

#### **FAKTET:**

H.B., me Urdhërin e Brendshëm Nr. 81, datë 31.10.2018 është emëruar në detyrën si Përgjegjëse e Task-Forcës, pranë Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Mallakastër.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Mallakastër u zgjodh Q.I., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Me Vendimin Nr. 06, datë 11.09.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizime Mallakastër, G.N., është emëruar në detyrën si Administrator i Shoqërisë. Me shkresën Nr. 463, datë 30.09.2019 të Administratorit të Shoqërisë, është bërë njoftimi i H.B., për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, bazuar në relacionin datë 26.09.2019 të paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë së Shitjes<sup>3</sup> në lidhje me funksionimin dhe realizimin e rezultateve në kryerjen e punës së Task –Forcës në të cilën rezultoi se performanca dhe eficaenca në punë e H.B., është shumë e dobët gati mos ekzistente.

Me Vendimin Nr. 02, datë 07.10.2019 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare” është njoftuar H.B për zgjidhjen e kontratës individuale të punës për arsye të performancës së dobët dhe moseficientës të vendit të punës.

Punonjësja H.B., prej një periudhe prej 11 muajsh nuk kishte pasur asnjë vërejtje për detyrat e kryera, masë disiplinore apo mosraportim nga ana e drejtuesve të Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Mallakastër.

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 49, 116.
- Konventa e OKB-së “Për elememinimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (2014).

<sup>3</sup> Me Urdhërin nr. extra, datë 16.08.2019, B.B është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shitjes.

- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të datës 27.11.2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të datës 05.07.2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”, të cilat synojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e gjinisë “femër”, sidomos në marrëdhëniet e punës.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj).
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>4</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”.
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 9, 21, 110.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 10, 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 1, 3, 7, 12, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE:**

Komisioneri vlerësoi se nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me H.B., është bërë për shkak të moskryerjes së detyrave funksionale, pasi Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër dështoi për të dërguar pranë Komisionerit, kopje të detyrave të ngarkuara për Task-Forcën.

Komisioneri vlerëson se vendimmarrja e drejtuesit të Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër ka qenë e paarsyeshme dhe jo proporcionale pasi është bazuar vetëm në relacionin informues të Drejtorit të Drejtorisë së Shitjes dhe jo në një vlerësim objektiv të detyrave të realizuara nga punonjësja H.B. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër nuk sollti asnjë provë që të dëshmonte se kishte thirrur në takim punonjësen lidhur me realizimin e detyrave apo ti kishte tërhequr vëmendje për eficiencën në punë. Nëse Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër do kishte realizuar analizat javore apo mujore të punës nëpër drejtori do ishin vërejtur dhe mangësitë në realizimin e detyrave të Task-Forcës.

Komisioneri vlerësoi se, duke patur në vëmendje se njoftimi për largim nga puna i ankueses përkon në kohë (rreth 12 ditë pune) me emërimin e Administratorit të ri, ngre dyshimin e

<sup>4</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

arsyeshëm se veprimi i mësipërm është bërë në dëm të subjektit ankues, duke përkeqësuar situatën e saj profesionale për shkak të bindjes politike.

Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankueses nga puna konstatoi se H.B., është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e saj nga puna është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me H.B.



## 8. G.K., kundër Bashkisë Gjirokastrër

### VENDIM NR. 40, DATË 27.04.2020

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Ankuesi, për një periudhë 4 vjeçare ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Gjirokastrës, në pozicionin “Inspektor terreni” pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM). Pas ardhjes në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë është larguar nga puna, për shkak të bindjeve politike.

#### **FAKTET**

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Gjirokastrër, me datë 01.04.2016, në pozicionin e Inspektor Terreni i Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM), Agjenci në varësi të Bashkisë Gjirokastrër, deri me datë 23.10.2019, datë në të cilën është bërë dhe lirimi i tij nga detyra.

Referuar akteve shkresore të dosjes së ankuesit, rezulton se ndaj tij, vetëm për periudhën: gusht-tetor të vitit 2019, janë dhënë katër masa disiplinore (përfshirë edhe largimin nga detyra), ndërkohë që për periudhën e mëparëshme të punës nuk rezultojnë masa disiplinore ndaj tij.

Arsyetimi për largimin e tij nga puna ishte se ankuesi: *“Me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar pamundësinë e Bashkisë Gjirokastrër për të përmbushur funksionet e parashikuara në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 27/5 “Administrimin e fondit pyjor dhe kollusor publik”, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja shumë të rënda, me faj të rëndë të Inspektorit të Terrenit të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në Bashkinë Gjirokastrër, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve, Gusht e Shtator 2019”.*

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>5</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr.139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”.
- Ligji Nr.9385/2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar.

### **KONKLUZIONE**

Në analizë të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masave disiplinore, Komisioneri gjykoi se nga ana e Bashkisë Gjirokastrë është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Bashkisë.

Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur dhe analizimi i këtyre katër masave disiplinore, veçmas dhe bashkarisht, Komisioneri ka konstatuar se Bashkia ka konsumuar shkelje të rënda të parimit të barazisë dhe trajtimit të drejtë të ankuesit, dhe për asnjëherë nga këto masa, Bashkia nuk provoi se ato kanë patur një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, apo që veprimet e saj, të kenë ndjekur një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Komisioneri, bazuar në analizimin e provave dhe bindjen e tij të brendshme, arriti në konkluzionin se kishte një lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike si anëtar i LSI-së dhe trajtimit të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u arrit të provohej një përligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj tij dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi i saj se largimi nga puna kishte ardhur, pasi në mënyrë të përsëritur nuk kishte zbatuar detyrat e ngarkuara nga ligji dhe Rregullorja e Brendshme e Agjencisë; rezultoi i pa bazuar në prova, i padrejtë dhe i paligjshëm. Rrjedhimisht Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i ishte nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

---

<sup>5</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.



## ***VENDIMI***

Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, G.K., për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Bashkisë Gjirokastrër.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Bashkisë Gjirokastrër, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me G.K.

## 9. T. M., kundër Bashkisë Berat

**VENDIM NR. 58, DATË 04.06.2020**

**Shkaku:** Bindja politike & Gjendja shëndetësore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

T. M., ka punuar në pozicionin e Drejtores në Drejtorinë Arsimore, pranë Bashkisë Berat. Ankuesja pretendon se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Berat, cili është përfaqësues i forcës politike “Partia Socialiste”, ajo u ekspozua ndaj diskriminimit për shkak të bindjes politike dhe gjendjes së saj shëndetësore.

### **FAKTET**

Ankuesja shprehet se me ndryshimin e titullarit të institucionit, ndaj saj ka filluar presioni, diskriminimi, fyerjet publike, si dhe bllokimi i procedurave mbi aktivitetet e drejtorisë përkatëse. Ankuesja pretendon se këto janë kryer me qëllim që ajo apo edhe punonjës të tjerë që i përkisnin forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim, të jepnin dorëheqjen.

T. M., sqaron se ka kërkuar në mënyrë të përsëritur takim me kryetarin e Bashkisë Berat, por nuk është pritur nga ana e tij. Ankuesja ka kërkuar të kryejë lejen vjetore, të planifikuar, në muajin shtator 2019, për arsye shëndetësore<sup>6</sup>, por leja nuk i është miratuar nga ana e titullarit të saj. T.M., thekson faktin se në një nga mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë e ka fyer në prezencë të stafit dhe mediave, si dhe nga data 15.08.2019 – 17.08.2019, i ka bërë presion me e-maile për anulimin e një procedure në thesar.

Diskriminimi në fjalë pretendohet se është reflektuar në vijim me masën disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” të dhënë ndaj saj nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat. Masa disiplinore u pasua me largimin e saj nga puna, me motivacion “*mospërmbushje e detyrimeve funksionale të pozicionit të punës*”.

Ankuesja pretendon se ka marrë raport për paaftësi të përkohshme në punë për 2 javë kalendarike, në mungesë të dhënies së lejes vjetore 2019 nga Kryetari i Bashkisë Berat. Ajo shprehet se diskriminimi i saj konsiston në faktin se, ndaj mjekut, i cili i ka dhënë raportin mjekësor, është ushtruar presion, nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Berat. Gjatë hetimit administrativ, ankuesja shtoi si shkak diskriminimi edhe gjininë, me pretendimin se ishte larguar nga puna pasi ishte femër.

<sup>6</sup> Referuar raportit për paaftësi të përkohshme në punë me Nr. Regjistri 6117, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr. 1, Berat, ku rezultoi se në datat 10-14 tetor 2019, ankuesja ka qenë me paaftësi të përkohshme në punë;

## **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 & 49;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), neni 5;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10.

## **KONKLUZIONE**

Komisioneri doli në përfundimin se ankuesja i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjeve të saj, politike.

Bashkia Berat, në asnjë moment nuk justifikoi dhe motivoi me fakte konkrete largimin nga puna të ankuseses. Pavarësisht se Komisioneri kërkoi informacion në mënyrë të përsëritur nga ky institucion, aktet që vërtetonin dhe provonin motivacionin për masat disiplinore dhe largimin e ankuseses nga puna, ky institucion nuk dërgoi informacionin e kërkuar në adresë të KMD-së.

KMD çmoi se T.M., i është dhënë masa disiplinore “*vërejtje*”, me motivacionin “*Për shkelje të rregullave të etikës në komunikim me eprorin gjatë kryerjes së detyrës funksionale*”, ndërkohë që motivacioni nuk është i vërtetuar me fakte konkrete nga Bashkia Berat, si dhe nga ana e këtij subjekti nuk janë zbatuar procedurat përkatëse, sipas Kodit të Punës.

Ankuseses i është dhënë gjithashtu masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*”, ndërkohë që, në të njëjtën datë, është miratuar shkresa e Kryetarit të Bashkisë Berat, nëpërmjet së cilës, ankuesja njoftohet për fillimin e proçedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Në vijim, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat, ankuesja shkarkohet nga detyra dhe i zgjidhet kontrata individuale e punës me motivacionin “*mospërbushje të detyrimeve funksionale të pozicionit të punës*”, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar rezulton se firma mbikqyrëse e punimeve nuk pati asnjë pasojë, si dhe objekti, mbi të cilin ishte kryer investimi u mor në vijim në dorëzim nga Bashkia Berat, pavarësisht punimeve me cilësi të dobët të kryera në objekt.

Ankuesja ka depozituar kërkesë zyrtare pranë punëdhënësit, ku kërkohej ndalimi i diskriminimit të ushtruar ndaj saj. Bashkia Berat nuk e ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe mosveprimi i këtij institucioni bie në kundërshtim me detyrimet e dispozitave të LMD.



## ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të T.M., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Berat.

Konstatimi i mosdiskriminimit të T.M., për shkak të gjendjes shëndetësore dhe gjinisë, nga Bashkia Berat.

Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Berat, për rikthimin e T.M., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion analog me të.

**10. A.A., kundër Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.,**

**VENDIM NR. 106, DATË 10.09.2020**

**Shkaku:** Bindja Politike, Gjendja Martesore  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune me Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë, duke mbuluar detyra të ndryshme. Ankuesi, pretendon se veprimet kundër tij janë bërë për shkak të bindjes politike, në kuadër të fushatës për Kryetar Bashkie, pasi bashkëshortja e tij, ishte deputete e PS-së dhe Kryetari i Bashkisë ishte i zgjedhur nga subjekti politik LSI.

***FAKTET***

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune<sup>7</sup> me Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë, duke mbuluar detyra të ndryshme, që nga data 15.01.1991 deri në datë 28.05.2019. Me Vendimin Nr. 53, datë 25.12.2017 është liruar nga detyra e Drejtorit të Departamentit të Shitjes dhe është emëruar në pozicionin, Përgjegjës i Departamentit të Shitjes.

Me Vendimin Nr. 179, datë 31.12.2018, Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Kryetari i Bashkisë Kuçovë, ka emëruar P.S., në pozicionin, Administrator i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.

Me Urdhërin Nr. 153, datë 27.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore” punonjësit A.A., me pozicionin “Përgjegjës i zyrës së shitjes” i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” dhe ulje në pozicionin e punës me motivacionin “Për performancë të dobët në punë”.

Me Urdhërin Nr. 168, datë 28.05.2019 “Për dorëzim të detyrës” është urdhëruar që punonjësi A.A., në pozicionin Përgjegjës i Zyrës së Shitjes të kryej dorëzimet brenda një afati pesë ditor.

Me Vendimin Nr. 168/1, datë 28.05.2019 “Për lirim dhe emërim punonjësi në detyrë” është vendosur që A.A., të lirohet nga detyra në pozicionin, Përgjegjës i Zyrës së Shitjes dhe të emërohet në pozicionin e punës “Specialist Statistike”. A.A., pas datës 27.05.2019 nuk është paraqitur në punë, pasi nuk ka pranuar ndryshimin e pozicionit dhe prishjen e kontratës së punës.

<sup>7</sup> Referuar Librezës së Punës të A.A të lëshuar nga Ndërrmarrja Elektroujësjiellës Berat, datë 15.01.1991.

Me Urdhrin Nr. 210, datë 11.06.2019 “Për lirim punonjësi në detyrë” është urdhëruar që A.A., të lirohet nga detyra në pozicionin e punës “Specialist Statistike”, me motivacionin “Mungesë e pajustificuar dhe nuk ka njoftuar me shkrim punëdhënësin brenda 7 ditëve”.

Shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurës të procedimit disiplinor ndaj ankuesit, kanë të bëjnë me masat disiplinore të ndërmarra, gjë që ka passjellë dhe largimin e tij përfundimtar nga puna. Kështu:

- Njëpërmjet shkresës Nr. 868, datë 27.05.2019, Urdhër Nr. 153, datë 27.05.2019 “Për dhënie mase disiplinore” punonjësit A.A, me pozicionin “Përgjegjës i zyrës së shitjes” i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” dhe ulje në pozicionin e punës me motivacionin “Për performancë të dobët në punë” dhe me Vendimin Nr. 168/1, datë 28.05.2019 “Për lirim dhe emërim punonjësi në detyrë” është vendosur që A.A., të lirohet nga detyra në pozicionin Përgjegjës i Zyrës së Shitjes dhe të emërohet në pozicionin e punës “Specialist Statistike”.
- Komisioneri vlerëson se, dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t’i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>8</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen *Bączkoëski* dhe të tjerët kundër Polonisë (*Bączkoëski and others v. Poland*),/ çështjes *Redfearn* kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.

<sup>8</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.



- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 2, 3, 7, 12, 32 dhe 33.
- Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 64.

### **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Respektimin e procedurës së dhënies së masës disiplinore për ankuesin dhe se ky i fundit kishte dhënë pëlqimin për ndryshimin e pozicionit të punës.
- Faktimin e mosrealizimit të detyrave të ngarkuara nga ana e ankuesit dhe se detyra analizës së debitorëve ishte në përgjegjësinë e ankuesit.
- Emërimin e punonjësit A.D., në kundërshtim me strukturën dhe organikën e shoqërisë.

Shoqëria UK Berat-Kuçovë jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm për dhënien e masës disiplinore dhe ndryshimi i pozicionit të punës së ankuesit por shpjegimet e dhëna prej saj, ishin të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Komisioneri vëren se veprimet e Administratorit të Shoqërisë UK Berat-Kuçovë, si institucion varësie të kryetarëve të Bashkive Berat dhe Kuçovë, kundrejt ankuesit, kanë ardhur menjëherë pas mbledhjes të datës 08.05.2019, para fillimit të fushatës elektorale për zgjedhjet vendore të vitit 2019 dhe pasi ankuesi ka vënë në dijeni Administratorin e UK Berat-Kuçovë për presionet dhe veprimet që po i bëheshin atij në kuadër të fushatës për zgjedhjet vendore.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerësoi se shtetasi A.A., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, nga ana e Shoqërisë UK Berat-Kuçovë, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike dhe gjendjes martesore të ankuesit.

### **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike në formën e “udhëzimit për të diskriminuar” të shtetasit A.A., nga ana e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë.

## 11. G.Xh., kundër Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kavajë sh.a.,

### VENDIM NR. 146, DATË 26. 10. 2020

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjekti ankues, në datë 08.12.2017 është emëruar në detyrën e Drejtorit Teknik pranë UK Kavajë dhe ka punuar në këtë detyrë deri në datë 19.09.2019 kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe financiare. Gjate kesaj periudhe nuk ka pasur asnjë mungesë apo masë disiplinore në marrëdhëniet e punës deri në momentin kur është zgjedhur Kryetari i ri i Bashkisë Kavajë në vitin 2019. Subjekti ankues ka pretenduar se i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve politike.

#### **FAKTET**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues me Urdhrin Nr. 156, datë 07.12.2017 është emëruar në detyrën si Përgjegjës i Sektorit Qytet pranë Shoqërisë UK Kavajë.

Me Urdhërin Nr. 46, datë 24.09.2018 është emëruar në detyrën e Drejtorit Teknik pranë Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Kavajë dhe në datë 31.12.2018 ka lidhur kontratën individuale të punës me afat 2 vjeçar.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 38, datë 29.07.2019, G.Xh., ka marrë lejen e zakonshme duke filluar nga data 01.08.2019 deri në datë 28.08.2019, ndërsa nga data 29.08.2019 deri në datë 12.09.2019 ka qenë i pajisur me raport për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Kavajë u zgjodh R.K., i kandiduar nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë dhe në datë 30.07.2019 ka bërë betimin për marrjen e detyrës.

Me Urdhrin Nr. 25, datë 19.09.2019 të Administratorit të Shoqërisë UK Kavajë, G.Xh., është liruar nga detyra e Drejtorit Teknik, pa përcaktuar ndonjë motivacion

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë, nuk provoi, edhe pse iu kërkua që të faktonte performancën, paaftësinë dhe parregullsitë për detyrat e kryera nga ankuesi, pra punët të cilat ankuesi nuk kishte realizuar dhe arsyet e mosrealizimit. Ky fakt tregon se vlerësimi i performancës dhe aftësisë profesionale për ankuesin, i paraqitur në deklaratën e mbrojtjes drejtuar gjykatës nga ana e UK Kavajë, nuk është bërë mbi baza objektive dhe si i tillë nuk

mund të shërbejë për të marrë një vendim objektiv për përfundimin e marrëdhënies së punës mes ankuesit dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kavajë.

Lidhur me largimin e ankuesit nga puna, Komisioneri gjykon se nga ana e UK Kavajë është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht i njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e UK Kavajë.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>9</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen *Bączkoński* dhe të tjerët kundër Polonisë (*Bączkowski and others v. Poland*),/ çështjes *Redfearn* kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 153.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 1, 2, 3, 7, 12, 32 dhe 33.
- Ligjit Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, nenin 64.

### **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Kavajë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Respektimin e procedurës së largimit të ankuesit nga puna.
- Faktimin e performancës së dobët, paaftësisë profesionale dhe parregullsitë e konstatuara, përpara datës së largimit të ankuesit nga puna.

Gjithashtu, Shoqëria UK Kavajë jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm për largimin nga puna të ankuesit por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të

---

<sup>9</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në kushtet kur, nga ana e Shoqërisë UK Kavajë nuk u arrit të provohej që largimi nga puna i ankuesit ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se kjo masë ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit G.Xh., nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a, për shkak të bindjes politike.

## 12. K.L., kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastrë

**VENDIM NR. 03, DATË 06.01.2020**

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastrë nga data 01.08.2010. Me datë 31.07.2018 është komanduar për një periudhë 3 mujore në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastrë. Me datë 15.8.2018 i është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna”. Ankuesi ka pretenduar se transferimi i tij përveçse i paligjshëm, ishte edhe tendencioz dhe diskriminues, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të titullarit të Insitucionit.

### **FAKTET**

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezultoi se, subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastrë nga data 01.08.2010 deri në datën 15.8.2018, datë në të cilën i është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna”.

Me Urdhërin me Nr. 2149 Prot., datë 31.07.2018 subjekti ankues është komanduar për një periudhë 3 mujore në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastrë, pozicion me pagë më të ulët se ai që kishte përpara.

Ankuesi ka kërkuar të njihet me arsyet e ndryshimit të vendit të punës, si dhe ka bërë me dije se ai nuk e pranon këtë pozicion pune, pasi e konsideron ulje në detyrë.

Nga ana e DRSSH Gjirokastrë nuk është marrë në konsideratë mosdhënia e pëlqimit të ankuesit lidhur me detyrën e re, por nëpërmjet Urdhërit Nr. 2226 Prot., datë 08.08.2018, për mosparaqitje në vendin e punës për 5 (pesë) ditë rresht, ka urdhëruar kalimin në një detyrë të një kategorie më të ulët për një periudhë një vjeçare.

Komisioni Disiplinor (KD) i DRSSH Gjirokastrë<sup>10</sup> ka shqyrtuar situatën dhe veprimet e ankuesit dhe i ka rekomanduar drejtorit të DRSSH, masën disiplinore: “Largim nga puna”. Nëpërmjet Urdhërit Nr. 2262 Prot., datë 15.08.2018, K.L., i komanduar në detyrën e Inspektorit të Bujkut në ALSSH Gjirokastrë, për thyerje të rënda të disiplinës në punë dhe mosparaqitje në punë për 12 ditë rresht, i është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna”.

<sup>10</sup> Referuar procesverbalit me Nr. 2261 Prot., datë 15.08.2018.

## **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 50, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj).
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: “Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar”.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>11</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 9, 21, 110..
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 10, 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

## **KONKLUZIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, vlerësoi se:

Kalimi/komandimi i ankuesit nga “Specialist i të Vetëpunësuarve në Bujqësi” në pozicionin e të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër; është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët thelbësore të saj. Njëherësh me ndryshimin e pozicionit dhe vendit të punës, është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe një element thelbësor i kontratës, siç është paga.

Komisioneri vlerësoi se, vetë Urdhëri Nr. 2149 Prot., datë 31.07.2018, për komandimin në një detyrë tjetër të ankuesit, edhe pse për një periudhë të caktuar kohore, është në fakt zgjidhje e kontratës së punës, përsa kohë ai nuk ka dhënë pëlqimin për të punuar në këtë detyrë të re.

Nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjinin faktin se komandimi i ankuesit nga “Specialist i të Vetëpunësuarve në Bujqësi” në pozicionin e të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër; të kishte ardhur për arsye të ligjshme apo të ishte i arsyeshëm dhe i justifikuar.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u arrit të provohej një përlligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi se largimi nga puna kishte

---

<sup>11</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

ardhur si rezultat i mosprezencës së tij në punë, rezultoi i pa bazuar në prova, i padrejtë, i paligjshëm dhe për më tepër i qëllimshëm.

Në kushtet kur, nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin kishte ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provoi dhe dokumentoi se mbarte një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i ishte nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstatoi se DRSSH Gjirokastër, ishte në shkelje të parashikimeve të LMD-së.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër.

### 13. F.K., kundër Ujësstellës Kanalizime Mat sh.a.,

**VENDIM NR. 184, DATË 28.12.2020**

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Ujësstellës Mat sh. a, me të cilin kishte nënshkruar një kontratë pune me afat një vjeçar. Me ndërrimin e titullarit, ankuesit i është ndërprerë kontrata e punës, para afatit të caktuar, me motivacionin e performancës së dobët në punë. Ai ka pretenduar se është larguar për motive politike, pasi është Sekretar i Seksionit të Partisë Demokratike Lis që prej vitit 2017 e në vijim, dhe ka bindje të ndryshme politike nga Administratori i Shoqërisë, i cili ka bindje të majta politike si mbështetës i Partisë Socialiste.

#### ***FAKTET***

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Ujësstellës Mat sh.a., me të cilin kishte nënshkruar një kontratë pune me afat një vjeçar.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 339 Prot., datë 03.10.2019, ankuesit i është njoftuar zgjidhja e marrëdhënieve të punës me Shoqërinë, duke cituar se: *“Është konstatuar se gjatë ushtrimit të detyrës është evidentuar performancë e dobët në përmbushjen e detyrave funksionale, nuk është treguar në nivelin e kërkuar përgjegjshmëria në punë dhe sipas parimit të mirëbesimit këto marrëdhënie nuk mund të vijojnë në të ardhmen. Afati përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës do të jetë data 03.11.2019”*.

Me vendimin Nr. 32, datë 04.11.2019 Ujësstellës Mat sh.a., ka vendosur që ankuesit t'i ndërpriten marrëdhëniet financiare në detyrën Specialist Hidraulik+Monovrator, pranë Ujësstellës Mat sh.a., me motivacionin “Performancë e dobët në punë”.

#### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>12</sup>.

<sup>12</sup> Hyrë në fuqi në vitin 1976.



- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>13</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë<sup>14</sup>”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Jurisprudenca e GJED<sup>15</sup>
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

## **KONKLUZIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Ujësjetllës Mat sh.a.:

- Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se cilat detyra funksionale të ankuesit si Specialist Hidraulik+Monovrator nuk ishin përmbushur konkretisht.
- Nuk depozitoi asnjë ankesë nga konsumatorët kundrejt ankuesit, lidhur me mosfurnizimin me ujë në kohë.
- Nuk depozitoi asnjë shkresë ku të provohej fakti se ankuesi ishte vënë në dijeni dhe ishte njohur me ankesat e paraqitura kundrejt tij, si dhe kishte patur mundësinë për t’u shprehur dhe mbrojtur efektivisht lidhur me këtë pretendim të Drejtorisë Teknike, pretendim i cili i ishte bërë me dije ankuesit vetëm pasi ishin zgjidhur marrëdhëniet e punës me të.
- Në lidhje me faktin se ankuesi ishte konsideruar si punonjës i ri dhe për rrjedhojë pa eksperiencë, Ujësjetllës Mat sh.a., nuk vendosi në dispozicion kriteret mbi bazën e të cilave presupozohet se do të realizohej ristrukturimi dhe se çfarë peshe do të kishte në këtë kuadër eksperiencia për secilin nga punonjësit apo se çfarë eksperience apo kualifikime zotërojnë punonjësit e tjerë të cilët kanë vazhduar marrëdhëniet e punës.
- Ujësjetllës Mat sh.a., nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të pretendimeve se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin ishte ristrukturimi.
- Bazuar në të dhënat e pasqyruara në ekstraktin historik të shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a, pak kohë pas emërimit të Kryetarit të Bashkisë në detyrë, në shoqërinë Ujësjetllës Mat sh.a kanë ndodhur disa ndryshime në organet e saj drejtuese dhe ndër të tjera, në

<sup>13</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>14</sup> International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

<sup>15</sup> <sup>15</sup> CJEU, C-416/13, Mario Vital Pérez v. Ayuntamiento de Oviedo, 13 November 2014 ;

pozicionin e administratorit të Ujësjetllës Mat sh.a., është emëruar A.Th., (datë 10.09.2019). Administratori i ri, rreth dy javë pas emërimit në detyrë ka filluar procedurën e për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.

- Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara Komisioneri konstaton se Ujësjetllës Mat sh.a., deklaroi motivacione dhe shkaqe të ndyshme që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstatoi se Ujësjetllës Mat sh.a., ka diskriminuar subjektin ankuesi në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e kontratës së punës nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm por për shkak të bindjeve politike.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të ankuesit, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a.

Shoqëria Ujësjetllës Mat sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

#### 14. L.P., kundër Bashkisë Gjirokastrër

**VENDIM NR. 39, DATË 27.04.2020**

**Shkaku: Bindjet politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Ankuesi, për një periudhë 4 vjeçare ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Gjirokastrës, në pozicionin “Përgjegjës Sektor” pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM). Pas ardhjes në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë, me datë 23.10.2019 është larguar larguar nga puna, për shkak të bindjeve politike.

#### **FAKTET**

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Gjirokastrër, me datë 11.04.2016, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM), Agjenci në varësi të Bashkisë Gjirokastrër, deri me datë 23.10.2019, datë në të cilën është bërë dhe lirimi i tij nga detyra.

Referuar akteve shkresore të dosjes së ankuesit, rezulton se ndaj tij, vetëm për periudhën: gusht-tetor të vitit 2019, janë dhënë katër masa disiplinore (përfshirë edhe largimin nga detyra), ndërkohë që për periudhën e mëparëshme të punës nuk rezultojnë masa disiplinore ndaj tij.

Arsyetimi për largimin e tij nga puna ishte se ankuesi: *“Veprimet dhe mosveprimet e tij kanë shkaktuar pamundësinë e Bashkisë Gjirokastrër për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjin Nr. 9385/2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja shumë të rënda, me faj të rëndë të Përgjegjës të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në Bashkinë Gjirokastrër, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve Gusht e Shtator 2019”.*

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005),

*Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>16</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”.
- Ligji Nr. 9385/2005 “*Për pyjet dhe shërbimn pyjor*”, i ndryshuar.

## **KONKLUZIONE**

Në analizë të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masave disiplinore, Komisioneri gjykoi se:

- Nga ana e Bashkisë Gjirokastrë është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Bashkisë.
- Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur dhe analizimi i këtyre katër masave disiplinore, veçmas dhe bashkarisht, Komisioneri ka konstatuar se Bashkia ka konsumuar shkelje të rënda të parimit të barazisë dhe trajtimit të drejtë të ankuesit, dhe për asnjërin nga këto masa, Bashkia nuk provoi se ato kanë patur një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, apo që veprimet e saj, të kenë ndjekur një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Komisioneri, bazuar në analizimin e provave dhe bindjen e tij të brendshme, arriti në konkluzionin se kishte një lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike si anëtar i LSI-së dhe trajtimit të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u arrit të provohej një përligjje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj tij dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi i saj se largimi nga puna kishte ardhur, pasi në mënyrë të përsëritur nuk kishte zbatuar detyrat e ngarkuara nga ligji dhe Rregullorja e Brendshme e Agjencisë; rezultoi i pa bazuar në prova, i padrejtë dhe i paligjshëm. Rrjedhimisht, në sintezë të sa më lart, Komisioneri vlerësoi se

<sup>16</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.



subjekti ankues, i ishte nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

### ***VENDIMI***

Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, L.P., për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Bashkisë Gjirokastrër.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Bashkisë Gjirokastrër, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me L.P.

## 15. L.SH., kundër Bashkisë Mallakastër

**VENDIM NR. 83, DATË 10.08.2020**

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjekti ankues për 4 vite ka qenë punonjëse në Bashkinë e Mallakastrës dhe ka mbajtur pozicionin e “Magazinieres”. Me datë 16.01.2020, Bashkia Mallakastër ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, me motivacionin se pozicioni i saj i punës ishte suprimuar, por ankuesja ka pretenduar se ka ndodhur për shkak të bindjeve politike të saj të ekspozuara dhe të ndryshme nga ato të Kryetarit të Bashkisë.

### **FAKTET**

Subjekti ankues për 4 vite ka qenë punonjëse në Bashkinë e Mallakastrës dhe ka mbajtur pozicionin e “Magazinieres”. Me datë 16.01.2020, Bashkia Mallakastër ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, me motivacionin se pozicioni i saj i punës ishte suprimuar.

Ankuesja shprehet se nuk është e vërtetë që pozicioni i saj i punës është suprimuar, pasi në vend të saj është emëruar punonjësjë T.Sh., e cila nuk ka qenë fare pjesë e organikës së këtij insitucioni dhe ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Bashkisë Mallakastër, vetëm për shkak të bindjeve politike, pasi ajo është anëtare e subjektit politik PD dhe i ka të ekspozuara bindjet e saj politike, të ndryshme nga ato të punëdhënësit.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollu 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>17</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.

<sup>17</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

## **KONKLUZIONE**

Gjatë shqyrtimit të ankesës, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga palët, Komisioneri vlerësoi se:

- Nga krahasimi i bërë ndërmjet strukturës së vjetër dhe asaj të re dhe pozicioneve të punës të pasqyruara në to: pozicioni i magazinieres, që kishte mbajtur ankuesja jo vetëm nuk ishte suprimuar por përkundrazi ishte shtuar, pasi në strukturën e vjetër të Bashkisë Mallakastër kishte vetëm një pozicion “Magazinier”, ndërsa në strukturën e re, aktualisht ishin dy pozicione “Magazinier”.
- Rezultoi e provuar, se vetëm gjashtë ditë pasi ankuesja ishte larguar nga puna me motivacionin se pozicioni i saj i punës ishte suprimuar, Bashkia Mallakastër kishte emëruar në pozicionin “Magazinier” një punonjës tjetër. Qartazi u provua dhe dokumentua se pozicioni i punës “Magazinier” nuk ishte suprimuar, pasi në vend të ankuseses ishte emëruar një punonjës tjetër i Bashkisë.

Komisioneri gjykoi se, ajo ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe se masa e marrë ndaj saj për largimin nga puna, si rezultat i suprimimit të pozicionit të saj të punës ishte e pajustificuar dhe e pa bazuar në prova dhe në ligj.

Bashkia Mallakastër jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, ishin të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në kushtet kur, nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesen kishte ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se kjo masë kishte qenë e justifikuar dhe e drejtë; dhe nga ana tjetër ankuesja provoi dhe dokumentoi faktin që punëdhënsi kishte dijeni për bindjet e saj politike të ekspozuara publikisht, të ndryshme nga të tija; Komisioneri, në përfundim konstatoi se subjekti ankues, i ishte nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të saj politike.

## **VENDIMI**

Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

## 16. S.K., kundër Shërbimit Spitalor Skrapar

### VENDIM NR. 8, DATË 13.01.2020

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të autoambulancës, prej 12 vitesh. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Institucionit, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

#### **FAKTET**

Ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të ambulancës, prej 12 vitesh. Gjatë vitit 2017 e në vijim, ka patur në përdorim autoambulancën tip Volksäagen me targë AA 241 CP. Secila autoambulancë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar edhe ajo me të cilën ai punonte, përdorej nga 2 shofer me sistem turni 24-orësh.

Sipas informacionit të administruar në media, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, A.D., i cili ka bërë largimin e ankuesit nga puna, është pjesë e strukturave të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Gjithashtu, ankuesi ka paraqitur pranë KMD-së prova të mjaftueshme për të vërtetuar shkakun e diskriminimit të pretenduar të bindjeve politike.

Me emërimin në detyrë të A.D., në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, me urdhërin datë 17.01.2018, është ngritur Komisioni i Kontrollit të Karburantit të Automjeteve të Shërbimit Spitalor Skrapar, i përbërë nga T.S., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit Spitalor, A.N., me detyrë Përgjegjëse i Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit, si dhe në prani të drejtuesve respektiv të autoambulancave, më datë 05.03.2018, janë kryer kontrollet pjesëve të këmbimit për automjetet e institucionit.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ndaj drejtuesve të autoambulancave, mbi ndërrimin e pjesëve të këmbimit, janë gjetur në shkelje edhe drejtues të tjerë të autoambulancave, por ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë. Pavarësisht këtij fakti, edhe pse gjatë marrjes në dorëzim të automjetit nga servisi, kanë qenë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, nuk janë ngarkuar me përgjegjësi nga drejtuesit, por vetëm ankuesi.

Gjithashtu, nga ana e përfaqësuesve të Shërbimit Spitalor Skrapar, është pohuar se vetëm për ankuesin dhe shtetasin A.B., të cilët kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së, janë konstatuar



diferenca negative në konsumin e karburantit dhe nuk është paraqitur asnjë provë nëse për drejtuesit e tjerë të autoambulancave është kryer i njëjti verifikim.

Pavarësisht se nga ana e Komisionit të Auditit të Brendshëm të Shërbimit Spitalor Skrapar, janë konstatuar diferenca negative për të gjithë shoferët e tjerë të autoambulancave dhe mjeti që kishte në përdorim ankuesi, ka diferencën më të ulët të karburantit, ndaj tij është marrë masa e largimit nga puna.

Në kushtet që S.K., ka qënë drejtuesi i automjetit që ka tërhequr automjetin nga subjekti që ka kryer shërbimet, me vendimin Nr. 26, datë 12.04.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me të. Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar më datë 27.04.2018, ka paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, kallëzim për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, ndaj S.K.

Përsa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, vendosi “*Pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit S.K.,*” dhe rezultoi se asnjë nga pretendimet e ngritura ndaj shtetasit S. K., nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, nuk qëndrojnë dhe nuk janë të provuara.

Mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, janë ngarkuar me përgjegjësi, janë larguar nga puna, si dhe janë kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, A.B., dhe shtetasi S.K., të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me pretendim largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Pavarësisht faktit që gjatë marrjes në dorëzim të automjetit me targë AA 241 CP, nga servisi, kanë qënë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, asnjë prej tyre nuk është ngarkuar me përgjegjësi, por vetëm ankuesi.
- Komisioni për normën e konsumit të karburantit, i përbërë nga të njëjtët punonjës nga viti 2015 deri në vitin 2018, kanë vlerësuar të njëjtin konsum karburanti për 2 vite rradhazi, ndërsa me emërimin e A.D., në krye të Shërbimit Spitalor Skrapar, kanë ndryshuar qëndrim duke vlerësuar se autoambulanca që kishte në përdorim ankuesi ka një konsum më të ulët.
- Pavarësisht faktit që e njëjta autoambulancë është përdorur nga dy drejtues (shoferë), është penalizuar duke u larguar nga detyra vetëm ankuesi.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se S.K., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit S.K., nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, për shkak të bindjeve politike.

Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e S.K., në vendin e mëparshëm të punës.

**17. M.M., kundër Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe Zyrës Vendore Arsimore Dibër (ZVA Dibër)**

**VENDIM NR. 16, DATË 04.02.2020**

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i në formën e “udhëzimit për të diskriminuar” dhe i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesja ka punuar pranë DAR Dibër, prej vitit 1998, në pozicione të ndryshme dhe së fundmi në pozicionin e Juristes së institucionit. Për shkak të kundërshtimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019, ankuesja është larguar nga pozicioni i punës.

***FAKTET***

Ankuesja ka filluar punë pranë DAR Dibër, fillimisht në pozicionin Inspektor, më datë 01.09.1998. Nga viti 2004, ka ushtruar detyrën e Juristes pranë këtij institucioni, deri më datë 02.11.2015, kur është emëruar Përgjegjëse në Sektorin e Programeve të Zhvillimit. Më pas gjatë vitit 2016-2017 ka ushtruar sërish detyrën e Juristes së DAR Dibër. Në vitin 2017, ankuesja është emëruar në pozicionin e Drejtorit të DAR Dibër, të cilin e ka ushtruar deri më në fund të vitit 2018, kur është emëruar sërish në pozicionin e Juristes së institucionit.

Gjatë periudhës që ka drejtuar DAR Dibër, është njohur me disa ankesa të ardhura nga prindër e nxënës të gjimnazit “Said Najdeni”, të cilat lidheshin me numrin e lartë të nxënësve në klasë dhe ambjentet e pamjaftueshme për të përballuar këtë numër nxënësish. Në këto kushte, i është drejtuar me shkresa MASR-së, duke përcjellë ankesat e komunitetit të prindërve dhe nxënësve të gjimnazit “Said Najdeni”. Gjithashtu, në kushtet e mbylljes së Filialit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në Peshkopi (UAMD), godina e filialit mbeti bosh. Në këtë situatë, ka kërkuar nga ana e MASR shfrytëzimin e kësaj godinë për gjimnazin “Said Najdeni”, duke vendosur një pjesë të stafit dhe nxënësve të kësaj shkolle në këto ambjente.

Më pas, DAR Dibër ka ngritur Komisionin e vlerësimit të kërkesës për ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni”, në dy drejtori. Në vijim, DAR Dibër ka urdhëruar ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni” në dy të tillë, në “Said Najdeni” Peshkopi 1 dhe “Said Najdeni” Peshkopi 2. Në këtë kuptim, u krijua një drejtori shkolle më vete dhe nxënësit u ndanë në dy godina.

Nga ana e MASR nëpërmjet një grupi pune, u ushtrua kontroll në DAR Dibër dhe u konstatua se:

- Vendimi i marrë nga ana e DAR Dibër për ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni” në dy drejtori më vete është në kundërshtim me ligjin. Në këto kushte ka rekomandoi MASR-në të marrë masa për personat përgjegjës, të cilët kanë vendosur *“Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”*.
- MASR të marrë masën për *“Shkarkim nga detyra”* të Drejtorit të komanduar të DAR Dibër, A.H.
- Komisioni Disiplinor në MASR të fillojë ecurinë disiplinore për shtetasin A.H., drejtor i komanduar i DAR Dibër.

Përsa më sipër, DAR Dibër filloi menjëherë zbatimin e tij fillimisht duke shkarkuar drejtorin e komanduar dhe duke emëruar shtetasen B. D, e cila më parë mbante detyrën e përgjegjëses së Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, në këtë institucion. Ndër të tjera DAR Dibër urdhëroi anulimin e urdhërit Nr. 138, datë 22.10.2018 *“Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”*.

DAR Dibër nuk ndërmori asnjë masë ndaj personave përgjegjës, të cilët kanë vendosur *“Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”*, por bëri vetëm anulimin e urdhërit duke rikthyer gjimnazin në gjendjen e mëparshme.

Gjatë periudhës që ankuesja ushtronte detyrën e Juristes më datë 26.04.2019, Ministria e MASR, ka zhvilluar një takim në shkollën “Said Najdeni”. Në këtë takim të mbajtur, rezultoi që ankuesja kishte qënë prezent dhe kundërshtuar urdhërin Nr. 35, datë 04.04.2019 të ZVA Dibër për bashkimin e gjimnazit “Said Najdeni 1” dhe “Said Najdeni 2”, duke e konsideruar atë si një vendim të padrejtë dhe në dëm të nxënësve të qytetit të Peshkopisë. Sipas informacionit të administruar, në përgjigje të ankueses, Ministria është shprehur se: *“... nuk e di në cilin univers mund të ndodh që të protestojë punonjësi i Ministrisë kundër Ministres”*.

Pak ditë pas debatit të zhvilluar mes saj dhe Ministres së MASR, më datë 30.04.2019, ankuesja është vënë në dijeni në rrugë zyrtare, se ndaj saj ka nisur procedim disiplinor dhe është marrë vendimi për pezullimin nga detyra. Më pas me datë 14.05.2019, është vënë në dijeni vendimi për largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukurimit. Komisioneri konstatoi se pas debatit me Ministren e Arsimit, DPAP dhe ZVA Dibër janë përshkallëzuar masat ndaj ankueses deri në largimin nga shërbimi civil.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996

- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 2, 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 99, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPAP”.
- Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 5 dhe 50.
- VKM Nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

## **KONKLUZIONE**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se:

- Subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përse i takon mosemërimit të përkohshëm në pozicionin e Juristes së ZVA Dibër dhe fillimit të ecurisë disiplinore të nisur ndaj saj. Në këtë kuptim, trajtimi i pabarabartë ka nisur që me nisjen e ecurisë disiplinore, për të cilën nuk pati asnjë vendim përfundimtar për shkeljet për të cilat ishte akuzuar, dhe ka përfunduar me mosemërimin e saj njëloj si punonjësit e tjerë.
- DPAP dhe ZVA Dibër, si institucione varësie të MASR, kundrejt ankuses, kanë ardhur menjëherë pas ngjarjes së ndodhur me ministren e MASR. Këto masa jo vetëm që u përshkallëzuan deri në largimin nga shërbimi civil të saj, por duhet të theksohet fakti që u ndërморën vetëm ndaj ankuses dhe jo ndaj punonjësve të tjerë të cilët kishin qenë në kushte të ngjashme me të.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri gjykon se ngjarja e ndodhur mes ankuses dhe ministres së MASR, e cila u bë edhe publike në media, ka ndikuar në veprimet e institucioneve arsimore vartëse të MASR, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore Arsimore Dibër.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit në formën e “udhëzimit për të diskriminuar” të shtetas M.M., nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për shkak të kundërshtimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.



Konstatimin e diskriminimit në formën e “diskriminimit të drejtëpërdrejtë” të shtetasës M.M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore të Arsimore Dibër, për shkak të kundërshtimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa nga ana e strukturave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore të Arsimore Dibër, për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me shtetasen M.M.

**18. A.R., kundër Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a.,**

**VENDIM NR. 90, DATË 14.09.2020**

**Shkaku: Bindja politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Zbatuar**

Ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Mat sh.a., nga viti 2017 deri në vitin 2020. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi me Vendimin Nr. 9, datë 14.02.2020, është liruar nga detyra e faturistit, për shkak të bindjeve të tij politike.

***FAKTET***

Më 2017, A.R., është emëruar në pozicionin Faturist në Njësinë Administrative Ulëz. Pak ditë pas emërimit të A.Th., me Vendim Nr. 16, datë 25.09.2019, ankuesi është transferuar nga pozicioni i Faturistit të Njësisë Administrative Ulëz, në atë të Manovratorit Qëndror Klorifikues pranë Njësisë Administrative Lis. Në vendimin e sipërcituar, u evidentua se A.R., ka refuzuar të firmosë transferimin në këtë pozicion pune. Për shkak të largësisë nga vendbanimi, ka kërkuar në rrugë verbale nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a., të kalojë sërish në pozicionin e punës që mbante më parë, në atë të Faturistit në Njësinë Administrative Ulëz. Pak kohë më pas, me Vendimin Nr. 30, datë 09.10.2019, të Administratorit të Shoqërisë, ankuesi është rikthyer sërish në pozicionin e Faturistit në Njësinë Administrative Ulëz.

Me Vendimin Nr. 27, datë 22.11.2019, të Këshillit të Administrimit, është miratuar Struktura Organike e Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a., duke reduktuar numrin e punonjësve nga 78, që ishte në Strukturën e mëparshme të miratuar me Vendim Nr. 21, datë 24.12.2018, në 55 punonjës.

Pas miratimit të Strukturës Organike të sipërcituar, ankuesi është njoftuar nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a., për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënies të punës, si dhe faktin që duhet të paraqitet për bisedime paraprake pranë punëdhënësit brenda një afati prej 3 (tre) ditësh. Në takim të realizuar më datë 11.12.2019, referuar Procesverbalit të mbajtur me Nr. 6 prot., ankuesi është njohur me faktin e reduktimit të numrit të pozicioneve të punës në strukturën organizative, për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a.

Në vijim, është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies të punës, për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative dhe reduktimin e numrit të punonjësve të Shoqërisë. Më pas me Vendimin Nr. 9, datë 14.02.2020, Shoqëria Ujësjetllës Mat sh.a., ka bërë ndërprerjen e

marrëdhënieve të punës me ankuesin, me motivacion “*Shkurtim i vendit të punës si pasojë e ristrukturimit*”.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolle 12 i saj.)
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.

### **KONKLUSIONE**

Në analizë të Strukturës Organike të Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a., miratuar më datë 22.11.2019, krahasuar me Strukturën Organike të miratuar më parë me Vendim Nr. Nr. 21, datë 24.12.2018, konstatohet se:

- Numri total i punonjësve është reduktuar nga 86 në 55 punonjës .
- Pozicionet e Faturistëve, nuk janë më të specifikuar për secilën Njësi Administrative të Bashkisë Mat, siç ishin në Strukturën e mëparshme, por janë të grupuar në Sektorin Teknik Fshat.
- Në ndryshim nga Struktura e mëparshme ku përcaktohej pozicioni Faturistët për secilën Njësi Administrative, emërtimi i tyre në Strukturën e re është bërë Faturist dhe Mirëmbajtës në Njësitë Administrative.
- Numri i pozicioneve Faturist, në Drejtorinë Teknike të Shoqërisë, ka qënë 4, ndërsa në Strukturën e re të miratuar në vitin 2019, është shtuar emërtimi Faturist dhe Mirëmbajtës në Njësitë Administrative, është rritur niveli i pagës, si dhe numri i tyre tashmë ka shkuar në 5.
- Në analizë të 2 Strukturave Organizative të Shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a., nuk shihet ndonjë reduktim i pozicioneve të punës Faturist, apo ndonjë ndryshim në kualifikimet dhe eksperiencën që kërkohet për këto pozicione pune.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:



- Ujësjetës Mat sh.a., nuk provoi se ndaj A.R., të jetë marrë ndonjë masë disiplinore, apo të jetë konstatuar dëm për moskryerjen e detyrave nga ana e punëdhënësit, po ashtu nuk ka dhe vlerësime të performancës në punë. Gjithashtu, nga ana e Shoqërisë Ujësjetës Mat sh.a., nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit, kopje të vlerësimeve të punës, lidhur me detyrat e realizuara nga A.R.
- Nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me A.R., është bërë për shkak të shkurtimeve të pozicioneve të punës Faturist. Pra, Shoqëria Ujësjetës Mat sh.a., dështoi për të provuar përpara që në Njësinë Administrative Ulëz, nuk ekziston më pozicioni i punës Faturist dhe kjo detyrë mbulohet nga një punonjës tjetër apo është reduktuar.

Përsa i përket bindjeve politike të A.R., bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që është anëtarë i Partisë Demokratike të Shqipërisë që në vitin 2017.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Mat u zgjodh A.M., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Pak kohë pas emërimit të tij në detyrë, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjetës Mat sh.a., u emërua A.Th., (datë 10.09.2019). Administratori i ri, 15 ditë kalendrike pas emërimit në detyrë ka filluar procedurën e transferimit të ankuesit nga një pozicion pune në tjetrin, si dhe në përfundim e ka larguar nga pozicioni i punës që mbante, me pretendimin e reduktimit në Strukturën Organizative, pavarësisht se nuk u provua një fakt i tillë. Ankuesi ka depozituar prova të mjaftueshme lidhur me bindjet e tij politike të kundërta me Administratorin e Shoqërisë.

Fakti se transferimi i ankuesit nga një pozicion pune në tjetrin ka nisur (rreth 15 ditë) nga emërimi i Administratorit të ri dhe që pozicioni në të cilin ishte transferuar ankuesi ishte në kushte më pak të favorshme, ngre dyshimin e arsyeshëm se veprimi i mësipërm është bërë në dëm të subjektit ankues, duke përkeqësuar situatën e tij profesionale dhe duke bërë të vështirë aksesin në punë për shkak të largësisë me vendin e banimit.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit A.R., nga ana e Shoqërisë Ujësjetës Mat sh.a., për shkak të bindjes politike.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Shoqërisë Ujësjetës Mat sh.a., të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me A.R.

## 19. F.F., kundër Ujësjiellës Kanalizime Mat sh.a.

### VENDIM NR. 144, DATË 26.10.2020

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Zbatuar

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Mat sh.a., nga viti 2015 deri në vitin 2020. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesja, është liruar nga detyra e Llogaritar/Arkëtar/Pagator/Operator në Ujësjiellës Mat sh.a., për shkak të bindjeve të saj politike.

### **FAKTET**

Më 2015, F.F., është emëruar në pozicionin Specialiste/Protokoll/Arkiviste pranë Ujësjiellës Kanalizime Mat sh.a.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Mat u zgjodh A.M., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Me Vendimin Nr. 25, datë 10.09.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ujësjiellës Mat sh.a., A.Th., është emëruar në detyrën si Administrator i Shoqërisë.

Rreth 2 muaj pas emërimit të A.Th., në pozicionin e Administratorit të Ujësjiellës Mat sh.a., me Vendim Nr. 35, datë 12.11.2019, ankuesja është transferuar nga pozicioni i Specialiste/Protokoll/Arkiviste, në atë të Specialistes së Marrëdhënieve me Klientin dhe Ndihmës Arkëtare.

Me Vendimin Nr. 27, datë 22.11.2019, të Këshillit të Administrimit, është miratuar Struktura Organike e Shoqërisë Ujësjiellës Mat sh.a., duke reduktuar numrin e punonjësve nga 78, që ishte në Strukturën e mëparshme të miratuar me Vendim Nr. 21, datë 24.12.2018, në 55 punonjës.

Pas miratimit të Strukturës Organike të sipërcituar, ankuesja është njoftuar nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Mat sh.a., për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe faktin që duhet të paraqitet për bisedime paraprake pranë punëdhënësit. Në takimin e realizuar, ankuesja është njohur me faktin e reduktimit të numrit të pozicioneve të punës në strukturën organizative, për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të Shoqërisë Ujësjiellës Mat sh.a. Gjatë diskutimeve të zhvilluara në takim, ankuesja ka kërkuar nga ana e punëdhënësit arsyen e transferimit të saj, si dhe i ka bërë me dije se ky transferim ishte i qëllimshëm për ta larguar nga puna dhe për asnjë arsye tjetër.

Në vijim, ankuesja është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative dhe reduktimin e numrit të punonjësve të Shoqërisë. Më pas me Vendimin Nr. 1, datë 14.02.2020, Shoqëria Ujësjetllës Mat sh.a., ka bërë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen, me motivacion “*Shkurtim i vendit të punës si pasojë e ristrukturimit të Shoqërisë*”.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Duke marrë në analizë Strukturën e re Organizative, konstatohet se:

- Pozicioni i Specialistit Protokoll/Arkiv, nuk është shkrirë
- Lidhur me arsimin e kërkuar për këtë pozicion pune, nuk ndryshoi asnjë kriter.
- Ndërsa sa i përket pozicionit të punës në të cilin është transferuar ankuesja, Specialiste e Marrëdhënieve me Klientin dhe Ndhimës Arkëtare, evidentohet se Struktura e mëparshme kishte 2 pozicione të tilla, ndërsa pas ndryshimeve të pësuar, një prej pozicioneve u reduktua.

Komisioneri vlerësoi se nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Mat nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se transferimi i ankueses nga pozicioni i Specialistes së Protokoll/Arkiv në atë të Specialistes së Marrëdhënieve me Klientin dhe Ndhimës Arkëtare dhe largimi i saj nga puna është bërë për arsye të përligjura dhe të justifikuara. Pra, krijohet dyshimi i arsyeshëm se transferimi i nga pozicioni i Specialistes së Protokoll/Arkiv në një pozicion që do të shkurtohej me strukturën e re, atë të Specialistes së Marrëdhënieve me Klientin dhe Ndhimës Arkëtare, është bërë me synimin për ta larguar ankuesen përfundimisht nga puna.

Fakti se transferimi i ankuses nga një pozicion pune në tjetrin ka nisur (rreth 2 muaj) nga emërimi i Administratorit të ri dhe që pozicioni në të cilin ishte transferuar me strukturën e re do të reduktohej, ngriti dyshimin e arsyeshem se veprimi i mësipërm është bërë në dëm të subjektit ankues, duke përkeqësuar situatën e saj profesionale dhe duke e larguar nga puna.

Referuar informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të të disa ankesave të tjera të trajtuara nga KMD, është konstatuar se pak kohë pas pas emërimit të A.Th., në krye të Ujësjellës Mat sh.a., ndaj ankuses dhe disa punonjësve të tjerë të këtij institucioni, kanë nisur procedurat për transferimin e tyre nga një pozicion në tjetrin apo largimin e tyre nga funksionet që ushtronin. Në analizë të tyre, Komisioneri ka konstatuar se, pretendimet e punonjësve të sipërcituar, lidheshin me faktin se transferimet apo largimeve e tyre nga puna ishin bërë për shkak të bindjeve të kundërta politike me Administratorin e Ujësjellës Mat sh.a., A.Th. Ankuesja ka depozituar prova të mjaftueshme lidhur me bindjet e saj politike të kundërta me Administratorin e Shoqërisë.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi të vogël në numër, siç është qyteti i Burrelit, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrin dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit F.F., nga ana e Shoqërisë Ujësjellës Mat sh.a., për shkak të bindjes politike.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Shoqërisë Ujësjellës Mat sh.a., të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me F.F.

## 20. SH.M., kundër Bashkisë Përmet

**VENDIM NR. 150, DATË 27.10.2020**

**Shkaku: Bindja politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Përmet, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit, ankuesja është liruar nga detyra, për shkak të bindjeve të saj politike.

### ***FAKTET***

Ankuesja më 2014 ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Përmet dhe ka mbajtur detyrën e Administratores së Ndhmës Ekonomike dhe Punës Sociale.

Me emërimin e A.H., në krye të Bashkisë Përmet, më datë 02.08.2019, me urdhërin Nr. 219, të saj, zyrat e Njesisë Administrative Frashër u transferuan sërish në zyrat e mëparshme të ish-Komunës Frashër, të cilat ishin jashtë funksionit prej 10 vitesh. Zyrave të ish-Komunës Frashër, i mungonte infrastruktura e nevojshme për realizimin e detyrave funksionale.

Rreth një muaj më vonë, Kryetarja e Bashkisë Përmet, ka liruar ankuesen nga e drejta e ushtrimit të detyrës së Specialistes së Arshiv-Protokollit të Njesisë Administrative Frashër dhe ka urdhëruar vetëm ushtrimin e funksionit të Specialistes së Ndhmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar.

Në vijim, shkresërisht, ankuesja i është drejtuar Kryetares së Bashkisë Përmet dhe Këshillit Bashkiak, duke i informuar lidhur me vështirësitë e ushtrimit të detyrës në zyrat e Njesisë Administrative Frashër, për shkak të mungesës së kushteve kryesore, si psh: mungonte baza materiale; tualeti ishte jashtë ndërtesës dhe i përbashkët për meshkuj dhe femra, si dhe ishte në gjendje të rënduar; dritaret ishin të thyera; ishte rreth 50 km larg qendrës së Përmetit; nuk kishte transport publik etj.

U evidentua se nga ana e Këshillit Bashkiak Përmet është parashikuar një sasi karburanti në shërbim të lëvizjeve për automjetet e Njesisë Administrative. Pavarësisht kësaj, nuk rezulton e provuar që punonjësve të Njesisë Administrative Frashër, si një njësi që ndodhet rreth 50 kilometra larg nga qyteti i Përmetit, t'u jetë vënë në dispozicion një mjet transporti për të ushtruar detyrën në zyrat e Njesisë Frashër.

Më pas, Kryetarja e Bashkisë Përmet, kishte urdhëruar lirimin e ankueses nga detyra e Specialistes së Ndhmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar dhe emërimin e saj në pozicionin e Punonjësës së Bujqësisë dhe Mjedisit në Njesisë Administrative Frashër.

Me shkresën Nr. 19 prot., datë 07.01.2020, ankuesja është njoftuar nga ana e punëdhënësit, për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës dhe është bërë me dije për paraqitjen e saj më datë 10.01.2020 në takimin që do të mbahej për vijim e marrëdhënie të punës. Në takimin e zhvilluar më datë 10.01.2020, ankuesja ka sqaruar punëdhënësin se e ka pasur të pamundur të shkojë në zyrat në Njësinë Administrative Frashër, për shkak të mungesës së transportit publik dhe largësisë. Për këtë, ankuesja i ka sqaruar se ka vënë në dijeni edhe kryetaren nëpërmjet shkresës zyrtare, por që nuk është marrë asnjë masë.

Përsa më sipër, me urdhërin Nr. 20, datë 16.01.2020, Bashkia Përmet ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesen, për shkak të mungesës së vijueshme për më shumë se 7 (shtatë) ditë në vendin e punës.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.

### **KONKLUSIONE**

Mbështetur në provat e administruara, sapo A.H., ka marrë detyrën e Kryetares së Bashkisë Përmet, ka nisur veprimet që kanë sjellë pasoja për ankuesen, duke bërë:

- Zhvendosjen e zyrave të Njësisë Administrative Frashër në zyrat e ish-Komunës Frashër, e më pas në Njësinë Administrative Qendër Piskovë;
- Bërjen të pamundur të ushtrimit të detyrës nga ankuesja, për shkak të mungesës së transportit dhe aksesimit të zyrave të Njësinë Administrative Frashër;
- Transferimin e saj nga një pozicion pune në tjetrin pa një justifikim të arsyeshëm;
- Largimin nga puna për shkak të mungesave, pavarësisht faktit që ajo ka informuar punëdhënësin për pamundësinë e udhëtimit drejt Njësisë Administrative Frashër, për të cilat nuk ka marrë asnjë herë përgjigje.

E njëjta titullare, A.H., në vitin 2014, kohë kur ka mbajtur detyrën e Përgjegjëses së Zyrës Arsimore Përmet, ka larguar ankuesen nga detyra e Përgjegjëses së Statistikës në ZA Përmet. Pas largimit nga detyra e Përgjegjëses së Statistikës në ZA Përmet, ankuesja i është drejtuar me kërkesë padi organeve gjyqësore (Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Gjykatës së Apelit Administrativ), të cilat në përfundim të shqyrtimit janë shprehur për paligjshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe kanë caktuar dëmshpërblimin përkatës ndaj ankuseses.

Referuar informacionit të administruar, ankuesja ka mbajtur pozicionin e Kryetares së Partisë Agrare Ambientaliste të Përmetit, subjekti politik i cili ka qënë pjesë e grupit të opozitës së bashkuar që është udhëhiqur nga Partia Demokratike në zgjedhjet lokale të vitit 2019.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit, të shtetases Sh.M., nga ana e A.H., në cilësinë e Kryetares së Bashkisë Përmet, për shkak të bindjes politike.

## 21. E.Z., kundër Bashkisë Bashkisë Mallakastër

**VENDIM NR. 117, DATË 18.11.2020**

**Shkaku:** Bindja politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka konkuruar dhe ka punuar fillimisht në pozicionin Specialist (inxhinier mjedisi), Sektori i Pyjeve dhe i Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër. Në vijim, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, E.Z., është emëruar në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër. Pas ardhjes në detyrë në vitin 2019, të kryetarit të ri të kësaj Bashkie, ai është larguar nga puna.

### **FAKTET**

Pretendimi për diskriminim i ankuesit konsiston në 3 momente, ku i pari ka të bëjë me largimin e tij nga detyra, momenti i dytë konsiston në mos dhënien e vendimit të Komisionerit për Mbikqyrjen në Shërbimit Civil (KSHC-së) nga ana e Bashkisë Mallakastër dhe momenti i tretë konsiston në mos sistemimin e tij në një pozicion tjetër pranë Bashkisë Mallakastër.

Në datën 08.09.2017, ankuesi E.Z., është emëruar nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin Specialist (inxhinier mjedisi), Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, Drejtoria e Mjedisit, pranë Bashkisë Mallakastër. Në vijim, me urdhër të ish-Kryetarit të Bashkisë ka kaluar në pozicionin e përgjegjës të këtij sektori. Ky fakt është konstatuar si shkelje dhe paligjshmëri nga ana e Komisionerit për Mbikqyrjen në Shërbimit Civil, që nëpërmjet vendimit të tij, ka kërkuar nga Bashkia Mallakastër vendosjen e lighshmërisë për rastin e E.Z., sikurse edhe për disa raste të tjera, të ngjashme me atë të ankuesit. Në zbatim të vendimit të sipërcituar, Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë masat përkatëse për vendosjen e ligjshmërisë në administrimin civil. Për rastin konkret, ka filluar procedurën për largimin nga puna të E.Z., dhe të disa punonjësve të tjerë të cituar në vendimin e KMSHC-së. Ankuesi ka kërkuar zyrtarisht një kopje të Vendimit të KMSHC, por Bashkia Mallakastër ka refuzuar t'ia japë. Në vijim të largimit nga puna, ankuesi pretendon se nuk është sistemuar në vendet vakante ekzistuese të këtij institucioni.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 & 49;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;



- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,

### **KONKLUZIONE**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri gjykoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Mallakastër, për shkak të bindjes së tij politike.

Bashkia Mallakastër nuk ka kryer një propozim konkret dhe nuk e ka sistemuar E.Z., edhe pse ka patur mundësinë, në pozicionin e mëparshëm të punës si specialist mjedisi pranë të njëjtit sektor, në kushtet kur ky pozicion ka qenë vakant në periudhën në fjalë. Një procedurë të tillë, Bashkia Mallakastër e ka zbatuar në një rast tjetër analog me ankuesin. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Bashkia Mallakastër ka dështuar për të provuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm, apo të pabarabartë të ankuesit, si dhe nuk ka demonstruar se megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

### **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të E. Z., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Mallakastër.

## 22. L.Gj., kundër E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe E.D., Kryetar i Bashkisë Berat

**VENDIM NR. 44, DATË 12.05.2020**

**Shkaku: Bindja politike & raca**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Ankuesja L.Gj., është punuar në pozicionin e Sekretares së Këshillit Bashkiak Berat, që prej vitit 2015. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë Berat dhe krijimit të Këshillit të ri Bashkiak, ajo është larguar nga puna.

### ***FAKTET***

L.Gj., është emëruar në datën 04.08.2015, në pozicionin e Sekretares së Këshillit Bashkiak me vendim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak Berat. Ndërmjet palëve nuk është lidhur një kontratë individuale pune, por në kushtet kur Ligji Nr. 139/2019 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk shprehet për detaje rregulluese mbi marrëdhëniet e punës për këtë pozicion pune, konsiderohet e mirëqenë që marrëdhëniet e punës së L.Gj., rregullohen nga dispozitat përkatëse të Kodit të Punës.

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019 dhe me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Berat E.D., si dhe krijimin e Këshillit të ri Bashkiak me në krye E.C., L.Gj., lirohet menjëherë nga detyra. Në datë 05.08.2019, ankuesja shkarkohet nga detyra të vendim të Këshillit Bashkiak. Në vijim, Kryetari i Bashkisë Berat urdhëron përfundimin e marrëdhënieve të saj financiare.

### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 & 49;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Kodi i Punës, neni 9;
- Ligji Nr. 139/2019 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,
- Vendimi Nr. 00-2014-854 (51), datë 28.01.2014, i Gjykatës së Lartë.

## ***KONKLUSIONE***

Komisioneri doli në përfundimin së Këshilli Bashkiak Berat në asnjë moment nuk justifikoi dhe motivoi largimin nga puna të ankueses dhe zëvendësimin e saj nga një punonjëse që i përket subjektit politik PS. Komisioneri gjykon se veprimet e ndërmarra nga këto dy subjekte kanë reflektuar faktin se pozicioni i Sekretarit të Këshillit Bashkiak Berat është konsideruar si post politik, edhe pse në asnjë akt ligjor dhe nënligjor nuk është përcaktuar si i tillë. Në këto kushte rezulton se është shkarkuar nga detyra pa asnjë motivacion një punonjëse, e cila i përket forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në vend të saj është emëruar një anëtare e subjektit politik në pushtet.

Referuar Protokollit të mbledhjes së datës 05.08.2019, rezulton se këshilltarët e Partisë Socialiste të Këshillit Bashkiak Berat kanë propozuar B.A., në pozicionin e punës së znj. L.Gj. Referuar CV se B.A., të publikuar në faqen zyrtare të KQZ rezulton se ajo është aktiviste e Partisë Socialiste, si dhe është propozuar nga kjo forcë politike, për anëtare të Këshillit Bashkiak Berat në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Njëkohësisht, referuar të njëjtit dokument ajo është edhe sekretare organizative e FRESSH Berat.

KMD gjykoi gjithashtu se nuk ka një lidhje shkakësore ndërmjet shkarkimit të ankueses me përkatësinë e saj në komunitetin egjiptian.

## ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të L.Gj., për shkak të bindjes politike, nga Këshilli Bashkiak Berat.

Konstatimin e mosdiskriminimit të L.Gj., për shkak të racës, nga Këshilli Bashkiak Berat.

### 23. Sh.Q., kundër Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)

**VENDIM NR. 22, DATË 25.02.2020**

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi, Sh.Q., nëpunës civil, u liruar nga shërbimi civil duke përfunduar marrëdhënien e tij të punës, pas dy vlerësimeve negative. Vlerësimi i rezultateve në punë nuk ishte bërë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe ankuesi ishte vlerësuar negativisht në lidhje me rezultatet e tij në punës, për shkak të bindjeve të tij.

#### **FAKTET**

Ankuesi ka filluar punë pranë AZHBR-së në datë 30.01.2014 duke u emëruar si Inspektor në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare dhe në datë 25.02.2014, ankuesi ka kaluar në pozicionin Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit në AZHBR. Ankuesi ka marrë statusin e nëpunësit civil 22.05.2017. Në datën 26.01.2018 pas ristrukturimit të AZHBR-së ankuesi është transferuar Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në momentin e lirit nga shërbimi civil.

Ankuesi është liruar nga shërbimi civil në datë 19.08.2019 pas dy vlerësimeve negative (jokënaqshëm) radhazi, bazuar në nenin 66/1/c të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikës 22 dhe 25 të Kreut III, të VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” si dhe VKM Nr. 109 datë 26.02.2014 “Për vlerësimin rezultateve në punë të nëpunësve civil”, të ndryshuar. Dy vlerësimet jokënaqshëm radhazi për të cilat ankuesi është liruar nga shërbimi civil janë: vlerësimi i parë negativ i përket periudhës 01.07.2018 deri 31.12.2018 dhe vlerësimi i dytë negativ i përket periudhës 01.01.2019 deri 30.06.2019.

Rezultoi e provuar se ankuesi e mbarte shkakun e pretenduar, pasi në bazë të Kartës Anëtarësimi të lëshuar më datë 12.17.2012, nga strukturat e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në Njësinë Nr. 8, Tiranë, ankuesi është anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Ankuesi pretendoi se këto vlerësime nuk ishin bërë në përputhje me kërkesat ligjore dhe se në asnjë moment nëpunësi nuk ka provuar se ai si nëpunës civil nuk ka zbatuar detyrat që i janë caktuar apo që ai nuk është i aftë të përmbush detyrat funksionale dhe rezultatet e

dobëta. Sipas ankuesit lirimi i tij nga shërbimi civil ishte pasojë e bindjeve të tij politike, pasi ai ishte anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 66,
- VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”.
- VKM Nr. 109 datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”,

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se, dy vlerësimet radhazi negative të ankuesit që kishin sjellë lirimin e tij nga shërbimi civil nuk ishin realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit “Për nëpunësin civil” dhe aktet e tij nënligjore. AZHBR nuk provoi në asnjë moment me prova dhe fakte konkrete performancën e dobët të ankuesit. Në kushtet kur AZHBR dështoi për të provuar me fakte dhe prova performancën e dobët në punë të ankuesit, nga ana tjetër rezultoi e pruvuar se, se për të njëjtat periudha vlerësimi ankuesi ka punuar në pjesën më të madhe të kohës me dy inspektorë të tjerë performanca e të cilëve ishte vlerësuar e tillë që të përligjë vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës.

Rasti i vetëm i provuar nga AZHBR kur ankuesi nuk kishte realizuar ashtu siç duhej detyrat e tij funksionale dhe ndaj tij për këtë arsye është marrë masë disiplinore ishte rasti i një subjekti, kur dëmi i shkaktuar ishte rregulluar dhe ajo që në thelb kërkohet nga rregullorja e brendshme e institucionit, pra dokumentacioni shkresor ishte mbajtur në rregull, por ishte pasqyruar gabim në sistemin elektronik që në bazë të rregullores ka funksion mbështetës. Kjo masë disiplinore, e cila ishte marrë edhe ndaj një inspektori tjetër, nuk kishte ndikuar për këtë të fundit në vlerësimin e tij me 4 “jokënaqshëm” por vetëm për vlerësimin jokënaqshëm të ankuesit. Gjatë shqyrtimit AZHBR nuk vendosi në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar dhe vecanërisht vlerësimet e punës për dy inspektorët e tjerë më të cilët kishte punuar ankuesi.

Ardhja e drejtuesit të ri të AZHBR përkon me momentin kur në vlerësimin e punës së ankuesit vihet re një ndryshim i konsiderueshëm në vlerësimin e tij, nga vlerësimi me 2 “mire” në vlerësimin me 4 “jokënaqshëm”. Nga ana tjetër titullari i ri i AZHBR-së rezultoi që të ishte një person i cili në mënyrë të hapur kishte bërë publike lidhjet me subjektin politik Partia Socialiste, duke qënë pjesë e Këshillit Bashkiak të Tiranës.



## ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit Sh.Q., në të drejtën për punësim për shkak të bindjeve politike, nga ana e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Në referim të pikës 1, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e ankuesit Sh.Q., në pozicionin Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit, pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

## 24. L.Ç., kundër Bashkisë Gjirokastër

### VENDIM NR. 43, DATË 29.04.2020

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Ankuesi u largua nga puna me pretendimin se, në mënyrë të përsëritur kishte shkelur detyrimet kontraktore, me faj të rëndë, të cilat nuk rezultuar të provuara. Gjithashtu, procedurat e ndjekura nga punëdhënësi, për dhënie e masave disiplinore kishin cënuar rëndë të drejtën e ankuesit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

### **FAKTET**

Ankuesi L.Ç., ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Gjirokastër, me detyrë "Inspektor terreni" në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisor. Ankuesi ka filluar punë në datë 15.05.2018 dhe ka vazhduar të punojë në këtë pozicion, deri në datën 23.10.2020, kur është liruar nga detyra.

Bashkia Gjirokastër ka zgjidhur kontratën e punës me ankuesin në mënyrë të menjëhershme, duke pretenduar se, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ankuesi ka shkaktuar pamundësinë e Bashkisë Gjirokastër, për të përmbushur funksionet ligjore, duke sjellë pasoja shumë të rënda, me faj të rëndë, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve gusht - shtator 2019. Për periudhën gusht – tetor 2019, ndaj ankuesit ishin marrë 3 masa disiplinore dhe më datë 22 tetor 2019, ankuesi ishte larguar nga puna.

Përpara kësaj periudhe ankuesi nuk kishte asnjë masë disiplinore ose vlerësim negative në punë. Ankuesi i kundërshton arsyet e largimit nga puna dhe pretendon se ka kryer punën me korrektësi dhe se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, të cilat janë të kundërta me ato të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, i cili ishte zgjedhur në këtë detyrë, në Zgjedhjet për Pushtetin Vendor, të zhvilluara në qershor 2019, si përfaqësues i Partisë Socialiste.

Rezultoi se, ankuesi ishte anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe në vite ai kishte mbajtur dhe vazhdonte të mbante funksione drejtuese pranë Degës Gjirokastër të Partisë LSI. Në zgjedhjet lokale të viti 2015, ankuesi kishte kandiduar për anëtar të Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Pjesë e strukturave drejtuese të LSI Dega Gjirokastër, kishin qenë dhe vazhdonin të ishin anëtarë të familjes së ankuesit, bashkëshortja dhe djali i tij.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9.

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se: arsyeja e deklaruar nga Bashkia Gjirokastrë për largimin e ankuesit nga puna nuk rezultoi e provuar dhe për rrjedhojë zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk rezultoi të ketë një shkak të ligjshëm, pasi masat disiplinore dhe shkeljet e pretenduara nuk u provuan nga Bashkia Gjirokastrë; ankuesit i është mohuar në mënyrë të përsëritur e drejta për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për të paraqitur fakte dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij, konform procedurës së parashikuar nga neni 37 i Kodit të Punës; ankuesi nuk ka patur asnjë masë disiplinore dhe se përkeqësimi i pretenduar i performancës në punë për ankuesin kishte ndodhur në mënyrë të menjëhershme dhe të pargumentuar, me ardhjen e drejtuesve të rinj; punonjësit e tjerë të proceduar me masa disiplinore, rezultuan të jenë edhe ata sikundër ankuesi anëtarë të Partisë LSI.

Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijonin prezumimin se, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, Bashkia Gjirokastrë, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Gjirokastrë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkakun i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

### **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit L.Ç., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.





Në referim të pikës 1, Bashkia Gjirokaštër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin L.Ç., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

## 25. E.O., kundër Bashkisë Kavajë

### VENDIM NR. 108, DATË 11.09.2020

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesja u largua nga puna me motivacionin e moskryerjes së detyrave funksionale të pozicionin e saj të punë, fakt i cili nuk rezultoi i provuar. Gjithashtu, procedurat e ndjekura nga punëdhënësi, për zgjidhjen e kontratës së punës kishin cënuar rëndë të drejtën e ankueses për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

#### **FAKTET**

Ankuesja E.O., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkinë Kavajë me detyrë “Inspektore” në Agjencinë e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore. Marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe Bashkisë Kavajë kanë zgjatur nga data 07.09.2017 deri në datën 05.02.2020 kur ankuesja është larguar nga puna.

Ankuesja ka qenë e punësuar në pozicione të ndryshme pune pranë Bashkisë Kavajë. Ajo fillimisht ka filluar punë ë në detyrën “Specialiste Biblioteke”, në Sektorin e Zhvillimit të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve pranë Bashkisë Kavajë, ku ka punuar deri në datën 04.03.2019. Në datë 04.3.2019, ankuesja është emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjëse” në Sektorin e Kalendarit, Programeve dhe Ngjarjeve Kulturore dhe Artistike, Vlerësimit të Projekteve Kulturore, në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve. Ajo ka qëndruar në këtë pozicion pune deri në datën 06.09.2019. Në vijim në datë 06.9.2019 ankuesja është transferuar në detyrën “Përgjegjëse”, në Sektorin e Zhvillimit të Turizmit, Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Trashëgimisë Kulturore, në Drejtorinë e e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve. Ankuesja ka qëndruar në këtë detyre deri në datën 18.10.2019, pra rreth 1 muaj e 12 ditë dhe më pas ajo është transferuar në detyrën “Inspektore” në Agjencinë e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore. Ankuesja ka punuar në këtë pozicion pune deri në datën 04.02.2020, kur është larguar nga puna. Gjatë kohës që ka punuar pranë Bashkisë Kavajë, ankuesja nuk ka asnjë masë disiplinore.

Bashkia Kavajë ka vendosur lirim nga detyra të ankueses për shkak të moskryerjes së detyrës funksionale në pozicionin e saj të punës si dhe moskryerjen e detyrave të caktuara nga eprori për inspektimin në terren të kopshteve dhe shkollave. Ankuesja e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, të kundërta me ato të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, i cili ishte

zgjedhur në këtë detyrë, në Zgjedhjet për Pushtetin Vendor, të zhvilluara në qershor 2019, si përfaqësues i Partisë Socialiste.

Rezultoi se, ankuesja ishte anëtare e Partisë Demokratike dhe kishte kishte një angazhim në aktivietë publike të zhvilluara nga kjo forcë politike në Bashkinë Kavajë.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9.

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna, nuk rezultoi e provuar. Rezultoi se ankuesja ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i saj nga puna ishte bërë pa një shkak të ligjshëm dhe në shkelje të plotë të procedurës dhe afateve të parashikuara nga Kodi i Punës.

Punonjësja e cila kishte zëvendësuar ankuesen ishte punësuar në datë 04.02.2020, pra në të njëjtën ditë kur është larguar nga puna ankuesja. Në harkun kohor prej 5 muajsh, duke filluar nga data 06.09.2019 deri në datën 04.2.2020 kur ka ndodhur largimi nga puna, ankuesja ishte transferuar në 2 pozicione të ndryshme pune, pa pëlqimin e saj. Ajo kishte pranuar dhe kishte vazhduar të punonte pasi kishte nevojë për të ardhura për të siguruar jetesën. Në transferimin si “Inspektore” ankuesja kishte pësuar ulje në detyrë, pasi ajo ishte transferuar nga “përgjegjëse sektori” që është një pozicion më i lartë, në “Inspektore” dhe se ky transferim ishte shoqëruar me ulje në pagë.

Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijonin prezumimin se, largimi i saj nga puna ishte kryer për motive politike, Bashkia Kavajë, e cila kishte barrën e provës që të provonte,

ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankueses se këto veprime ishin kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Kavajë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja, pra bindjet politike.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të ankueses E.O., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.

Në referim të pikës 1, Bashkia Kavajë të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesen E.O., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

## 26. O.S., kundër Bashkisë Përmet

**VENDIM NR. 156, DATË 02.11.2020**

**Shkaku:** Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesja u largua nga puna me pretendimin se, emërimi i saj si Drejtore Kopshti kishte qenë i pavlefshëm, pasi nuk ishte bërë nëpërmjet procedurave të konkurimit, sipas parashikimeve të akteve nënligjore, të dala në zbatim të ligjit Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ky pretendim i Bashkisë Përmet, rezultoi i pabazuar. Gjithashtu, punëdhënësi kishte dështuar që të trajtonte në mënyrë efektive pretendimin për diskriminim të paraqitur nga ankuesja.

### **FAKTET**

Ankuesja O.S., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Përmet, në pozicionin e punës Drejtore në Kopshtin Nr.1. Ankuesja është emëruar në këtë pozicion në datën 01.05.2016. Ankuesja ka një eksperiencë prej 14 vite punë në sistemin arsimor. Në lidhje me nivelin arsimor, rezultoi , ankuesja ka përfunduar studimet e larta universitare në Degën Cikël i Ulët dhe ka fituar titullin “Mësues i Ciklit të Ulët”. Ankuesja ka fituar në vitin 2017 kategorinë e dytë të kualifikimit “Mësues Specialist” për lëndën “Arsim fillor”.

Në datë 23.12.2019, Bashkia Përmet ka shpallur njoftimin për vend të lirë pune në pozicionin Drejtor i Institucionit Arsimor – Kopshti Qytet Përmet, ku konkurimi ishte caktuar në datën 14.01.2020. Në datën 21.01.2020, Komisioni i Vlerësimit, ka shpallur aplikanten M.T, fituese për pozicionin “Drejtor të Arsimit Parashkollor Përmet”.

Në datën 23.01.2020, Bashkia Përmet ka njoftuar ankuesen për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. Në takim të datës 27.01.2020, të mbajtur midis ankueses në cilësinë e punëmarrëses dhe Bashkisë Përmet në cilësinë e punëdhënësit, ankueses i është komunikuar se, vendin e punës e ka fituar dikush tjetër në bazë të konkurimit. Gjatë këtij takimi, ankuesja e ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës së punës dhe ka pretenduar se largimi i saj nga puna po bëhej për shkak se ajo ishte anëtare e Partisë Demokratike.

Zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë në datën 31.01.2020 dhe si shkak për zgjidhjen e saj ishte konstatimi i pavlefshmërisë së procedurës së emërimit të ankueses në këtë pozicion pune, sipas udhëzimit Nr. 57, datë 12.11.2013 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në të njëjtën datë, M.T është emëruar në detyrën e “Drejtorit të Arsimit Parashkollor Përmet”, në Bashkinë Përmet, pra në të njëjtën ditë me urdhrin për largimin e ankueses nga puna.

Ankuesja e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, të kundërta me ato të Kryetares së Bashkisë Përmet, e cila ishte zgjedhur në këtë detyrë, në Zgjedhjet për Pushtetin Vendor, të zhvilluara në qershor 2019, si përfaqësuese e Partisë Socialiste.

Rezultoi se, ankuesja ishte anëtare e Partisë Demokratike që prej vitit 2000 dhe anëtare e Kryesisë së Degës Përmet të Partisë Demokratike. Rezultoi se, se ankuesja kishte qenë komisionere e kësaj force politike në KZAZ e rrethit në zgjedhjet lokale të vitit 2011, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 si dhe Kryetare KZAZ-je në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Ankuesja që prej vitit 2017 kryente detyrën e drejtueses së Degës Përmet të Lidhjes Demokratike të Gruas.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Europiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 55, 55/1 (Ligji Nr. 69/2012, i ndryshuar)

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen ishte bërë në kundërshtim me Kodin e Punës dhe ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në këto kushte ankuesja ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i saj nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm.

Në kohën kur ankuesja është punësuar pranë Bashkisë Përmet, ligji Nr. 69/2012, i ndryshuar nuk ka patur parashikime në lidhje me emërimin e drejtorit të institucionit arsimor parashkollor. Bazuar në parashikimet ligjore në fuqi dhe konkretisht sipas nenit 55/1 të ligjit Nr. 69/2012, të ndryshuar, arsyeja e deklaruar nga Bashkia Përmet për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen nuk përbën shkak për shkarkimin ankueses si drejtuese e institucionit të arsimit parashkollor (Drejtore Kopshti). Bazuar në nenin 55/1, të ligjit Nr. 69.2012, të

ndryshuar, shkak i ligjshëm për shkarkimin e ankueses si Drejtore Kopshti do të ishin shkelja nga ana e saj e dispozitave të ligjit nr. 69/2012 dhe akteve nënligjore të tij apo nëse ankuesja do të ishte gjetur në shkelje të etikës e të sjelljes në institucion, fakte këto që nuk rezultojnë të provuara, por as të pretenduara nga Bashkia Përmet.

Komisioneri vlerësoi se, referimi që bëhet nga ana e Bashkisë Përmet tek udhëzimi Nr. 57, datë 12.11.2013, i MASR, jo vetëm që nuk përbën arsye të ligjshme për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen, por është referencë e gabuar ligjore. Nga përmbajtja e këtij udhëzimi rezulton se, procedurat e parashikuara në këtë akt kanë të bëjnë me emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, por nuk ka parashikime për arsimin parashkollor, edhe pse ky i fundit është pjesë e arsimit parauniversitar sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Të gjitha procedurat e parashikuara në këtë udhëzim janë detyrim për t'u ndjekur dhe zbatuar nga njësitë arsimore vendore të cilat janë përgjegjëse për emërimin e drejtuesve të shkollave, ndërsa emërimi dhe shkarkimi i drejtuesit të institucionit të arsimit parashkollor (Drejtore Kopshti) është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore. Ky udhëzim i cili është miratuar në bazë dhe për zbatim të nenit 55, të ligjit Nr. 69/2012, i ndryshuar, nuk përmban asnjë detyrim për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kompetencën e të cilave përfshihet emërimi dhe shkarkimi i drejtuesit të institucionit të arsimit parashkollor, për ndjekjen e procedurave të parashikuara në këtë akt.

Rezultoi se, Bashkia Përmet kishte shpallur vendin e punës të mbajtur nga ankuesja, si vend të lirë pune, përpara se të bënte zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen. Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune deri në datën 31.01.2020, datë kur ka dalë urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ndërsa shpallja si vend i lirë pune, është bërë që në datën 23.12.2019. Në datën 23.01.2020 rezulton se ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, ndërkohë që Komisioni i Vlerësimit përpara kësaj date kishte shpallur fituesin për vendin e saj të punës.

Bashkia Përmet i është referuar me emërtim jo të saktë pozicionit të punës, i cili zyrtarisht sipas strukturës mbante emërtimin “Drejtore Kopshti” dhe jo “Drejtore e Arsimit Parashkollor”, referuar kjo strukturës së Bashkisë Përmet për vitin 2019 dhe 2020 dhe Rregullores së Brendshme të institucionit.

Rezultoi se, nga momenti i marrjes së drejtimit të Bashkisë Përmet, nga Kryetarja e Bashkisë A.H, ishin larguar nga puna rreth 19 punonjës. Me motivacionin e ristrukturimit të institucionit ishte larguar nga puna edhe motra e ankueses Në vitin 2016, në kohën Kryetarja aktuale e Bashkisë Përmet ushtronte detyrën e Përgjegjëses së Zyrës Arsimore Përmet, ankuesja ishte larguar nga puna si mësuese në Shkollën 9-vjeçare “Meleq Gosnishti”, Përmet, ku punonte prej vitit 2011.

Komisioneri vlerësoi se, Bashkia Përmet kishte vepruar në shkelje të neneve 5 e 13/1c, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi nuk kishte marrë në shqyrtim pretendimin për

diskriminim për shkak të bindjeve politike të paraqitur nga ankuesja në takimin e datës 27.01.2020.

Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike ka patur dijeni për bindjet politike të ankueses.

Në kushtet kur, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijonin prezumimin se, largimi i saj nga puna ishte kryer për motive politike, Bashkia Përmet, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankueses se këto veprime ishin kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Përmet, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja, pra bindjet politike.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të ankueses O.S., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Përmet.

Në referim të pikës 1, Bashkia Përmet, të marrë masa, për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesen O.S., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të



**27. A.Ç., kundër Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a.,**

**VENDIM NR. 124, DATË 05.10.2020**

**Shkaku: Bindjet politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Motivacioni i largimit nga puna të ankuesit ishte konraditor, ku nga njëra anë pretendohet largimi për shkak të performancës së dobët dhe nga ana tjetër largimi legjitimohej në kuadër të nevojave për ristrukturimin e shoqërisë. Pavarësisht mungesës së koherencës, në lidhje me shkakun e largimit nga puna, asnjë nga këto motivacione nuk rezultoi i provuar.

***FAKTET***

Ankuesi A.Ç., ka filluar punë pranë Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a në datën 04.02.2019, në pozicionin e punës “Specialist Hidraulik+Monovrator (Koms), pranë Drejtorisë Teknike të Shoqërisë Ujësjellës Mat sh.a. Marrëdhëniet e punës kanë vazhduar normalisht deri në datën 26.09.2019, kur ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por nuk rezultoi e provuar që punëdhënësi të ketë zhvilluar takimin paraprak me ankuesin.

Në datën 03.10.2019, Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a ka njoftuar ankuesin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me motivacionin, si vijon: “*Marrëdhënia ekzistuese kontraktuale e punës ndërmjet jush si punëmarrës dhe Ujësjellës Kanalizime Mat në cilësinë e Punëdhënësit do të zgjidhet për shkak se është konstatuar se gjatë ushtrimit të detyrës është evidentuar performancë e dobët në përmbushjen e detyrave funksionale, nuk është treguar në nivelin e kërkuar përgjegjshmëria në punë dhe sipas parimit të mirëbesimit këto marrëdhënie nuk mund të vijojnë në të ardhmen. Afati përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës do të jetë data 03.11.2019.*” Me vendimin e datës 04.11.2019 Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a ka vendosur lirim nga detyra të ankuesesit me motivacionin “performancë e dobët në punë”.

Ankuesi e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike. Rezultoi se ankuesi ishte anëtar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike dhe ushtronte detyrën si Sekretar i Seksionit të Partisë Demokratike Baterr e Vogël, që prej vitit 2017.

***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna, nuk rezultoi e provuar. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm dhe në shkelje të procedurës të parashikuar nga Kodi i Punës.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin, jo vetëm që nuk rezultoi që kishte ndodhur për ndonjë shkak ligjor, por nga faktet dhe aktet e administruara, Komisioneri konstatoi se Ujësjetllës Mat sh.a deklaroi motivacione dhe shkaqe të ndryshme, që kanë shërbyer për përfundimin e marrëdhënies së punës. Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., nuk paraqiti asnjë dokument apo akt shkresor nëpërmjet të cilit të provonte performancën e dobët të ankuesit, për të legjitimuar në këtë mënyrë faktin se shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me ankuesin kishte të bënte me aftësitë e tij.

Ndryshe nga motivacioni i deklaruar në vendimin e largimit nga puna ai i “performancës së dobët në punë”, Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., deklaroi një motivacion tjetër për zgjidhjen e kontratës së punës, ristrukturimin e shoqërisë. Gjatë shqyrtimit të ankesës Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se, nevoja për rivlerësimin e marrëdhënies së punës me ankuesin kishte si shkak ristrukturimin e shoqërisë. Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a nuk depozitoi asnjë akt shkresor për të provuar se: ristrukturimi do të ishte strukturor apo do të prekte edhe organikën e shoqërisë duke shkurtuar numrin e punonjësve dhe për më tepër sa do të ishte numri i punonjësve që do të largoheshin nga puna; cilat do të ishin kriteret mbi bazët e të cilave do të realizohej ristrukturimi dhe përzgjedhja e punonjësve të cilët do të vazhdonin punën dhe atyre që do të largoheshin nga puna; cila ishte procedura, afatet dhe strukturat/personat e ngarkuar me procesin e ristrukturimit; dhe si ishte vlerësuar përmbushja e kriterëve, kualifikimi dhe performanca në punë e paditësit në raport me personat e tjerë.

Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., pretendoi se, në kuadër të nevojës për ristrukturimin e shoqërisë, ankuesit i ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës si “punonjës i ri pa eksperiencë

dhe pa kualifikimin e nevojshëm”. Ujësjetllës Mat sh.a., nuk vuri në dispozicion kopje të dokumentacionit ku parashikohen kërkesat për kualifikimin e punonjësve në pozicionin e punës të mbajtur nga ankuesi “specialist hidraulik+monovrator”. Gjatë shqyrtimit ankuesi provoi se ka mbaruar arsimin e mesëm, ka përfunduar kursin për “Hidraulike” dhe është pajisur me Dëshmi Kualifikimi, nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës. Në lidhje me faktin se ankuesi ishte konsideruar si punonjës i ri dhe për rrjedhojë pa eksperiencë, Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., nuk vendosi në dispozicion kriteret mbi bazën e të cilave presupozohet se do të realizohej ristrukturimi dhe se çfarë peshe do të kishte në këtë kuadër eksperiencia për secilin nga punonjësit apo se çfarë eksperience apo kualifikime zotërojnë punonjësit e tjerë të cilët kanë vazhduar marrëdhëniet e punës.

Ujësjetllës Mat sh.a., nuk vuri në dispozicion (edhe pse një gjë e tillë i’u kërkua në mënyrë të përsëritur) informacionin në lidhje me largimet apo punësimin e punonjësve të rinj pranë kësaj shoqërie duke filluar nga momenti i ndërrimit të organeve të saj drejtuese në muajin shtator 2019; informacion në lidhje me kualifikimet e punonjësve që vazhdonin punën; faktin nëse pozicioni i punës së ankuesit ishte plotësuar duke emëruar punonjës tjetër, edhe pse sipas vendimit Nr. 50, datë 11.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, rezultoi se Ujësjetllës Mat sh.a., ka pranuar faktin se vendi i punës së ankuesit nuk është shkurtuar dhe pas largimit të tij nga puna ky vend pune është plotësuar me një punonjës tjetër. Refuzimi për të vënë në dispozicion provat e kërkuara është një rrethanë që është marrë në konsideratë nga Komisioneri për qëllime të të provuarit dhe marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me ankesën.

Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., në cilësinë e punëdhënësit të ankuesit është një shoqëri aksionere e cila funksionon në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me aksioner të vetëm Bashkinë Mat. Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Mat u zgjodh A.M., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Pak kohë pas marrjes së detyrës nga Kryetari i Bashkisë, në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a., kanë ndodhur disa ndryshime në organet e saj drejtuese dhe ndër të tjera, në pozicionin e administratorit është emëruar A.Th., (datë 10.09.2019). Administratori i ri, 15 ditë kalendarike pas emërimit në detyrë ka filluar procedurën e për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.

Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike ka patur dijeni për bindjet politike të ankueses.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.Ç., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Mat sh.a.



Në referim të pikës 1, Ujësjellës Kanalizime Mat sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin A.Ç., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

## 28. P.I., kundër Bashkisë Mallakastër

**VENDIM NR. 82, DATË 10.08.2020**

**Shkaku: Bindjet politike**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Ankuesi u largua nga puna me motivacionin se, si pasojë e ristrukturimit, pozicioni i tij i punës ishte suprimuar, por ndryshimi konsistente në thelb vetëm në ndryshimin formal të emërtimit të vendit të punës dhe jo në detyrat funksionale.

### **FAKTET**

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkinë Mallakastër me detyrë “Inspektor pyjesh”, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, në Drejtorinë e Mjedisit. Ankuesi ka filluar punë në datë 03.04.2017 dhe ka vazhduar të punojë në këtë pozicion deri më datën 17.03.2020, kur është liruar nga ky pozicion pune.

Shkaku i deklaruar nga ana e Bashkisë Mallakastër për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ankuesin, ishte, se në zbatim të VKB Nr.104, datë 20.12.2019 *“Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe institucioneve të varësi, strukturës organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Mallakastër për vitin 2020”*, pozicioni i punës i mbajtur prej ankuesit ishte suprimuar. Ankuesi e kundërshtoi arsyen e deklaruar nga ana e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke pretenduar se vendi i tij i punës nuk ishte suprimuar nga VKB Nr.104.02.12.2019, por zgjidhja e kontratës së punës kishte ndodhur për shkak të bindjeve politike.

Rezultoi se, ankuesi ishte anëtar i Partisë Demokratike që prej datës 08.03.1991 dhe se ai kishte mbajtur dhe vazhdonte të mbante pozicione të ndryshme brenda strukturave të kësaj partie. Rezultoi gjithashtu se ankuesi në vite të ndryshme, kishte qenë i zgjedhur në organet e pushtetit vendor, si përfaqësues e kësaj force politike, si: Këshilltar i Komunës Qendër, Mallakastër, N.Kryetar i Këshillit të Komunës Qendër. Ankuesi ishte aktiv duke marrë pjesë në protesta të ndryshme të organizuara nga Partia Demokratike. Gjatë një proteste të realizuar nga Partia Demokratike në qytetin e Fierit, në datë 09.03.2019, ankuesi ishte ndaluar nga forcat e policisë dhe ndaj tij nga ana e gjykatës, ishte marrë masë sigurimi “arrest në shtëpi” e cila më pas ishte zëvendësuar me “detyrim paraqitje”. Në kuadër të procedurave penale ndaj ankuesit, Bashkia Mallakastër kishte vendosur pezullimin e tij nga detyra dhe të gjitha këto akte ndodheshin në dosjen personale të ankuesit.

## **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9.

## **KONKLUZIONE**

Komisioneri arriti në përfundimin se, pozicioni i punës “Inspektor Pyjesh” nuk ishte suprimuar dhe se, në strukturën e vitit 2020, këtij pozicioni i korrespondonte pozicioni me emërtimin “Specialist Pyjesh”. Komisioneri vlerësoi se, si pasojë e ristrukturimit pozicioni i punës “Inspektor pyjesh” kishte ndryshuar vetëm emërtimin nga “inspektor pyjesh” në “specialist pyjesh” ndërsa funksionet dhe detyrat mbeteshin të njëjta. Pavarësisht shkurtimeve që kishte pësuar Drejtoria e Mjedisit dhe Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, ku ka qenë i pozicionuar pozicioni i punës “Inspektor Pyjesh”, këto shkurtime nuk kanë prekur këtë pozicion pune, por përkundrazi, me strukturën e viti 2020 numri i pozicioneve të punës “Specialist Pyjesh” (që i korrespondon pozicionit Inspektor pyjesh) ishte rritur.

Punonjës të tjerë ishin mbajtur në punë si “specialist” pyjesh, por pa u realizuar ndonjë procedurë apo kritere mbi bazën e të cilave ishte vendosur sistemimi i tyre në këto pozicione sipas strukturës së re. Bashkia kishte punësuar gjithashtu punonjës të rinj në pozicionet e punës “specialist pyjesh”, të cilët nga shqyrtimi i dosjeve të tyre personale rezultuan më pak të kualifikuar ose pa arsimin përkatës, ndërsa ankuesi kishte arsimin e duhur dhe një eksperiencë të konsiderueshme në fushën përkatëse. Komisioneri vlerësoi se, në kuadër të ristrukturimit, Bashkia Mallakastër kishte mundësi që të sistemonte ankuesin në një nga pozicionet e lira të punës si “specialist pyjesh”, por nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Më pas, nëse do të rezultonin akoma vende të lira, bashkia mund t’i plotësonte ato me punonjës të rinj, të cilët plotësonin kriteret e vendit të punës.

Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi në mënyrë logjike ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijonin prezumimin se, largimi i tij nga puna

ishite kryer për motive politike, Bashkia Mallakastër, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Mallakastër, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkakun i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit P.I., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Në referim të pikës 1, Bashkia Mallakastër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke emëruar ankuesin P.I., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

### 29. Grup personash kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Tiranë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) Korçë dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

**VENDIM NR. 34, DATË 07.04.2020**

**Shkaku:** Gjendja ekonomike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesit që prej vitit 2014 janë akomoduar nga Bashkia Korçë tek ndërtesa e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore. Fillimisht ata janë furnizuar me energji elektrike nëpërmjet një kontrate kolektive, të lidhur me Bashkinë Korçë. Në vitin 2017, pasi lidhën kontratën e huapërdorjes me Bashkinë Korçë, ankuesve iu kërkua të lidhnin kontrata individuale me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike. Bazuar në pikat 4.2 dhe 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, ata duhet të paguanin në avancë shumën prej 22.000 lekësh. Ankuesit, të ndodhur në situatë ekonomike të vështirë, e kanë të pamundur të paguajnë në mënyrë të menjëhershme shumën prej 22.000 lekësh, duke qenë se nuk kanë të ardhura ekonomike të mjaftueshme.

#### **FAKTET**

Subjektet ankues që prej vitit 2014 janë akomoduar nga Bashkia Korçë tek ndërtesa e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore, ku dhe jetojnë aktualisht. Fillimisht ata janë furnizuar me energji elektrike nëpërmjet një kontrate kolektive, të lidhur me Bashkinë Korçë. Në vitin 2017 banorët lidhën kontrata huapërdorjeje me Bashkinë Korçë. Në vijim, banorët u orientuan nga ana e Bashkisë të lidhnin kontrata individuale me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike.

Bazuar në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes<sup>18</sup>”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, subjektet ankues kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.

Referuar përcaktimeve të Rregullores aktuale “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes<sup>19</sup>”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike,

<sup>18</sup> Miratuar me Vendimin Nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr. 177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

<sup>19</sup> Miratuar me Vendimin Nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr. 177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.



aplikatët/subjektet ankues në rastin konkret, detyrohen të kryejnë pagesën prej 22.000 lekësh, për tarifën e lidhjes së re, e cila duhet të realizohet e plotë dhe në avancë prej tyre.

Referuar sa më sipër, subjektet ankues kanë dokumentuar se janë në pamundësi pagese të kësaj shume, në mënyrë të menjehershme, të plotë dhe në avancë, pasi janë në pamundësi financiare.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 52, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 25.
- Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Evropës, nenet 7,8.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002).
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 10, 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rregullorja “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes<sup>20</sup>”.
- Rregullorja “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” (miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të ERE-s).
- Rregullorja “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen me energji elektrike të klientëve në nevojë”. (miratuar nëpërmjet Vendimit të Bordit të ERE-s me Nr. 246, datë 11.12.2018).

### **KONKLUZIONE**

Lidhur me kërkesën e OSHEE sh.a Korçë/OSHEE sh.a ndaj ankuesve, për pagesën e plotë në avancë për lidhjen e re, Komisioneri vlerësoi se, kjo kërkesë vjen si zbatim i drejtëpërdrejtë i aktit rregullator të këtij Operatori. Për sa kohë që Rregullorja e përcakton si detyruese një kërkesë të tillë, OSHEE sh.a është e detyruar ta zbatojë atë.

---

<sup>20</sup> Miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

Pra, në këtë rast nuk jemi para shkeljes së të nenit 7, pika 1 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nga ana e OSHEE sh.a Korçë dhe OSHEE sh.a.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë apo diskriminuese nga ana e OSHEE sh.a., Korçë dhe OSHEE sh.a., për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, përsa kohë ata kanë zbatuar Rregulloren, e cila miratohet me Vendim të Bordit të ERE.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri analizoi dhe shqyrtoi nëse vetë akti rregullator, Rregullorja “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes” ishte diskriminues ndaj subjekteve ankues, bazuar pikërisht në pamundësinë e tyre financiare për të realizuar pagesën e plotë dhe në avancë të lidhjes së re.

Rezultoi e pranuar prej palëve në proces: OSHEE sh..a, OSHEE sh.a., Korçë dhe ERE se subjektet ankues ishin realisht në pamundësi pagese të kësaj shume, në mënyrë të menjehershme, të plotë dhe në avancë, pasi ata faktuan se ishin në pamundësi financiare.

Nga ana tjetër, është fakt që parashikimi i pikës 4.3 të kësaj Rregulloreje trajton pa asnjë diferencim të gjithë aplikantët, duke mos patur në konsideratë aftësitë e tyre paguese, sa i takon tarifës së lidhjes së re.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri theksoi se, legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, parashikon se ata individë që janë në situata të ndryshme duhet të marrin trajtim të ndryshëm deri në masën që nevojitet për t’i lejuar të gëzojnë mundësi të caktuara njësoj si të tjerët.

Referuar barrës së proves, ERE duhet të provonte që parashikimi i bërë në pikën 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, ishte një masë e arsyeshme, objektive dhe proporcionale konform përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; ose në të kundërt duhet të demonstronte vullnet për ta ndryshuar atë, duke konsideruar mundësinë për heqjen e këtij detyrimi për subjektet ankues, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta paguar atë.

Nga ana e ERE-s nuk u soll asnjë dokument që të provonte se ata do të ndërmerrnin masa konkrete lidhur me sa është kërkuar. Në këto rrethana, Komisioneri vlerësoi se subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë krahasuar me të gjithë aplikantët e tjerë, pasi ata nuk ndodhen në kushte e rrethana të njëjta, me aplikantët e tjerë, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

## **VENDIMI**

Konstatimi i diskriminimit të tërthortë, për shkak të “gjendjes ekonomike”, të subjekteve ankues dhe të gjithë kategorisë të aplikantëve të ndodhur në të njëjtat kushte apo kushte të ngjashme me ta, nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Konstatimi i mosdiskriminimit për shkak të “gjendjes ekonomike”, të subjekteve ankues dhe të gjithë kategorisë të aplikantëve të ndodhur në të njëjtat kushte apo kushte të ngjashme me ta, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Tiranë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) Korçë.

ERE të marrë masa për ndryshimin e pikës 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes<sup>21</sup>”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta realizuar atë.

---

<sup>21</sup> Miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

### 30. SH.M., kundër Drejtorisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I., me detyrë drejtuese e Shërbimit të Anatomisë Patologjike

**VENDIM NR. 44, DATË 04.05.2020**

**Shkaku:** Përkatësia në një grup të veçantë dhe gjendja arsimore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesja ka nga viti 1999 e në vijim, është punonjëse e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (në vijim QSUT), me detyrë Laborante pranë Shërbimit të Laboratorit të Anatomisë Patologjike në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent. Pas emërimit të drejtueses së Shërbimit të Anatomisë Patologjike, ka patur debate apo diskutime për përmirësimin e metodikës së punës nga një grup mjekësh dhe punonjësish të këtij shërbimi, të cilat kanë çuar në marrjen e masave disiplinore vetëm ndaj ankuseses, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe gjendjes arsimore.

#### **FAKTET**

Nga viti 1999 e në vijim, Sh.M., është punonjëse e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (në vijim QSUT), me detyrë Laborante pranë Shërbimit të Laboratorit të Anatomisë Patologjike në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent.

Në muajin Nëntor 2018 në krye të Shërbimit të Anatomisë Patologjike është emëruar mjekja M.I., Disa muaj pas emërimit të M.I., në pozicionin e drejtueses së Shërbimit të Anatomisë Patologjike, mes saj, mjekut L. B., bashkëshortes së tij T.B., dhe ankuseses, ka patur debate apo diskutime për përmirësimin e metodikës së punës së Shërbimit të Anatomisë Patologjike.

Më datë 23.07.2019, në Shërbimin e Anatomisë Patologjike, është mbajtur një mbledhje në praninë e N/drejtoreshës së QSUT-së, ku janë diskutuar problematikat e hasura në këtë shërbim sa i përket realizimit të biopsive. Në këtë mbledhje janë diskutuar edhe vonesat e realizimit të biopsive nga mjekët L.B.,<sup>22</sup>, T.B.<sup>23</sup>, A.N., dhe E.S. Për këtë M.I., i është drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me anë të ankesës Nr. 2612 prot., datë 16.07.2019, duke kërkuar marrjen e masave për tërheqjen e vërejtjes ndaj mjekëve të sipërcituar. Vërehet se nga ana e N/drejtoreshës së QSUT-së, i është thënë M.I., se debatet nuk i shërbejnë punës dhe nga ana e saj duhet të merren masa për t’i shmangur këto situata.

<sup>22</sup> Mjeku L.B., i cili konkuroi me M.I., për pozicionin e Shefit të Shërbimit të Anatomisë Patologjike

<sup>23</sup> T.B., bashkëshortja e mjekut L.B.

Në vijim, më datë 24.07.2019, M.I., ka zhvilluar sërish një mbledhje me stafin e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, ku në objekt të saj ishte dhënia e vërejtjes ndaj mjekes T.B., dhe Sh.M., për shkak të mungesës së etikës së treguar në mbledhjen e datës 23.07.2019. Në përmbajtje të proceverbalit të kësaj mbledhje, nuk evidentohet në asnjë rast që ndaj M.I. dhe Sh.M., të ketë patur debate. Po, ashtu për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së tyre në këtë mbledhje, M.I., ka kërkuar që mjekëve L.B., bashkëshortes së tij dhe mjekes S.Sh., t'u hiqet dita punës.

Në të njëjtën ditë, M.I., i është drejtuar Drejtorisë së QSUT-së, duke i sqaruar se në mbledhjen e organizuar në Shërbimin e Anatomisë Patologjike të datës 24.07.2019, Sh.M., ka mbajtur një sjellje të papërshtatshme dhe në shkelje të etikës në komunikim me të dhe një pjesë të stafit mjekësor, si dhe ka fyer, ushtruar dhunë dhe kundërshtuar detyrat e caktuara nga shefi i shërbimit. Në rrethana të tilla, ka kërkuar nga ana e drejtuesve të QSUT-së, që ndaj Sh.M., të merret masë disiplinore largim nga puna ose zhvendosja e saj në shërbim tjetër laboratorik.

Përsa më lart dhe referuar procesverbalit të mbledhjeve të sipërcituara, pavarësisht faktit që M.I., ka patur diskutime rreth mënyrës së punës dhe përmirësimit të saj, me mjekët L.B., T.B., dhe Sh.M., ajo ka kërkuar nga ana e drejtuesve të QSUT-së të merret masë disiplinore vetëm ndaj Sh.M.

Një ditë pas mbledhjes së zhvilluar në Shërbimin e Anatomisë Patologjike, ankuesja së bashku me një grup të përbërë nga mjek, pedagogë, specializant dhe laborant, të cilët ushtrojnë aktivitetin pranë Shërbimit të Anatomisë Patologjike, kanë drejtuar një shkresë në Drejtorinë e QSUT-së, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe për dijeni Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me përmirësimin e kushteve të punës dhe evidentimin e shkeljeve të M.I.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.

## **KONKLUZIONE**

Në analizë të informacionit të administruar, konstatohet se:

- Qëndrimi i mbajtur ndaj ankuses, nga ana e M.I., ka qenë i ndryshëm nga qëndrimi i mbajtur ndaj mjekëve L.B., dhe bashkëshortes së tij, të cilët sërisht kanë “kritikuar” metodikën e punës së saj.
- I vetmi person i penalizuar nga debatet e zhvilluara në mbledhjet e sipërcituara, ka qenë Sh.M., ndërkohë mjekët L.B., dhe bashkëshortja e tij, nuk janë proceduar disiplinarisht.
- Krahasuar me mjek të tjerë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e QSUT-së, nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim, gjatë procedurave të dhënies së masave disiplinore, pasi në rastin e tyre për shkelje më të rënda, nuk janë konsideruar si rënduese masat e dhëna më parë, ndërsa për ankuesen po. Në këtë kuptim, pretendimi i ankuses se Drejtoria e QSUT-së, ka mbështetur M.I., për shkak se ajo ka pozicionin hierarkik më të lartë se ajo, qëndron dhe mbështetet në provat e administruara.
- Nga ana e QSUT-së është vepruar në mënyrë të njëanshme lidhur me masën e disiplinore të dhënë ndaj ankuses, pasi krahasuar me të, ka konsideruar të mbështetura pretendimet e M.I., ndërkohë që ato nuk ishin të bazuara në prova dhe fakte.
- Duke analizuar masat e propozuara nga M.I., vëmë re se kundrejt laboranteve është dhënë masa “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” ndërsa kundrejt mjekëve “Tërheqje vëmendje” gjë që tregon tendencën e QSUT ndaj punonjësve që janë të një niveli arsimor më të ulët se doktoret.

Nuk evidentohet asnjë fakt, se ndaj ankuses të jenë dhënë masa disiplinore, vlerësime pune negative apo mosmarrëveshje me drejtuesit e mëparshëm gjatë karrierës së saj. Kjo situatë e krijuar ka nisur në momentin që M.I., është emëruar në pozicionin e drejtueses së Shërbimit të Anatomisë Patologjike. Ky fakt forcon edhe më shumë bindjen që problematikat e lindura mes ankuese dhe M.I., janë të lidhura me shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit, në fushën e punësimit, të shtetases Sh.M., nga ana e M.I., me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe gjendjes arsimore të saj.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e QSUT-së, të merren masa për anullimin e masës disiplinore të dhënë ndaj ankuses.



Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e M.I., të merren masa për kërkimin e ndjesës me shkrim ndaj ankuses, për situatën e krijuar, si dhe ndalimin e situatës diskriminuese në vazhdim.

### **31. R.G., kundër Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc**

**VENDIM NR. 41, DATË 29.04.2020**

**Shkaku: Gjendja arsimore**  
**Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Në gjykatë**

Ankuesi ka konkuruar për një vend të lirë pune për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Kategorinë Lektor pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, por është skualifikuar për shkak të gjendjes arsimore, si rezultat i vendosjes së kriterëve përjashtuese për kandidatët të cilin nuk ishin diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT.

#### ***FAKTET***

Departamenti i Historisë, së Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, i Universitetit të Tiranës, për plotësim të stafit akademik, ka përcjellë pranë Dekanit, Kriteret për një vend pune “*lektor*”.

Pas miratimit nga Dekani i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë dhe Rektori i Universitetit të Tiranës, referuar njoftimit të bërë në faqen e APP Nr. 20, datë 20.05.2019, është shpallur konkursi për 1(një) vend të lirë pune për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Kategoria “*Lektor*”. Njoftimi ka të specifikuarat kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kriteret të përgjithshme dhe kriteret të veçanta.

R.G., pasi është vënë në dijeni të këtij njoftimi të publikuar në Buletinin e Prokurimeve Publike, më datë 03.06.2019 ka paraqitur aplikimin e tij, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë.

Përsa në sipër dhe në vijim të procedurës, me Vendim të Dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë Nr. 39, datë 24.06.2019, është ngritur Komisioni Ad-hoc për konkursin personel akademik të kategorisë “*Lektor*”, në Departamentin e Historisë. Nga Procesverbali i Komisionit Ad-hoc, mbajtur më datë 03.07.2019, rezulton se në konkurim për vendin e lirë punës për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Kategoria “*Lektor*”, kanë qënë 4 (katër) kandidat, nga të cilët pas intervistimit nga ana e Komisionit Ad-hoc, është vendosur që kandidaturat që duhen marrë në konsideratë dhe që do të shqyrtohen për votim, janë Prof. Dr. R.G., dhe Dr. E.K., Në përfundim të procedurës së konkurimit, Komisioni Ad-hoc ka shpallur fitues kandidaten E.K.



Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, me datë 05.07.2019, ka përcjellë pranë Rektorit të UT-së dokumentacionin mbi rezultatet e konkursit për kategorinë “Lektor” të Departamentit të Historisë, për ndjekjen e procedurave të mëtejshme. Pas analizës së bërë, Universiteti i Tiranës, ka konstatuar faktin që procedura e ndjekur nga ana e Komisionit Ad-hoc *nuk është zhvilluar konform nenit 67, pika 7 të Statutit të Universitetit të Tiranës*. Për këtë arsye, ka kërkuar nga ana e Komisionit Ad-hoc të bëhen edhe një herë procedura për përzgjedhjen e kandidatit fitues për këtë vend pune, në zbatim të Statutit të UT-së.

Përsa më sipër, më datë 15.07.2019, Komisioni Ad-hoc është mbledhur sërish për të bërë vlerësimin e dosjeve të kandidatëve konkuroes për vendin vakant, personel akademik të kategorisë “Lektor”. Pas shqyrtimit të dosjeve të secilit kandidat pjesëmarrës në konkurim, komisioni ka vendosur të kalojë në fazën e dytë, atë të intervistimit vetëm kandidaten E. K. dhe ta shpallë fituese.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.)
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64.
- Statuti i UT-së, neni 14, neni 47 dhe 67,
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Së pari, mbështetur në provat e administruara, Departamenti i Historisë, nuk ka justifikuar vendosjen e kriterit që kandidati të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT. Departamenti i Historisë nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri ka përjashtuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjithë kandidatët që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT-së, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së. Gjithashtu, edhe pse ankuesi disponon dy diploma të ciklit të parë të studimeve në Universitetin e Shkodrës, një në Fakultetin e Drejtësisë dhe një në Fakultetin e Histori-Gjeografisë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë është

përrjashtuar nga konkurimi për vendin vakant në Departamentin e Historisë, duke u trajtuar kështu në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në krahasim me kandidaten fituese.

Së dyti, kriteri i dytë i vendosur për kandidatët, të cilët duhet të kenë notë mesatare të studimeve të ciklit të parë bachelor mbi 9, në pamje të parë nuk e vendos ankuesin në kushte të pabarabarta apo të padrejta, por analizuar kjo në vijim të kriterit të parë, e përjashton në mënyrë të drejtëpërdrejtë ankuesin, pavarësisht se ai ka notën mesatare 9.9 të ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Histori-Gjeografisë së Universitetit të Shkodrës.

Duke i marrë së bashku këto kritere, në raport me kandidaten fituese, subjekti ankues është vënë në pozita të pabarabarta dhe të padrejta nga ana e Departamentit të Historisë si hartues i këtyre kritereve, si dhe nga ana e Universitetit të Tiranës, si miratues të tyre.

Së treti, Kriteri i tretë i vendosur i cili kërkon që kandidati të jetë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave ose diploma ekuivalente me to, në drejtimet “*Marrëdhënie Ndërkombëtare*” ose “*E Drejtë Ndërkombëtare Publike*”. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vlerësoi se, mospërcaktimi i fushës/grup lëndëve për personelin akademik që do të angazhohet me kohë të plotë, sjell pabarazi në vlerësimin e aplikantëve/kandidatëve, referuar këtij kriteri.

Në përfundim të arsytimit, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë në krahasim me kandidaten fituese, pasi është përjashtuar për shkak se nuk ka përfunduar ciklin e parë të studimeve në një nga degët e kërkuara në Universitetin e Tiranës.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjendjes arsimore, në fushën e punësimit, të R.G., nga ana e Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc.

Universiteti i Tiranës dhe Departamenti i Historisë të marrin masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me skualifikimin e kandidatit R.G., në konkursin për pozicionin e lektorit të brendshëm pranë Departamentit të Historisë së këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.

### 32. E.N., kundër Zyrës Vendore Arsimore Klos dhe Shkollës 9-Vjeçare “Tahir Hoxha” Klos

**VENDIM NR. 147, DATË 26.10.2020**

**Shkaku:** Gjendja arsimore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi me një eksperiencë prej 22 vitesh në arsim si mësues i gjuhës frënge, largohet nga puna për shkak se nuk zotëron një diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare “Master” dhe nuk i ishte nënshtruar provimit të shtetit.

#### ***FAKTET***

Ankuesi E.N., ka qenë në marrëdhënie pune si mësues i gjuhës frënge në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos. Ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune në datën 01.09.2014 bazuar në një kontratë pune me afat të pacaktuar. Ankuesi ka një eksperiencë prej 22 vitesh. Në lidhje me nivelin arsimor të ankuesit, rezulton se ai ka përfunduar Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, në Tiranë në vitin 1984, zotëron Diplomë Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Freng, lëshuar nga Universiteti i Tiranës në vitin 2011 dhe ka fituar shkallën e 2-të të kualifikimit si mësues i gjuhës frënge në vitin 2004. Rezultoi se, ankuesi ishte student në vitin e parë, të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, Programi i Studimit “Master i Shkencave” në “Mësuesi e gjuhës frënge në arsimin e mesëm të lartë”, për vitin akademik 2019-2020”.

Në datën datë 30.09.2019, ZVA Klos, ka refuzuar miratimin e listës emërore të mësuesve të shkollës “Tahir Hoxha”, Klos, për shkak se nuk përbushnin kriterin arsimor të parashikuar nga ligji, për të qenë të emëruar në vendet e punës, për tre mësues të kësaj shkolle. Rezultoi se një nga mësuesit ishte ankuesi E.N. ZVA Klos ka kërkuar nga Drejtoria e Shkollës marrjen e masave për zgjidhjen e marrëdhënies të punës, për këta mësues, duke përfshirë ankuesin.

Bazuar në vendimin e mësipërm të ZVA Klos, në datë 07.10.2019, Shkolla 9–vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos ka urdhëruar që tre mësuesit, duke përfshirë ankuesin, brenda të njëjtës dite duhet të nënshkruanin kontratat e punës me afat të caktuar dhe në rast refuzimi vendi i punës do të shpallej vakant dhe do t’i nënshtruhej procedurave për lëvizje paralele. Ankuesit, të cilit i’u ofruar një vend pune në Shkollën “Ramiz Kadiu” Bejn, (një shkollë në zonë periferike) ka refuzuar dhe nuk ka nënshkruar kontratën me afat të caktuar që i është propozuar.

Në datën 09.10.2019, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, ka njoftuar ankuesin për t’u paraqitur në takim për të biseduar në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës. Ankuesi ka marrë pjesë në takim dhe ka kundërshtuar arsyen e largimit nga puna. Në datën 06.01.2020, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos ka vendosur lirim nga detyra të ankuesit, duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Ankuesi, pretendoi se, ishte penguar nga drejtuesja e ZVA Klos, nga e drejta për t’u përfshirë në provimin për marrjen e shkallës së parë të kualifikimit, për shkak të bindjeve politike.

Rezultoi se ankuesi, i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017, ka ushtruar detyrën e anëtarit të Grupit të Numërimit të Votave KZAZ Nr.17, Qarku Dibër.

Ankuesi pretendoi se ishte diskriminuar për shkak të gjendjes së tij arsimore dhe bindjeve politike.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Europiane
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 57, 72/5 (Ligji Nr. 69/2012, i ndryshuar)

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri arriti në përfundimin se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin për shkak të mospërputhjes së formimit universitar me profilin e vendit të punës (niveli i diplomës universitare dhe jo profili) vjen në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji Nr. 69/2012) dhe Kodin e Punës. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm.

Komisioneri vlerësoi se, nga përmbajtja e nenit 72/5, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, rezulton qartë se, qëllimi i legjislatorin në miratimin e këtij neni ka qenë që të shmang vendosjen në pozita diskriminuese një numër të madh të personelit mësimor që prej vitesh janë

të punësuar në sistemin arsimor dhe kanë fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesit në një kontekst dhe rregullim ligjor të ndryshëm nga rregullimet e vendosura nga ky ligj.

Bazuar në këtë nen personeli mësimdhënës, që në kohën e miratimit të ligjit ka qenë i punësuar me kontratë të përhershme dhe ka patur formimin përkatës universitar, pa bërë ndonjë përcaktim në lidhje me nivelin e diplomës universitare, ruan vendet e punës. Mundësia për të ruajtur vendet e punës i është dhënë edhe personelit mësimor që ka qenë i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit. Komisioneri vlerësoi se, parashikimet e nenit 57, të Ligjit Nr. 69/2012, të ndryshuar, nuk mund të zbatohen të pavarura nga parashikimet e nenit 72, të po këtij ligji. Kjo do të thotë që kategoritë e mësipërme janë konsideruar nga ligji që përmbushin kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit. Kjo kategori nuk mund të konsiderohet si personel mësimor i cili do të hyjë rishtazi në sistemin arsimor pas këtyre ndryshimeve ligjore. Pra, ligji kërkon që i gjithë personeli mësimor i cili do të punësohej rishtazi nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit e në vijim të plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 57, por ndërkohë ka vlerësuar si të përmbushura këto kriteret nga kategoritë e mësipërme.

Rezultoi se, në kohën e miratimit të ligjit Nr. 69/2012, ankuesi ishte personel mësimor me emërim dhe jo me kontratë me afat të përcaktuar dhe zotëronte Diplomë Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Frëng.

Nuk rezultoi që zgjidhja e kontratës së punës në rastin e ankuesit të jetë bërë për një nga rastet e parashikuara nga Kodi i Punës, i cili në nenin 144/3, parashikon se zgjidhja e kontratës së punës, bëhet vetëm për shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes.

Rezultoi se, ankuesi është larguar nga puna me motivacionin se formimi i tij universitar nuk përputhet me vendin e tij të punës, pasi ai nuk zotëron diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare (diplomë master), kusht ky që kërkohet për të ushtruar profesionin e mësuesit në arsimin e mesëm të ulët, pozicion i mbajtur nga ankuesi si mësues i gjuhës frënge, në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Komisioneri vlerësoi se diferenca në trajtim që bazohet në nivelin e arsimit të një personi, do të konsiderohet si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore dhe sa më sipër rezultoi se ankuesi ka të vërtetuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes arsimore.

Bazuar në dosjet e mësuesve të cilat u administruan gjatë shqyrtimit, Komisioneri përforcoi bindjen se, mësuesit për shkak të mosmarrjes në konsideratë të dispozitave kalimtare të Ligjit Nr. 69/2012, të ndryshuar, konkretisht nenit 72, vendosen në kushte të pafavorshme duke ju kërkuar një nivel i caktuar i diplomës universitare apo marrja e licencës për ushtrimin e

profesionit, deri në largimin nga puna si në rastin e ankuesit. Sipas nenit 57/5/a, të Ligjit Nr. 69/2012, të për të ushtruar profesionin me mësuesit kërkohet edhe që mësuesi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale. Kjo kërkesë tregon qartë se në tërësi zbatimi i kriterëve të parashikuara nga neni 57, i ligjit Nr. 69/2012, të ndryshuar, zbatohet për personat që hyjnë në sistem pas miratimit të këtyre parashikimeve dhe se detyrimisht neni 57, duhet të zbatohet i kushtëzuar nga neni 72, i ligjit. Personat e vendosur në kontekste të caktuara kohore, i janë nënshtruar rregullimeve të caktuara për ushtrimin e profesionit. Ata nuk duhet të penalizohen apo të ndalohen për të ushtruar profesionin për shkak se nuk zotërojnë një nivel të caktuar të studimeve universitare. Për më tepër aftësitë dhe performanca e mësuesve është objekt i vlerësimeve periodike të punës së mësuesve.

Komisioneri vlerësoi se, qasja e ZVA Klos duke i propozuar ankuesit një vend pune në një shkollë tjetër periferike, por jo t'a lejojë atë që të vazhdojë punën si mësues në shkollën "Tahir Hoxha", Klos, e cila rezulton të jetë shkollë në qytet, me pretendimin se nuk përmbush kriteret për të qenë mësues, nuk është e drejtë. Një mësues i cili largohet nga puna se nuk plotëson kriteret për të qenë mësues, nga ana tjetër vlerësohet se mund të japë mësim në një shkollë periferike. Pra, ankuesi nuk plotëson kriteret për të qenë mësues në një shkollë në qytet, por mund të japë mësim në një shkollë periferike. Kjo qasje e ZVA Klos ngre dyshime mbi pretendime për diskriminim për shkak të vendbanimit, që potencialisht mund të pësojnë fëmijët që ndjekin arsimin në shkolla rurale.

Rezultoi se, ankuesi i ishte nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm dhe se ky trajtim ka ardhur si rezultat i gjendjes së tij arsimore. Një trajtim i tillë do të konsiderohet diskriminues, në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Prezantimi i kërkesave për nivele të caktuara të diplomave universitare dhe kalimi i mësuesve në procese verifikuese përtej marrjes së diplomës universitare, si pajisja me liçencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, synojnë të garantojnë një arsim cilësor për fëmijët. Qëllimi për të siguruar një arsim cilësor, padyshim që është një qëllim legjitim. Megjithatë kur gjykohet në lidhje me ekzistencën e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, duhet gjithashtu të vlerësohet nëse ekziston një marrëdhënie të arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Komisioneri vlerësoi se, kufizimi i vendosur mbi ankuesin për të ushtruar profesionin e mësuesit, nuk është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme dhe në përpjestim me nevojën që e ka diktuar atë. Për këtë arsye, Komisioneri vlerësoi se ishte cënuar parimi i proporcionalitetit, pasi nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme midis qëllimit të ligjshëm të synuar dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. ZVA Klos dhe Shkolla 9-vjeçare "Tahir Hoxha", Klos nuk arritën të provojnë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për

trajtimin më pak të favorshëm që i ishte bërë ankuesit për shkak të gjendjes së tij arsimore dhe për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi është diskriminuar në të drejtën e tij për punësim dhe profesion për shkak të gjendjes arsimore.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se ishte penguar nga drejtuesja e ZVA Klos, nga e drejta për t'u përfshirë në provimin për marrjen e shkallës së parë të kualifikimit, nuk u paraqitën prova të mjaftueshme për të provuar se ankuesi ka aplikuar dhe periudhën kur ka aplikuar. Gjithashtu, Komisioneri vlerësoi se nuk ekzistonte ndonjë lidhje midis pretendimit për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe sjelljeve të pretenduara si diskriminuese nga ana e subjekteve kundër të cilëve ishte paraqitur ankesa.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.N., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Klos dhe Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.

Në referim të pikës 1, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos dhe Zyra Vendore Arsimore Klos, të marrin masa, sipas kompetencave respektive për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin E.N., në pozicionin e mëparshëm të punës.

Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit për shkak të bindjeve politike.

## ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQERORE

33. V.A., kundër B.P., dhe A.R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”,  
Tiranë

**VENDIM NR. 20, DATË 21.02.2020**

**Shkaku:** Gjendja shoqërore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Arsim  
**Statusi:** Zbatuar

E.I., dhe K.I., vajzat binjake që ndiqnin Shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, janë bulluar nga shokët e klasës. Një fakt i tillë ka patur ndikim negativ në gjendjen e tyre shëndetësore dhe psikologjike. Nëna e tyre pretendon për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore nga ana e mësueses së tyre, kujdestare dhe mësueses që jepte lëndët e Historisë dhe Gjeografisë.

### **FAKTET**

E.I., dhe K.I., lindur në datën 24.11.2002, në Berat, kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Në procesin e shqyrtimit administrativ të ankesës, vajzat përfaqësohen ligjërisht pranë KMD-së nga ana e nënës së tyre, pasi ato janë ende nën moshën 18 vjeç dhe nuk kanë zotësi të plotë veprimi.

Gjatë periudhës kohore, që vajzat e saj kanë ndjekur klasën e tetë, që përkon me vitin shkollor 2016-2017 dhe klasën e nëntë që përkon me vitin shkollor 2017-2018, kanë patur ndryshim të ndjeshëm në sjelljen e tyre dhe mënyrën e jetesës. Ndryshimi ka qenë negativ, pasi sipas nënës së tyre, vajzat filluan të bënin mungesa të shumta në shkollë, u mungonte dëshira për të frekuentuar shkollën dhe si rrjedhim kishin rënie të ndjeshme në mësimet. Gjendja e tyre ishte e shoqëruar me ankth, ndërprerje të marrjes së ushqimit dhe mos shoqërim me shokë e shoqe të moshës së tyre.

Në vijim, nëna e vajzave u vu në dijeni të faktit se ato bulloheshin nga nxënësit e klasës, si dhe nga mësuesja kujdestare B.P., e mësuesja A.R. Bullizmi konsistonte në tallje, ofendime dhe në mungesën e marrjes së masave të menjëherëshme e të nevojshme, nga ana e mësues kujdestare, për të ndaluar situatën e bullizmit. Ankuesja shprehet se mësuesja kujdestare ishte në dijeni të asaj që po ndodhte me dy vajzat binjake dhe nuk vepronte. Gjendja psikologjike dhe shëndetësore e vajzave sa vinte e rëndohej.

Referuar recetave të lëshuara nga mjeku i familjes, Dr. N.K., rezultoi se E.I., dhe K.I., vuajnë nga anemia dhe mjeku thekson faktin se ka dyshim, se të dyja vajzat vuajnë nga anoreksia dhe duhet të vizitohen tek psikologu. Ankuesja nuk mundej të përballonte financiarisht



shpenzimet e vizitave tek psikologu dhe për këtë arsye nuk i kishte vizituar vajzat e saj tek një specialist psikolog.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 17-19, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 20;
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”;
- Urdhëri Nr. 344, date 19.8.2013, i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e Njësisë së Shërbimit Psiko-social” (i ndryshuar).

### **KONKLUZIONE**

Komisioneri konstatoi se E.I., dhe K.I., janë ekspozuar jo vetëm ndaj bullizmit të shokëve të klasës, përgjatë fundit të klasës së VIII dhe gjatë klasës së IX, por edhe ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Shkollës 9- vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, pasi ky institucion nuk u ka ofruar shërbimin e psikologut, në kushtet e problematikave, që vajzat kanë shfaqur në ambientet e shkollës.

Komisioneri gjykoi se E.I., dhe K.I., janë ndodhur para një presioni të madh, në ambientet shkollore. Si pasojë e këtij presioni, vajzave iu ka humbur dëshira për të frekuentuar shkollën dhe kanë derivuar në probleme të tjera, që janë reflektuar në mos ushqyerje, përdorim të veshjeve të errëta, mbyllje në vetëvete e veçim. Fakti që, vajzat janë veçuar nga pjesa tjetër e klasës dëshmon se ato nuk ndjeheshin mire në ambientin rrethues dhe me individët që kishin pranë, nga të cilët fyheshin, talleshin e ofendoheshin. Komisioneri çmon se veçimi i tyre ka qenë i imponuar nga ambienti rrethues. Komisioneri cmoi se të gjitha këto pasoja tek të dy vajzat janë rrjedhim i bullizmit të ushtruar nga shokët e klasës.

Komisioneri gjykoi se të dy vajzat duhet të kishin marrë ndihmën e psikologut të shkollës në momentin e duhur, pasi këshillimi dhe trajtimi nga ana e tij ka qenë tepër i nevojshëm për dy vajzat, gjatë periudhës që ato ndiqnin Shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Shërbimi i psikologut të shkollës nuk u është ofruar E.I., dhe K.I., pavarësisht se janë identifikuar dhe kanë shfaqur problematika, të cilat duheshin trajtuar nga një specialist i tillë.

## ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të E.I., dhe K.I., për shkak të gjendjes shoqërore, nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

Konstatimi i mosdiskriminimit të E.I., dhe K.I., për shkak të gjendjes shoqërore, nga mësueset B.P., dhe A.R.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme, që situata të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen dhe fëmijët me probleme në sjellje të trajtohen menjëherë nga psikologu i shkollës.

Të kryhen shtesat e nevojshme në Rregulloren e Brendshme të Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, lidhur me rastet e nxënësve, që duhet të marrin ndihmën e psikologut në shkollë, si dhe mbi mënyrën dhe procedurën, që duhet ndjekur për të raportuar dhe përcjellë rastet përkatëse tek psikologu i shkollës.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi të hartohet një plan masash, nga ana e ZVA Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, kundër bullizimit, si fenomen që, ndodh shpesh në raportin nxënës me nxënës dhe mësues me nxënës.

Të merren masa nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, për afishimin e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në ambientet e brendshme të të gjitha shkollave, që ndodhen nën juridiksionin e saj.

## ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË PËRKATËSISË PRINDËRORE

### 34. M.Ç., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPP) dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë (DVP Vlorë)

**VENDIM NR. 160, DATË 09.11.2020**

**Shkaku:** Përkatësia prindërore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi është skualifikuar nga konkurimi në Kolegjin e Policisë, për shkak të dyshimit se babai i tij mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale.

#### **FAKTET**

Rezultoi e provuar gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, se M.Ç., ka qenë aplikant në konkurimin për praninë në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP), rezulton se pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve për praninë në Akademinë e Sigurisë, ankuesi është përzgjedhur për të vazhduar fazat e konkurimit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015.

Për sa më sipër, rezulton se M.Ç., ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurimit për në Akademinë e Policisë, duke mbërritur në fazën e Verifikimit Përfundimtar. Në këtë fazë, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë kishte kryer verifikimet përkatëse mbi ankuesin, nëse ai apo pjesëtarë të familjes së tij janë të implikuar në veprimtari kriminale, ku pas verifikimeve të nga strukturat e krimeve, ka konfirmuar se shtetasi M.L.Ç., nuk mund të pajiset me “Vërtetim besueshmërie”, pasi ndaj babait të tij L.G.Ç., gjenden të dhëna që e implikojnë në veprimtari kriminale.

Në këto kushte, pas verifikimit të relacionit Nr. 2545/7, datë 07.10.2019 të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe vërtetimit të besueshmërisë, me Vendimin Nr. 82, datë 21.10.2019, Komisioni i Pranimit, vendosi skualifikimin e M.Ç.

Përsa më lart, ankuesi i ishte drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje. Gjatë shqyrtimit<sup>24</sup> të mosmarrëveshjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në seancë përgatitore, përfaqësuesja e

<sup>24</sup> Referuar paragrafit 3, faqja 13 e Vendimit Nr. 98, datë 10.02.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

palës së paditur, në prapësimet e saj nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar besueshmërinë e M.Ç., por përpara gjykatës është shprehur se: “... *babai i paditësit dyshohet se ka qënë i implikuar në veprimtari kriminale*”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, pas shqyrtimit të mosmarrëveshjes, kishte vendosur pranimin e plotë të kërkesë padisë, i cili është kundërshtuar nga DPP dhe DVP Vlorë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nisur nga veprimet dhe përgjigjet e kthyer nga ana e institucioneve e sipërcituara, ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, i është drejtuar DVP Vlorë, me anë të një kërkesë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar të dhëna për babain e tij L. Ç., gjatë kohës që pati shërbyer në Policinë e Shtetit. Nëpërmjet shkresës Nr. 230/1 Prot., datë 11.06.2020, DVP Vlorë, ndër të tjera ka informuar ankuesin se nuk i disponojnë pasi përditësimi dhe ruajtja e dokumentacionit të personelit bëhet në Kartotekën e Policisë së Shtetit.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 30, 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollit 12 i saj.)
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar), Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, neni 38.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 2, 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.
- Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me Vendimin Nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, neni 139.

### **KONKLUZIONE**

Mbështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ të çështjes rezultoi se:

- Ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e subjekteve kundër së cilave drejtohet ankesa.
- M.Ç., është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas Vërtetimit Negativ të Besueshmërisë, të hartuar nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Sipas këtij vërtetimi, babai i ankuesit është i implikuar në veprimtari kriminale, për të cilën nuk u administrua asnjë provë nga organet kompetente.

- Babai i ankuesit, nuk rezulton të ketë qenë nën hetim nga organi i prokurorisë, nuk ka qenë i gjykuar ndonjëherë për veprën penale të vrasjes nga gjykata kompetente, si dhe referuar gjendjes së tij, gjyqësore, ai rezulton i padënuar.

Për sa më sipër, mbështetur në provat e administruara nga KMD, nuk rezultoi se Vlerësimi i Besueshmërisë, së bërë nga personat përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë të ishte i mbështetur në prova dhe fakte konkrete. Në këtë kuptim, Komisioneri ngre dyshimet e arsyeshme se vlerësimi i tyre është bërë duke përdorur informacione nga burime të jashtme, të cilat kanë rezultuar të pambështetura në fakte dhe prova konkrete.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të M.Ç., për shkak të përkatësisë prindërore, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që M.Ç., të ndjekë studimet pranë Akademisë së Sigurisë në vitin akademik 2020 - 2021.

**35. S.S., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, A.(B.)H., dhe E.M., Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Durrës, M.Rr., Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, në Ministrinë e Brendshme**

**VENDIM NR. 132, DATË 08.10.2020**

**Shkaku:** Përkatësia prindërore dhe gjendja arsimore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi S.S., ka konkuruar për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë dhe ka kaluar suksesshëm fazat e vlerësimit dhe kontrollit, ndërkohë që është skualifikuar gjatë Verifikimit Përfundimtar, pasi në bazë të verifikimeve të kryera nga dy oficerë të policisë gjyqësore, të Drejtorisë Policisë Durrës, babai i tij ka rezultuar se është i involvuar në aktivitet kriminal.

***FAKTET***

Ankuesi S.S., ka konkuruar në muajin janar 2019, për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë dhe ka kaluar suksesshëm fazat e vlerësimit dhe kontrollit (testin e gjuhës angleze, intervistën me gojë, kontrollin shëndetësor dhe verifikimin e gjurmëve të gishtave). Në vijim, ankuesi ka filluar të ndjekë studimet në Akademinë e Sigurisë, ndërkohë që pas 2 javëve, ai njoftohet nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, se nuk ka kaluar me sukses fazën e fundit të pranimit, atë të Verifikimit Përfundimtar dhe si rrjedhim është skualifikuar.

Pas kryerjes së verifikimit përfundimtar, mbështetur në të dhënat e disponuara dhe referuar kritereve të përcaktuara në nenin 139, e Rregullores së Policisë së Shtetit, Komisioni i Vlerësimit ka dalë në përfundimin se S.S., nuk është kandidatë e përshtatshme për t'u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

S.S., pretendon se A.H., dhe E.M., dy oficerët e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Durrës, të cilët kanë hartuar Raportin e Verifikimit Përfundimtar, nuk kanë kryer kërkimet e nevojshme në arkiva dhe kanë dërguar informacione të mangëta dhe të pasakta pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ankuesi pretendon se dy oficerët e policisë gjyqësore ishin kundër pranimit të tij në Akademinë e Sigurisë, pasi ai është student ekselence dhe se në kushtet, kur ai zotëronte nivelin arsimor Master i Shkencave në Menaxhim Bankar, do të fitonte të drejtën për të qenë oficer policie vetëm pas kryerjes së 6 muajve studime pranë Akademisë së Sigurisë e jo pas 3 viteve, sikurse oficerët e sipërpërmendur.

S.S., pretendon se dy oficerët e policisë gjyqësore kanë përdorur kundër tij faktin e një ngjarjeje të ndodhur në vitin 1991, e cila ka lidhje me një sulm të kryer ndaj babait të tij, si

rezultat i së cilit kishte humbur jetën një person. Ankuesi sqaron se babai i tij nuk është dënuar asnjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës e kishte pushuar çështjen ndaj tij. Ankuesi ka depozituar ankesë pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, pranë Ministrisë së Brendshme, nga ku i është komunikuar jo zyrtarisht se është skualifikuar, pasi babai i tij është i përfshirë në aktivitet kriminal.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Konventa Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), neni 14, neni 1, i Protokollit 12;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996) Neni E, Pjesa V;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10;
- Ligjit Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, neni 38;
- Vendimi Nr. 750, datë 16.09.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores për Policinë e Shtetit”, neni 139, pika 4.

### **KONKLUZIONE**

Komisioneri gjykoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e subjekteve kundër së cilave drejtohet ankesa, për shkak të përkatësisë prindërore. Komisioneri çmoi se skualifikimi i S.S., ka ndodhur pasi është supozuar se babai i tij ka qenë i involvuar në aktivitet kriminal, edhe pse një gjë e tillë ka qenë totalisht e pambështetur në fakte dhe prova të besueshme.

- S.S., është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas Vërtetimit Negativ të Besueshmërisë, të hartuar nga ana e personave përgjegjës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës. Sipas këtij vërtetimi, babai i ankuesit është i involvuar në aktivitet kriminal, pasi në vitin 1990 ka kryer një vrasje, për të cilën rezulton i padënuar nga organet kompetente. Gjatë analizimit të fakteve dhe provave rezultoi se babai i ankuesit, M.S.S., nuk rezulton të ketë qenë nën hetim nga organi i prokurorisë, nuk ka qenë i gjykuar ndonjëherë për veprën penale të vrasjes nga gjykata kompetente, si dhe referuar gjendjes së tij, gjyqësore, ai rezulton i padënuar.
- Personat përgjegjës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës kanë hartuar një Vlerësim Besueshmërie të pambështetur në prova, por kanë vepruar duke përdorur

informacione nga burime të jashtme, të cilat kanë rezultuar të pambështetura në fakte dhe prova konkrete.

- Procedurat e miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit për kryerjen e këtyre verifikimeve nuk janë bërë asnjëherë të ditura, fakt që dëshmon për mungesë transparence. Komisioneri gjykoj se punonjësit e policisë kanë diskrecion të gjerë në përcaktimin dhe hartimin e Vërtetimit të Besueshmërisë së individit, që konkurron në Akademinë e Sigurisë. Njëkohësisht mos ekzistenca e transparencës dhe diskrecioni i gjerë ngrenë shqetësime, lidhur me parashikimin e nenit 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, që afekton individët vetëm për shkak se një i afërm i tyre, mund të jetë përfshirë në aktivitet kriminal. Komisioneri gjykon se mohimi i një të drejte nuk mund të vijë si pasojë e mos transparencës, diskrecionit të pakufizuar dhe përgjegjësisë së të tretëve.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të S.S., për shkak të përkatësisë prindërore, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Brendshme.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që S.S., të ndjekë studimet pranë Akademisë së Sigurisë në vitin akademik 2020 - 2021.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.



## ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË

### 36. D.T., kundër Shoqërisë Spiecapag – Shqipëria

**VENDIM NR. 88, DATË 13.08.2020**

**Shkaku:** Gjinia, shtatëzania, amësia  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesja D.T., ka qenë e punësuar në pozicionin e punonjësës së Sigurisë pranë Projektit Rajonal Durrës të shoqërisë Spiecapag – Shqipëria, e cila është shpallur fituese e projektit për ndërtimin e Gassjellësit Tokësor, për Gassjellësin Trans Adriatik Pipeline në Republikën e Shqipërisë. Ankuesja largohet nga puna menjëherë pas rikthimit në punë nga leja e barrë lindjes.

#### **FAKTET**

D.T., ka punuar në pozicionin supervizore sigurie në projektin Rajonal Durrës, pranë Shoqërisë Spiecapag Transadriatika, prej datës 05.04.2016. Në datën 21.01.2019, ajo ka marrë lejen e barrë lindjes. Pas përfundimit të saj, ankuesja pretendon se i është drejtuar punëdhënësit, me shkresën e datës 30.01.2020, nëpërmjet së cilës kërkon rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të, duke shprehur gadishmërinë për të kryer detyrat e saj, si më parë. D.T., e bën me dije shoqërinë, lidhur me detyrimin ligjor, që ky punëdhënës ka në bazë të Kodit të Punës, për ta rikthyer atë në pozicionin e saj të punës, pas përfundimit të lejes së barrë lindjes.

Në datën 03.02.2020, D.T., pretendon se është paraqitur në punë, por menaxheri i saj i ka komunikuar faktin se nuk mund të punojë më në atë pozicion pune, duke e drejtuar për sqarime të mëtejshme pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Ankuesja pretendon se nga specialistja e burimeve njerëzore i është dhënë për nënshkrim akti “Deklaratë e Përbashkët”. Ankuesja ka refuzuar nënshkrimin e këtij akti, pasi pretendon se në bazë të tij, nënkuptohej largimi i saj, vullnetar nga puna.

Në vijim, punëdhënësi dërgon në adresë të D.T., shkresën e datës 05.02.2020, nëpërmjet së cilës sqarohet se gjatë periudhës kohore që ajo ka qenë me leje barrë lindje, shoqëria ka nisur procesin e demobilizimit të punonjësve. Në shkresë sqarohet gjithashtu, se Shoqëria nuk mund të zgjidhte kontratën individuale të punës, për sa kohë që ankuesja ishte me lejen e barrë lindjes, ka vijuar marrëdhënien e punësimit, duke e paguar rregullisht deri në fund të lejes. Në vijim, pas përfundimit të lejes së lindjes, shoqëria e ka lejuar rikthimin e ankueses në punë dhe më pas, në përputhje me nevojat e projektit, e ka njoftuar për zgjidhjen e

kontratës individuale të punës. Në shkresë theksohet gjithashtu fakti se kontrata individuale e punës me D.T., është me afat të caktuar.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, nenit 18, 54/1;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 14;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996), neni 1, pika 8, e Pjesës së I-rë, neni 8, pika 2 j, Pjesa e II-të;
- Shtojca e Kartës Social Europiane, neni 24, pika 3/d/e;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAË) të vitit 1979, nenet 1, 2, neni 11, pika 2, germa a);
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Kodi i Punës, neni 9, neni 105, pika 4, neni 105/1, pika 2;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1 & 6, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a);
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” nenet 2, 4, 6, neni 17, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).
- Ligji Nr. 8829, datë 05.11.2001 “Për ratifikimin e “Konventës Nr.183 “Mbrojtja e Amësisë, 2000”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”, neni 8;
- Case 0460/06 Nadine Paquay v Société d’architectes Hoet + Minne SPRL;

### **KONKLUZIONE**

KMD gjykoi se ankuesja është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga kompania Spiecapag sh.a., për shkak të gjinisë, shtatëzansisë dhe amësisë.

Komisioneri doli në përfundimin se pozicioni i punës së ankuseses ishte suprimuar që gjatë periudhës, që ajo gëzonte lejen e lindjes. Shoqëria ka marrë vendim për të larguar punëmarrësen, që gjatë periudhës së lejes së lindjes, pavarësisht se zbatimi *de jure* i këtij vendimi ka qenë menjëherë pas kthimit të saj në punë, fakt që sërisht është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërpërmendura dhe në kundërshtim me praktikën e GJED-së.

Në kushtet kur, pranë Projektit Rajonal Durrës ekziston 1 pozicion pune për punonjës sigurie dhe ankuesja D.T., ka punuar në atë projekt që prej vitit 2016, Komisioneri gjykon se vendimi për të demobilizuar ankuesen ka qenë diskriminues. L.M., është transferuar pranë projektit Rajonal Durrës në fund të vitit 2019, pavarësisht se punonte për Shoqërinë Spiecapag që prej muajit nëntor 2016. Kriteri përzgjedhës nuk ka qenë performanca në punë, por sikurse citohet në prapësimet e përfaqësuesve ligjorë të Spiecapag. Komisioneri vlerësoi se ankuesja është paragjykuar se nuk do të kryente siç duhet punën e saj, ndërkohë që në shkresën e saj dërguar Shoqërisë në datën 30.01.2020, ajo thekson të kundërtën. Të qënurit nënë e një fëmije që ende nuk ka mbushur 1 vjeç dhe detyrimet përkatëse kanë “trembur” Shoqërinë Spiecapag, e cila ka marrë vendim për largimin e D.T., që ishte me leje lindjeje dhe pritej të rikthehej në pozicionin e mëparshëm të punës, pavarësisht se kishte me tepër kohë, që punonte pranë këtij projekti. Nga arsyetimi i përdorur nga përfaqësuesit ligjorë të Shoqërisë, Komisioneri vlerëson se përveç shtatëzaniës, amësia ka qenë shkak vendimtar për largimin nga puna të D.T.

Ankuesja është larguar nga puna menjëherë pas kthimit nga leja e lindjes. Në organikën e Projektit Rajonal Durrës ekzistonin 2 pozicione për punonjës sigurie, njërin prej të cilëve e mbante D.T., dhe tjerin L.M., i cili edhe pse ishte punësuar pranë Spiecapag në vitin 2016, është transferuar pranë Projektit Rajonal Durrës në fund të vitit 2019. Në kushtet kur, një prej pozicioneve të punonjësve të sigurisë është suprimuar, punëdhënësi ka përzgjedhur L.M., për të qendruar në punë, ndërkohë që ka zgjidhur kontratën e punës me D.T. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer mbi baza objektive, duke u mbështetur tek performanca në punë, apo vjetërsia e secilit punonjës tek Projekti Rajonal Durrës. Justifikimi i Spiecapag mbështetet në faktin se ,L.M. duhet të mbulojë punën në Fier dhe Durrës dhe është menduar dhe konsideruar më i aftë se D.T., për ta kryer një punë të tillë. Në këtë kontekst, Shoqëria Spiecapag ka përzgjedhur një punonjës mashkull dhe e ka konsideruar më të aftë se një punonjëse femër, pavarësisht se D.T., nuk i është parashtruar asnjëherë fakti se duhej të mbulonte punën në Durrës dhe Fier dhe ajo ta ketë kundërshtuar një gjë të tillë. Në shkresën e saj drejtuar Shoqërisë, në përfundim të lejes së saj të barrëlindjes, ankuesja shpreh gadishmërinë për të kryer punën e saj me përkushtim, fakt, i cili nuk është marrë parasysh nga Shoqëria.

## **VENDIMI**

Konstatimi i diskriminimit, të D.T., për shkak të shtatëzaniës, amësisë dhe gjinisë, nga ana e Shoqërisë Spiecapag Transadriatika.

## ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË MOSHËS

**37. M.H.,<sup>25</sup> kundër V.B., Drejtore e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.**

**VENDIM NR. 120, DATË 05.10.2020**

**Shkaku: Mosha, Gjendja Shëndetësore**  
**Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë**  
**Fusha: Punësim**  
**Statusi: Zbatuar**

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune të pandërprera me Universitetin e Shkodrës, duke mbuluar detyra të ndryshme, që nga data 01.04.1980 e në vijim. Me Vendimin Nr. 417/1, datë 12.02.2020, “Për emërim të bibliotekares”, Rektori i Universitetit të Shkodrës, pas kërkesës verbale të të interesuarës ka vendosur që M.H të transferohet nga pozicioni Përgjegjëse e Sektorit Klasifikator/restaurator, në pozicionin Bibliotekare, me kategorinë e pagës IV-b. Subjekti ankues pretendon se ulja në detyrë ka ndodhur për shkak të moshës dhe gjendjes

### ***FAKTET***

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune të pandërprera me Universitetin e Shkodrës, duke mbuluar detyra të ndryshme, që nga data 01.04.1980 e në vijim dhe është në prag të pensionit.

M.H., me Vendimin Nr. 167, datë 03.05.2018 të Rektorit të Universitetit të Shkodrës është emëruar në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit Klasifikator/restaurator me kategorinë e pagës IV-a.

Me shkresën Nr. 84, datë 11.11.2019, Drejtorja e Bibliotekës A.L., i është drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës, duke i paraqitur kërkesën për konsumimin e lejes vjetore të vitit 2019, për punonjësen M.H., për periudhën 10.12.2019 deri në datë 07.01.2020.

Me Vendimin Nr. 380, datë 18.11.2019 të Rektorit të Universitetit të Shkodrës, V.B., është aktivizuar me kontratë pune me afat të caktuar deri në realizimin e procedurave të rekrutimit, në pozicionin e Drejtorit të Bibliotekës Shkencore të Universitetit të Shkodrës.

Subjekti ankues për periudhat nga: 09.11.2019 deri në datë 09.12.2019, 04.02.2020 deri në datë 07.02.2020 dhe 13.02.2020 deri në datë 23.02.2020 ka qenë e pajisur me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë.

<sup>25</sup> Në pozicionin si Përgjegjëse e Sektorit Klasifikim-Restaurim, në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës.

Me Vendimin Nr. 28, datë 15.01.2020 të Rektorit të Universitetit të Shkodrës, M.H.,<sup>26</sup>, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” mbështetur në detyrat dhe rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të KLSH-së .

Me Vendimin Nr. 417/1 Prot, datë 12.02.2020, “Për emërim të bibliotekares”, Rektori i Universitetit të Shkodrës, pas kërkesës verbale të të interesuarës<sup>27</sup> ka vendosur që M.H., të transferohet nga pozicioni Përgjegjëse e Sektorit Klasifikator/restaurator, në pozicionin Bibliotekare, me kategorinë e pagës IV-b.

Drejtorja e Bibliotekës me shkresën Nr. 297, datë 02.03.2020 ka propozuar Rektorit të Universitetit, dhënien e një mase disiplinore për M.H., për mosrealizim të detyrave të ngarkuara dhe fyerje ndaj eprorit.

Administratori i Universitetit të Shkodrës me Urdhrin Nr. 117, datë 02.03.2020 “Dhënie mase administrative” ka urdhëruar që punonjësës M.H, të mos i paguhet dita e punës, datë 02.03.2020, me motivacionin “Për mos-zbatim të urdhërit të eprorit”, masë e cila nuk është ekzekutuar për shkak të gjendjes shëndetësore të punonjësës.

Administratori i Universitetit të Shkodrës pas propozimit të bërë nga Drejtorja e Bibliotekës ka dhënë një masë disiplinore e cila nuk rezulton si masë disiplinore në legjislacionin e brendshëm të universitetit<sup>28</sup>, për më tepër që propozimi dhe masa janë dhënë brenda ditës pa bërë një analizë të situatës dhe pa ndjekur procedurën ligjore.

Me shkresën datë 04.03.2020, M.H., i është drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës, në të cilën është ankuar për Drejtoreshën e bibliotekës për diskriminim në punë lidhur me ndryshimin e pozicionit të punës dhe ndryshimin e bravës së zyrës pa u njoftuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se në mungesë të një procesverbali të mbledhjes apo të një kërkesë zyrtare të bërë nga punonjësja, punëdhënësi, në këtë rast Universiteti i Shkodrës nuk mund të ndërmerre veprimin e ndryshimit të pozicionit të punës së punonjësës, me anë të të cilit ka vendosur uljen në detyrë dhe ndryshimin e kontratës së punës. Referuar sa më sipër, duket që Universiteti i Shkodrës ka dhënë masë disiplinore të uljes në detyrë për punonjësën M.H., duke i ndryshuar pozicionin e punës dhe duke i ulur të ardhurat financiare. Me këtë veprim Universiteti i Shkodrës, nuk i ka dhënë mundësinë punonjësës për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për të dhënë pëlqimin për ndryshimin e pozicionit të punës, duke bërë që ky proces të jetë i njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e universitetit.

<sup>26</sup> Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas Urdhërit të Rektorit të Universitetit, me Nr. 132, datë 14.05.2014, sipas rekomandimeve të raportit të auditimit të KLSH për veprimtarinë e Universitetit të Shkodrës për periudhën 01.01.2015 deri më 31.08.2019.

<sup>27</sup> Sipas citimit të Universitetit, pasi nuk rezulton ndonjë dokument që M.H të ketë kërkuar që të transferohet.

<sup>28</sup> Neni 16 i Rregullores së brendshme të USH dhe neni 49 të Statutit të USH-së.

Mbështetur në provat dhe informacionet e administruara nga palët në proces, nuk evidentohet asnjë fakt, se ndaj ankueses të jenë dhënë masa disiplinore, vlerësime pune negative apo mosmarrëveshje me drejtuesit e mëparshëm.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolle 12 i saj.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>29</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”.
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 37, dhe 92.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 1, 3, 7, 12, 132 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Rektori i Universitetit të Shkodrës, me Vendimin Nr. 417/1, datë 12.02.2020, ka vendosur që M.H., të transferohet nga pozicioni Përgjegjëse e Sektorit Klasifikator/ restorator, në pozicionin Bibliotekare, duke mos i dhënë mundësinë ankueses për t’u dëgjuar, për tu mbrojtur dhe për të dhënë pëlqimin për ndryshimin e pozicionit të punës.

Krahasuar me punonjësit e tjerë, Universiteti i Shkodrës nuk ka ndjekur të njëjtën procedurë për miratimin e lejes vjetore të M.H. Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për mosmiratimin e lejes vjetore ankueses, ka konstatuar se ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjësit e tjerë të cilëve i është miratuar leja vjetore.

Universiteti i Shkodrës, nuk arriti të dokumentonte se ndërrimin e bravës së zyrës së M.H., dhe ndryshimi i mjedisit të punës ishte bërë për qëllime teknike dhe se punonjësja ishte informuar për këtë fakt.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Universiteti i Shkodrës, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion lidhur me:

- Kërkesën e bërë nga ankuesja për ndryshimin e pozicionit të punës.

<sup>29</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

- Mosrealizimet e detyrave të punës nga ana e ankueses.
- Procedurën e përdorur për ndërrimin e bravës së zyrës së ankueses dhe se ajo ishte në dijeni të këtij veprimi.
- Procedurën e ndjekur për dhënien e masës disiplinore për mospagimin e ditës së punës.
- Mosmiratimin e kërkesës për konsumimin së lejes vjetore të M.H.

Komisioneri vlerëson se Universiteti i Shkodrës dështoi të provonte përpara Komisionerit se, ndryshimi i pozicionit të punës së ankueses është bërë për arsye të rritjes së performancës së punës së institucionit dhe jo për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe diskriminues nga ana e Universitetit të Shkodrës, pikërisht për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore të ankueses.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit, të shtetasës M.H., nga ana e Universitetit të Shkodër, për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Universitetit të Shkodrës, të merren masa për kthimin e M.H., në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit Klasifikator/restaurator.

### 38. K.K., kundër Bashkisë Kavajë

#### VENDIM NR. 102, DATË 10.09.2020

**Shkaku:** Mosha, Bindjet politike  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Kavajës, në detyrën “Specialist/Jurist” pranë Njesisë Administrative Golem, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit. Me datë 12.11.2019 i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, dhe ankuesi ka pretenduar se kjo ka ndodhur për shkak të moshës dhe bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të titullait të Institucionit.

#### **FAKTET**

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Kavajë, me datë 04.09.2017, në detyrën “Jurist” në Agjencinë e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë. Me datë 15.10.2019 ai është transferuar në Njësinë Administrative Golem, në pozicionin “Specialist/Jurist” pranë Njesisë Administrative Golem, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 3608/1 Prot., datë 16.10.2019 ankuesi ka kërkuar anulimin e Urdhrit të transferimit, pasi, akti nuk merr në konsideratë moshën e tij, gjendjen shëndetësore, uljen në pagë në dëm të tij, distancën e vendit të punës ku do të transferohet, si dhe kualifikimin profesional.

Vetëm një muaj pas këtij transferimi, me datë 12.11.2019 ankuesi është larguar nga puna, për shkak të moskryerjes së një procedure konkurimi të hapur e cila është e vetmja mënyrë për plotësimin e pozicioneve të punës së kategorive ekzekutive, përcaktuar në Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ: “Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar”. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H., and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.



- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>30</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 9, 111, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 10, 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Kavajë, nuk vuri në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, duke dështuar të provonte përpara Komisionerit se:

- Ankuesi nuk ka kundërshtuar dhe ka pranuar vendimin e transferimit, ndërkohë që faktohet e kundërta, që e ka kundërshtuar shkresërisht këtë pozicion pune.
- Emërimi i punonjësës që ka zëvendësuar ankuesin ishte i ligjshëm, i arsyeshëm dhe i justifikuar.
- Transferimi i tij ishte i ligjshëm, i justifikuar dhe në përputhje me kushtet e kontratës individuale të punës me të.
- Transferimi i tij nuk ka sjellë ndryshim të kushteve të kontratës individuale të punës dhe nuk ka qenë në dëm të tij si punëmarrës.

Komisioneri vlerësoi se argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se transferimi i tij është kryer për motive politike.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara, rezultoi se:

- Ankuesi është i datëlindjes 02.11.1957, pra 62 vjeç në momentin e transferimit dhe për më pak se 3 vite mbush moshën e daljes në pension.
- A.K., është e datëlindjes 14.01.1988, aktualisht 31 vjeç.

Bashkia ka dështuar të provojë para Komisionerit se, emërimi i punonjësës A.K., në pozicionin e ankuesit është bërë për arsye të ligjshme, të justifikuara dhe proporcionalisht me nevojën e diktuar të Institucionit.

Me transferimin në Njësinë Administrative Golem, ankuesit i duhej të bënte rreth 18 km rrugë në ditë vajtje/kthim. Këtë udhëtim të përditshëm përveç kostos financiare, ia

<sup>30</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

vështirësonte dhe moshën e tij, pasi në momentin e transferimit, ai ishte rreth tre vite para daljes në pension. Për rrjedhojë ky transferim, përveçse në shkelje të procedurës së rregullt ligjore, është i pajustificuar dhe joproportional në raport dhe me moshën e tij.

Në konkluzion të sa mësipër, Komisioneri vlerësoi se nga ana e punëdhënësit, duhet të ishte marrë në konsideratë fakti që ankuesi kishte më pak se 3 vite për të plotësuar moshën e daljes në pension dhe njëherësh konstaton se Bashkia Kavajë ka shkelur nenin 12 të LMD, duke diskriminuar subjektin ankues, për shkak të moshës së tij.

Mbështetur në sa mësipër, rezultoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, për shkak të bindjeve politike dhe moshës, përse i takon largimit të tij nga puna.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, K.K., për shkak të “*bindjeve politike*” dhe të “*moshës*”, nga ana e Bashkisë Kavajë.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

**39. S.S., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier dhe Shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier**

**VENDIM NR. 151, DATË 28.10.2020**

**Shkaku:** Gjendja shëndetësore, çdo shkak tjetër<sup>31</sup>  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjekti ankues, është me profesion mësuese e lëndës “Gjuhë dhe letërsi”, me vjetërsi mbi 25 vjeçare në mësimdhënie, prej të cilave 15 vite ka punuar në shkollën 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë, Fier. Për periudhën nga data 27.10.2015 deri më datë 10.01.2019 ka qenë drejtuese e kësaj shkolle<sup>1</sup>. Nëpërmjet shkresës me Nr. 08 Prot., datë 07.01.2019 “Për ulje në detyrë” është liruar nga detyra e drejtores. Është ankuar për diskriminim ndaj ish-DAR Fier lidhur me uljen në detyrë nga pozicioni i drejtores së Shkollës, si dhe kundrejt drejtorit të Shkollës për sjellje diskriminuese ndaj saj, gjatë marrëdhënieve të punës.

### ***FAKTET***

Subjekti ankues ka pretenduar diskriminim nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier<sup>32</sup> dhe Shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier.

*Përsa i takon pretendimeve ndaj Shkollës, ankuesja ka parashtruar se:*

Pas largimit të saj nga detyra e drejtueses së Shkollës, është zëvendësuar nga SH.D., dhe menjëherë pas emërimit të tij në këtë pozicion ka lindur një konflikt i hapur, i vazhdueshëm dhe se nga ana e Shkollës ishin ndërmarrë veprime të padrejta dhe të paligjshme, përsa i përket: mosnjohjes së raportit mjekësor duke i nxjerrë pengesa për plotësimin e regjistrave të shkollës, moszëvendësimin të saj me një mësues tjetër të Shkollës në kushtet kur ajo kishte njoftuar mungesën në punë për shkak të gjendjes shëndetësore. Si dhe, dy masave disiplinore të dhëna ndaj saj dhe procedurës së ndjekur për dhënien e tyre.

*Përsa i takon pretendimeve ndaj DRAP Fier, ankuesja ka parashtruar se:*

<sup>31</sup> Ankuesja referon tek ky shkak konfliktin e krijuar mes saj dhe drejtueses së ish DAR Fier përshkallëzuar me denoncimet e saj mediatike, si dhe konfliktin e krijuar mes saj dhe drejtorit të Shkollës për shkak të denoncimit nga ana e tij në organin e Prokurorisë të bashkëshortit të saj.

<sup>32</sup> Ish-DAR Fier.

Me drejtorin e emëruar Sh.D., ishin krijuar marrëdhënie konfliktuale për shkak se ky i fundit me datë 26.09.2017 kishte denoncuar dhe dërguar për ndjekje penale bashkëshortin e saj. Lidhur me këtë çështje ishte shprehur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila nëpërmjet Vendimit Nr. 62/2018/74/6 ka vendosur deklarin të pafajshëm të S.S., bashkëshorti i ankueses.

Ankuesja, pas paraqitjes dhe bërjes publike të problematikës së saj<sup>33</sup>, nëpërmjet emisionit televiziv investigativ “Stop” në televizionin kombëtar TV Klan, me datë 24.04.2019, ndaj saj janë ndërmarrë një sërë veprimesh diskriminuese nga drejtuesit e Shkollës dhe ato të ish-DAR Fier /DRAP Fier. Ish- DAR Fier/DRAP Fier kishte iniciuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj saj dhe në përfundim kishte vendosur uljen në detyrë nga drejtore në mësuese.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>34</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- Udhëzimi Nr. 57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.

### **KONKLUZIONE**

Komisioneri, bazuar në aktet shkresore të disponuara, vlerësoi se, nga ana e drejtorit të Shkollës kishte mungesë të theksuar bashkëpunimi me ankuesen.

<sup>33</sup> Lidhur me konfliktet e vazhdueshme mes saj dhe Drejtorit të Shkollës dhe Drejtores së DRAP Fier.

<sup>34</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

- Gjatë procedurës administrative rezultoi se ankueses i ishte pamundësuar puna me regjistrat, pikërisht për shkak të konflikteve që ajo kishte me drejtorin e Shkollës.
- Po ashtu, ankuesja kishte njoftuar Shkollën për arsyen e mungesës së saj në punë dhe e kishte dokumentuar atë. Në këto kushte, pretendimi i drejtorit të Shkollës se mësuesja ka vonuar nxjerrjen e rezultateve përfundimtare të nxënësve, përmes mosplotësimit të regjistrave, nuk qëndron, është i pabazuar, si dhe në shkelje të parashikimeve ligjore, pasi; në kushtet kur ajo ka njoftuar dhe provuar me dokument mjekësor mungesën e saj për shkaqe shëndetësore, drejtori i Shkollës duhet të ngarkonte me urdhër të brendshëm, një mësues tjetër të kësaj Shkolle për nxjerrjen e rezultateve përfundimtare, duke ndjekur dhe procedurën e rregullt lidhur me këtë.
- Nga ana tjetër, Komisioneri vlerësoi se, përsa i takon dhënies së “Vërejtjes” me datë 27.06.2019 kundrejt ankueses, procedura e ndjekur nga drejtoria e Shkollës ishte në shkelje të rëndë të parashikimeve ligjore lidhur me dhënien e masave disiplinore dhe tërësisht e padrejtë. Nga ana e Shkollës nuk u sollën argumenta bindës, prova dhe fakte që të provonin se ankuesja nuk ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë, si përsa i takon masave që duheshin marrë për periudhën kur ajo ishte me raport mjekësor, ashtu dhe përsa i takon masave disiplinore të dhëna ndaj saj.

Lidhur me momentin e “Uljes në detyrë” të ankueses nga ana e ish-DAR Fier/DRAP Fier, Komisioneri, pas këqyrjes së dokumentacionit dhe analizimit të legjislacionit përkatës, vlerësoi se:

- Motivacioni i paraqitur nga ish-DAR Fier se: *“Ankuesja ka thyer parimin e mirëbesimit dhe nuk ka vepruar në përputhje me standardet e drejtorit të institucioneve arsimore duke bërë të pamundur ushtrimin e detyrës së drejtorit”*, ishte i pabazuar dhe i pa mbështetur në legjislacion. Veprimet të cilat ish-DAR Fier i atribuon ankueses si veprime nëpërmjet të cilave ajo ka thyer parimin e mirëbesimit, nuk i referohen veprimeve të kryera prej saj në funksion të detyrës si drejtoresh, por nga bashkëshorti i saj, në cilësinë e prindit të fëmijës së tyre.
- Procedura e ndjekur për uljen në detyrë të ankueses ishte në shkelje të rëndë të drejtave ligjore të saj përsa përcaktojnë aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe Komisioneri arriti të provonte se referimi i ish-DAR Fier si shkelje të ankueses, lidhur me emërimin e një mësuesi ndihmës jashtë këtij portali ishte pa sens dhe alogjik, në interpretim të vetë udhëzimit më sipër, të ish-DAR Fier. Nga ana tjetër, ish-DAR Fier, kishte aprovuar vetë nënshkrimin e kontratës me mësuesen ndihmëse, për të cilën ishte pyetur më parë nga ankuesja.

DRAP Fier nuk solli prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se ulja në detyrë e ankueses kishte ardhur për arsye të ligjshme apo të ishte veprim i arsyeshëm dhe i justifikuar.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të hetuara, Komisioneri vlerësoi se, subjekti ankues, ishte ekspozuar haptazi para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e ish-DAR Fier/DRAP Fier, pikërisht për shkaqet e faktuara prej saj.

### ***VENDIMI***

Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, S.S., ardhur për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe drejtueses së ish-DAR Fier, nga ana e DRAP Fier.

Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, S.S., ardhur për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe drejtorit të Shkollës, dhe për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, nga ana e shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier.

Shkolla 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë të marrë masa të menjëhershme për ndalimin e trajtimit dhe qëndrimit diskriminues ndaj ankueses.

#### 40. M.T., kundër Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

**VENDIM NR. 42, DATË 29.04.2020**

**Shkaku:** Gjendja shëndetësore  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Arsim  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Ankuesi M.T., i cili kishte aplikuar pranë Akademisë së Sigurisë, për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, për “Patrullë e Përgjithshme”, skualifikohet gjatë fazës së kontrollit shëndetësor, për shkak se rezultoi me Hepatit B.

#### **FAKTET**

Ankuesi M.T., ka qenë aplikant në konkurimin për pranim në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë. Pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve për pranimin në Akademinë e Sigurisë, të përcaktuara në nenin 38, të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ankuesi është përzgjedhur për të vazhduar fazat e konkurimit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015.

Ankuesi ka kaluar me sukses fazën e testimit me shkrim, testimit të aftësive fizike, intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit dhe testimit psikologjik, të parashikuara nga gërmat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 135, pika 1, të Rregullores së Policisë së Shtetit. Bazuar në gërmën “d”, të nenit 135, të Rregullores së Policisë së Shtetit faza e radhës e konkurimit është kontrolli shëndetësor.

Në bazë të nenit 137, të Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se :“*Aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimit. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.*” Në bazë të Procedurës Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV, “*Kriteret Shëndetësore*”, pika 8, “*Kriteret për sëmundjet infektive*”, përcaktohet se: “*Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe të mos jenë bartës të ndonjë sëmundje ngjitëse. Nuk do të pranohen ata aplikantë të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv ose jo) Nëse kursanti gjatë periudhës së studimit del me Hbs pozitiv, largohet nga Akademia e Sigurisë. Nuk do të pranohen as ata aplikantë, të cilët janë bartës të hepatitit C apo virusit HIV dhe që mund të kenë vijueshmëri shenja përmirësimi.*”

Gjatë fazës së kontrollit shëndetësor, nga ekzaminimet mjekësore të kryera nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor ankuesi ka rezultuar me Hepatit B (Hbs pozitiv). Meqënëse ankuesi

nuk ka kaluar fazën e kontrollit shëndetësor, është s’kualifikuar nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor dhe ka humbur të drejtën për të kaluar në fazën tjetër të konkurimit.

Ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion një dokument i shkruar apo vendim në lidhje me arsyet e skualifikimit që ai të ushtronte të drejtën e ankimit.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 dhe 57
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 14 dhe Protokolli Nr.1, Neni 2,
- Vendimi Nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- *I.B kundër Greqisë dhe Kiyutin kundër Rusisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut,
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale Ekonomike, Sociale dhe Kuturore, neni 2/2, 13/2,
- Ligji Nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, neni 1, 3 neni 7, Neni 17,
- Ligji Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, neni 5, 38,
- Rregullorja e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015
- Urdhri Nr. 984 datë 17.12.2015, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Procedurat standarte për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve*”.
- Ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”,
- Ligji Nr. 15/2016 “*Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive*”,
- Kodi i Procedurave Administrative, neni 12/2,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 20 datë 02.07.2009 “*Për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*” miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore (KDESK)
- Rekomandim (2001)10 “*Mbi Kodin Evropian të Etikës së Policisë*”, miratuar në datë 19.09.2001 nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës.
- Rezoluta WHA63.18, miratuar në vitin 2010 nga Asambleja Botërore e Shëndetit,
- Strategjia globale e sektorit të shëndetit mbi Hepatitin Viral, 2016-2021, miratuar në vitin 2016, nga Organizata Botërore e Shëndetit.
- Rezoluta S-26/2, miratuar më datë 27.06.2001 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara “*Deklaratë Angazhimi për Hiv/Aids; Rezoluta nr. 1995/44, e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut Për diskriminimin dhe stigmën në lidhje me Hiv/Aids;*
- Udhëzimet Ndërkombëtare për Hiv/AidN dhe të Drejtat e Njeriut (versioni i konsoliduar 2006) botuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe UNAIDS;



- Rekomandimi 1116 (1989) Mbi Aids dhe të Drejtat e Njeriut, i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës;
- Rezoluta 1536 (2007) Mbi Hiv/Aids në Evropë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës;
- Rekomandimin për Menaxhimin e Virusit të Hepatitit B- Punonjësit e infektuar të kujdesit shëndetësor dhe studentët, Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC), në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përditësuar në 6 korrik 2012.

## **KONKLUZIONE**

Komisioneri vlerësoi se diferencat në trajtim që bazohen në faktin që një person jeton apo është prekur nga hepatiti B, do të konsiderohet si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen shëndetësore.

Komisioneri arriti në përfundimin se, kriteri përjashtues i përcaktuar në Procedurat Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV “Kriteret shëndetësore”, pika 8 “Kriteret për sëmundjet infektive”<sup>35</sup> i cili përjashton personat që rezultojnë me Hepatit B, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit. Komisioneri vlerësoi se ky kufizim nuk është një kufizim që ka të bëjë me kriteret të meritës apo aftësisë dhe se parashikimi në Procedurat Standarte ka cënuar aspekte të tilla të rëndësishme si aksesueshmëria dhe parashikueshmëria që duhet të përmbushë akti që ndërhyr në të drejtat dhe liritë e individit. Rrezultoi se ankuesit i ishte cënuar e drejta për ankim.

Ankuesi kaloi me sukses fazat e konkurrimit sipas rendit të përcaktuar nga aktet përkatëse, pra testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike, intervistën me gojë, ushtrimet vlerësuese dhe testimin e aftësive të shkruarit dhe në fund testimin psikologjik. Ankuesi u skualifikua për të kaluar në fazën tjetër të konkurimit pasi ai rezultoi pozitiv me hepatit B. Ky shkak u konfirmua nga DPPSh, si shkak i vetëm i skualifikimit të ankuesit për të vazhduar në fazat e tjera të mbetura të konkurimit. Për këtë arsye Komisioneri vlerësoi se ankuesi ndodhej në situatë të njëjtë me atë të aplikantëve të tjerë të cilët kishin kaluar me sukses sikundër edhe ankuesi deri në fazën e kontrollit shëndetësor, fazë të cilën ankuesi nuk e kaloi pikërisht për shkak të statusit të tij me hepatit B.

Trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në lidhje me qëllimin e ligjshëm, DPPSH nuk mbajti asnjë qëndrim në lidhje me faktin se cili ishte qëllimi për vendosjen e një kriteri për skualifikimin e aplikantëve të cilët kanë antigen

---

<sup>35</sup> Miratuar me Urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

pozitiv. Në mungesë të një qëndrimi nga ana e DPPSH, Komisioneri kryesisht analizoi se, hepatiti B është një infeksion i mëlçisë i shkaktuar nga virusi i hepatitit B, që mund të shkaktojë infeksion akut dhe kronik të saj. Hepatiti B ashtu sikundër llojet e tjera të hepatiteve virale (A,C,D,E) hyn në kategorinë e sëmundjeve infektive. Për rrjedhojë parandalimi i rrezikut të infektimit të personave të tjerë padyshim që përbën një qëllim të ligjshëm për vendosjen e një mase të tillë kufizuese. Një arsye tjetër për vendosjen e një kriteri të tillë nuk mund të mos kishte lidhje me faktin që në përfundim të shkollimit studentët e Akademisë së Sigurisë do të emërohen si punonjës policie. Në këtë moment fillojnë marrëdhëniet e punës në policinë e shtetit dhe studentët fitojnë statusin e punonjësit të policisë. Për kryerjen e detyrave punonjësit e policisë duhet të jenë në gjendje për kryerjen e detyrave dhe padyshim që gjendja shëndetësore mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të kryer detyrat. Kështu që, është e qartë se shqetësimi për të siguruar kapacitetin operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor përbën një objektiv të ligjshëm.

Në lidhje me marrëdhënien e arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet, Komisioneri vlerësoi se masa në fjalë, pra kriteri që skulifikon aplikantët që rezultojnë pozitiv me Hepatit B (aktiv ose jo aktiv), nuk është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të parandalimit të transmetimit të sëmundjes. Ndalimi për të ndjekur arsimin mund të jetë i nevojshëm dhe i përshtatshëm gjatë fazës akute të hepatitit B, pra për një periudhë provizore dhe jo duke mohur aksesin në arsim për personat pozitiv me hepatit B. Kriteri në Procedurat Standarte mohon plotësisht të drejtën e ankuesit për të ndjekur arsimin e lartë të zgjedhur prej tij. Një kufizim i tillë nuk bazohet në asnjë të dhënë, raport apo studim se ndjekja e studimeve apo puna si punonjës policie mbart një rrezik më të shtuar për transmetimin e virusit ndërkohë që potencialisht të gjithë njerëzit janë të rrezikuar për të infektuar.

Standartet ndërkombëtare në këtë fushë ndalojnë autoritetet që t'i mohojnë dhe kufizojnë të drejtën nxënësve për të patur akses në arsim. Kufizimi për të ndjekur studimet në këtë institucion të arsimit të lartë nuk gjen mbështetje në masat që propozohen për parandalimin e përhapjes së virusit që janë, transfuzion i sigurt i gjakut, përdorim i sigurt i injeksioneve, promovimin e praktikave të seksit të sigurt dhe imunizimin nëpërmjet vaksinimit. Përfundimi i ankuesit për të ndjekur arsimin e zgjedhur prej tij nuk qëndron në një përpjestim të arsyeshëm me qëllimin për parandalimin e transmetimit të virusit.

Vërtetë që arsimi i lartë kushtëzohet nga kriteri i aftësisë, por në rastin në fjalë kriteri shëndetësor nuk ka të bëjë me aftësitë dhe meritën e ankuesit. Nga të gjitha provat e administruara nuk rezultoi që ankuesi për shkak të gjendjes shëndetsore nuk është i aftë të ndjekë arsimin. Ankuesi ka kaluar me sukses fazën e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme që parashikojnë se aplikanti duhet të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për punë. Ankuesi ka kaluar me sukses testimin me shkrim të njohurive dhe testimin fizik që janë të lidhura me vlerësimin e aftësive të tij. Bazuar në përgjigjen e marrë nga Instituti i

Shëndetut Publik, një person bartës i hepatit B mund të ndjekë arsimin me përjashtim të personave gjatë fazës akute të hepatit B. Ankuesi nuk ishte i sëmurë me hepatit B por është thjesht bartës i saj dhe nuk përbënte rrezik për shëndetin.

Gjithashtu aftësitë e punonjësit të policisë për të kryer detyrat testohen në mënyrë periodike dhe është një masë objektive për të përjashtuar mundësinë e mbajtjes në punë të punonjësve që nuk janë të aftë për të kryer detyrat. Gjendja shëndetësore e punonjësit të policisë që mund të ndikojë në aftësinë e tij për të kryer detyrat është objekt i kontrolleve periodike, jo më pak se një herë në vit, sipas përcaktimeve të Rregullores së Policisë së Shtetit. Ky parashikim bën një vlerësim individual dhe rast pas rasti të punonjësve në lidhje me aftësitë e tyre për të kryer detyrën. Në këtë mënyrë kufizimi i vendosur në Procedurat Standarte nuk vendos një raport të drejtë midis qëllimit të synuar dhe mjeteve të përdorura, pasi qëllimi i synuar mund të arrihet me mjete që vënojnë më pak të drejtën e personit.

Nuk ka shumë studimeve në dispozicion që të tregojnë se si mungesa e njohurive në lidhje me përhapjen e virusit të hepatit B çon në stigmatizimin dhe veçimin e personave që jetojnë me këtë virus. Po për shkak të ngjashmërisë së mënyrës së përhapjes së tij me virusin HIV, padyshim që kjo mund të çojë në të njëjtin rezultat si në rastin e personave me status HIV pozitiv. Në këtë kontekst, rezulton se, personat me HIV pozitiv përballen me një mori problemesh, jo vetëm mjekësore, por edhe profesionale, sociale, personale dhe psikologjike, dhe mbi të gjitha ndonjëherë me paragjykime të rrënjësura thellë edhe në mesin e njerëzve më të arsimuar. Injoranca për mënyrën se si përhapet sëmundja ka sjellë paragjykime të cilat, nga ana tjetër, stigmatizojnë ose marginalizojnë ata që janë të infektuar me virusin. (*shiko Kiyutin kundër Ruisisë dhe I.B., kundër Greqisë*) Rezoluta WHA67.6 e Asamblesë Botërore të Shëndetit për të promovuar veprime ndërkombëtare për të parandaluar, diagnostifikuar dhe trajtuar hepatitin viral, pranon ekzistencën e stigmatizimit dhe diskriminimit, kur thekson nevojën për të luftuar dhe eliminuar stigmatizimin dhe diskriminimin e personave që jetojnë ose janë të prekur nga hepatiti viral dhe vendosmërinë për të mbrojtur dhe siguruar të drejtat e njeriut për këta persona.

Në këto kushte Komisioneri vlerësoi se është cënuar parimi i proporcionalitetit pasi nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme midis qëllimit të ligjshëm të synuar dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Kufizimi i vendosur vendos një barrë jo të arsyeshme mbi ankuesin. Pra, DPPSH, nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin ndryshe të ankuesit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore si person pozitiv me hepatit B.

Komisioneri konstatoi se, Procedurat Standarte vendosin kufizime edhe për personat me status HIV pozitiv dhe hepatit C. Këto dy kategori nuk ishin objekt i ankesës në shqyrtim, megjithatë për të gjitha arsyet e mësipërme Komisioneri ngriti shqetësimin edhe në lidhje me skualifikimin e aplikantëve që rezultojnë me hepatit C dhe HIV apo largimin e studentëve që mund të preken nga virusi gjatë ndjekjes së studimeve. Komisioneri vlerësoi se, përgjegjësia i

takonte Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit pasi kriteri s'kualifikues ishte përcaktuar në Procedurat Standarte të miratuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe se Akademia e Sigurisë nuk kishte konsumuar sjellje të tilla të cilat të kishin cënuar të drejtën e ankuesit.

Komisioneri vlerësoi se, edhe nëse kriteri që s'kualifikon personat me status pozitiv të hepatit B do të ishte parashikuar në Ligjin "Për Policinë e Shtetit", për të gjitha arsyet e mësipërme një kriter i tillë nuk do ishte i përligjur nga një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankuesit për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore si person pozitiv me hepatit B, nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Komisioneri konstaton se ankuesi është diskriminuar për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore për të gëzuar akses të barabartë në arsim dhe se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka shkelur dispozitat e Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të ankuesit M.T., për shkak të gjëndjes shëndetësore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke i dhënë mundësinë ankuesit që të kalojë në fazën tjetër të konkurimit të parashikuar në nenin 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për heqjen e kriterit s'kualifikues për personat pozitiv me hepatit B (aktiv ose jo aktiv) të parashikuar në Kreun IV, "Kriteret Shëndetësore", pika 8, "Kriteret për sëmundjet infektive", të Procedurave Standarte "Për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve", të cilat janë miratuar me urdhrin Nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për rishikimin në tërësi të Procedurave Standarte me qëllim identifikimin dhe eliminimin e kritereve kufizues për të cilët nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për hartimin e politikave për parandalimin dhe trajtimin e hepatiteve virale dhe HIV/Aids në Policinë e Shtetit.

Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit nga ana e Akademisë së Sigurisë.

## ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

### 41. Çështja ex-officio mbi ngjarjen e ndodhur në datën 04.02.2020 në Teatrin ArTurbina

**VENDIM NR. 59, DATË 05.06.2020**

**Shkaku:** Aftësi e kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Në kuadër të “*Javës Kundër Diskriminimit*”, me rastin e 10-vjetorit të krijimit dhe funksionimit të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 04.02.2020, pranë Teatrit ArTurbina u zhvillua shfaqja Teatrale “Sfida”, ku aktorë ishin persona me aftësi të kufizuara dhe jo të tillë. Drejtori i këtij teatri përdoruri fjalor fyes ndaj personave me aftësi të kufizuar duke kërkuar ndërprerjen e shfaqjes.

#### **FAKTET**

Në pasditen e datës 04.02.2020, pranë Teatrit ArTurbina u zhvillua shfaqja Teatrale “Sfida”, ku aktorë ishin persona me aftësi të kufizuara dhe jo të tillë. Për zhvillimin e kësaj shfaqjeje, e cila u organizua nga një sërë aktorësh<sup>36</sup>, ishte marrë paraprakisht leja përkatëse nga Ministria e Kulturës. Shfaqja ishte një ndër aktivitetet e parashikuara për t’u zhvilluar në kuadër të “*Javës Kundër Diskriminimit*”, me rastin e 10-vjetorit të krijimit dhe funksionimit të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas planifikimit përkatës, ora e përfundimit të shfaqjes ishte ora 18:00. Pikërisht në këtë orë, K.L., Drejtor i teatrit ArTurbina u paraqit pranë derës së sallës, ku zhvillohej shfaqja teatrale, e cila ishte në përfundim e sipër. Ai kërkoi me zë të lartë, që të pranishmit në sallë të dilnin jashtë, se orari i shfaqjes kishte përfunduar, si dhe kërcënoi për mbylljen e dritave të sallës, duke përdorur fjalor fyes ndaj personave me aftësi të kufizuar e duke i cilësuar ata “të metë”.

Në kushtet kur, një pjesë e spektatorëve dhe aktorëve në sallë ishin persona me aftësi të kufizuar, ku shumë prej tyre ishin të verbër apo individë, që lëviznin me karrocë me rrota, organizatorët e shfaqjes kërkuan disa minuta kohë shtesë, që këta persona të dilnin nga salla.

<sup>36</sup> Shfaqja teatrale u organizua nga një sërë aktorësh, ku përfshihen Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ADRF, Caritas Shqiptar, Caritas Dioqezan Tiranë Durrës, Klubi i prindërve të fëmijëve me çregullime të Spektrit Autik, Kolegjit Don Bosko, përfaqësues të komunitetit të personave që nuk shikojnë dhe Ministria e Kulturës.

Në kundërpërgjigje, drejtori i këtij teatri u soll në mënyrë jo institucionale dhe në mungesë të çdo etike me ta.

Organizatorët e shfaqjes theksojnë faktin se fryma aspak bashkëpunuese e stafit të këtij teatri, ishte vënë re edhe në ditët para zhvillimit të shfaqjes. Aktorëve dhe stafit organizator nuk iu vunë në dispozicion punëtorët e skenës, si dhe nuk u lejuan të zhvillonin qetësisht provat përfundimtare.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, neni 4 dhe 5;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, pikat II/1, VIII/c;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996), Neni E, Pjesa V;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 5, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa c).

### **KONKLUZIONE**

Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i individëve me aftësi të kufizuar, pjesëmarrës në shfaqjen teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020, në këtë teatër, si pasojë e sjelljes aspak të përshtatëshme, në adresë të tyre, nga ana e K.L., Drejtor i Teatrit ArTurbina.

Komisioneri gjykoi se veprimet e K.L., kanë sjellë shqetësim, kanë krijuar një mjedis poshtërues e ofendues, si dhe kanë shkelur dinjitetin, e dy kategorive individësh, në shfaqjen teatrale, të zhvilluar në datën 04.02.2020, në Teatrin ArTurbina.

- Kategoria e parë, së cilës i është shkelur dinjiteti dhe i është krijuar shqetësim nëpërmjet sjelljes dhe fjalëve të K.L., është ajo e të gjithë personave me aftësi të kufizuar, që ndodheshin në sallën teatrale të Teatrit ArTurbina, ku bëjnë pjesë jo vetëm ata individë që performonin në shfaqje, por edhe ata që ishin në rolin e spektatorit apo organizatorit të kësaj shfaqjeje.
- Kategoria e dytë e individëve, të cilët janë ekspozuar ndaj shqetësimit dhe poshtërimit nga ana e sjelljes dhe fjalëve të K.L., përbëhet nga të gjithë ata individë që ishin prindër dhe të afërm të personave me aftësi të kufizuar, që aktronin në shfaqje.

## ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit, *në formën e shqetësimit*, për shkak të aftësisë së kufizuar, të të gjithë personave me aftësi të kufizuar, që morën pjesë në cilësinë e aktorëve, spektatorëve apo organizatorëve, të shfaqjes Teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020, në Teatrin ArTurbina, nga K. L., Drejtor i këtij teatri.

Konstatimi i diskriminimit, *në formën e shoqërimit*, për shkak të aftësisë së kufizuar, të të prindërve dhe të afërmeve të personave me aftësi të kufizuar, të përmendur në pikën 1 të Vendimit, që morën pjesë në rolin e spektatorëve në shfaqjen Teatrale “Sfida”, që u zhvillua në datën 04.02.2020 në Teatrin ArTurbina, nga K. L., Drejtor i këtij teatri.

Në referencë të pikave 1 dhe 2, të këtij Vendimi, K.L., duhet të kërkojë falje publike ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuar.

#### 42. S.K., kundër operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k.,

##### VENDIM NR. 44, DATË 12.05.2020

**Shkaku:** Aftësi e kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Në datën 12.12.2019, ankuesja, që është invalide pune, ka udhëtuar me njërin nga autobusët e linjës ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë. Faturino i autobusit të kësaj linje i ka marrë Dëshminë e lëshuar nga Shoqata e invalidëve të Punës të Shqipërisë dhe nuk ia rikthyer më.

#### **FAKTET**

Në datën 12.12.2019, ankuesja ka udhëtuar me njërin nga autobusët e linjës ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë. Ankuesja S.K. është invalide e plotë e punës dhe dispononte Dëshminë nr. 1551, datë 03.11.2018, të lëshuar nga Shoqata e invalidëve të Punës të Shqipërisë. Vlefshmëria e dëshmisë së sipërcituar ka qenë 1 (një) vit, dmth nga data 03.11.2018 – 03.11.2019. Në kushtet kur, ajo gëzonte statusin e invalidit të punës, në bazë dispozitave ligjore, duhet të përfitonte udhëtim me 50 për qind të vlerës së biletës, por ajo pretendon se nuk ka qenë e vetëdijshme për skadencën e këtij dokumenti. Në momentin e paraqitjes së Dëshmisë tek faturino i autobusit, ky i fundit ka konstatuar se vlefshmëria e Dëshmisë së Invaliditetit të ankueses kishte përfunduar prej më shumë se 1 muaji. Pasi është njohur lidhur me faktin e skadencës së dëshmisë së invaliditetit, ankuesja i ka kërkuar faturinos që t’ia kthejë mbrapsht dokumentin dhe të paguajë biletën e udhëtimit. Faturino nuk ka pranuar të kthejë dokumentin pa asnjë shpjegim.

#### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, neni 4 dhe 5;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, pikat II/1, VIII/c;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996), Neni E, Pjesa V;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 5, nenin 5, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa c);



- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidëve Të Punës”, i ndryshuar, neni 1, neni 4, neni 11 etj.
- Ligji nr.N8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 16,

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri gjykon se veprimi i faturinos së operatorit urban “Remi Trans”, që konsiston në konfiskimin e Dëshmisë së Invaliditetit është i pajustificueshëm, aq më tepër kur ankuesja i ka kërkuar disa herë me rradhë t’i kthente këtë akt. Faturino i autobusit ka abuzuar me detyrën e tij, duke kryer një veprim të tillë dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë për një ndodhi të tillë është e operatorit urban, që është edhe punëdhënësi i tij.

Komisioneri gjykon se sjellja e punonjësit të këtij operatori urban konsiston në mungesë të theksuar respekti ndaj S.K., si dhe qendrimi i tij është gjithashtu tepër fyes e denigrues ndaj personave me aftësi të kufizuara.

### **VENDIMI**

Konstatimi i diskriminimit të S.K., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Remi Trans sh.p.k.

Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Administratori i kësaj shoqërie t’i kërkojë falje ankuseses, për mungesën e respektit të treguar nga ana e punonjësit të tij.

Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Shoqëria “Remi Trans” sh.p.k., t’i kthejë S.K., Dëshminë e Invaliditetit, që ankueses i është sekuestruar padrejtësisht nga faturino i autobusit me targë AA 397 TM.

Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, shoqëria “Remi Trans” sh.p.k. të marrë masa për mospërsëritjen e situatave të tilla kundrejt personave me aftësi të kufizuar.

**43. Për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me gjuhën e përdorur, në programin, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V” të datës 24.07.2020 të publikuar në faqen web të televizionit Top-Channel**

**VENDIM NR. 155, DATË 30. 10. 2020**

**Shkaku:** Aftësia e Kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejtë  
**Fusha:** Të mira dhe shërbime  
**Statusi:** Vendim me gjobë

Subjekti ankues, ka parashtruar fakte se një nga protagonistet e programit, Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020 (Vali), ka përdorur shprehjen: “... o djalë je shumë down”.

**FAKTET**

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që:

- Sipas informacionit të administruar të publikuar në media<sup>37</sup> dhe në rrjetet sociale<sup>38</sup>, në programin Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V” të datës 24.07.2020, një nga protagonistet e programit (V.), në pjesën prezantuese/hyrëse të emisionit shfaqet duke biseduar në celular me një djalë dhe mes tyre zhvillohet dialogu si më poshtë: “*Të thashë që nuk mundem sot, o djalë je shumë down*”<sup>39</sup>, *nuk mundem pra, herë tjetër do takohemi normalisht, ok mjeshtër*”.
- Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e televizionit Top Channel nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument lidhur me shprehjen e përdorur në adresë të personave me sindromën Down.

**LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17, 18, 22, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Konventa “Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”
- Rekomandimit të Përgjithshëm të Politikave nr. 15 të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës për “Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”,

<sup>37</sup> <https://top-channel.tv/video/real-talk-me-aventurieret-vali/>

<sup>38</sup> [https://www.instagram.com/p/CC\\_OoFhj8o7/?fbclid=IwAR2OYoghrjPFDnyJW38EAKiIm28FE6MS5cGTfw\\_oMl4X71YJvnNEKL4ZyB8c](https://www.instagram.com/p/CC_OoFhj8o7/?fbclid=IwAR2OYoghrjPFDnyJW38EAKiIm28FE6MS5cGTfw_oMl4X71YJvnNEKL4ZyB8c)

<sup>39</sup> Referuar shprehjes së përdorur në sekondën 10-12 të videos.

- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NY (Case C-54/07)/ Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ/ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07 dhjetor 1976.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 92.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 2, 3, 7, 12, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emision, duke përdorur fjalën “down” me qëllim ofendimi, në mënyrë të drejtëpërdrejtë mund të prodhojë përhapjen ose nxitjen e stereotipizimeve negative, stigmatizimeve ose kërcënimeve kundër fëmijëve dhe të rriturve të diagnostifikuar me “sindromën down”.

Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin objekt shqyrtimi është një rast i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë, përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Sa më sipër papërgjegjshmëria e lirisë së fjalës e përdorur në emisionin “Reality Show “REAL TALK me Aventurierët”, çënon dinjitetin dhe personalitetin e personave që vuajnë nga sindroma doën për shkak të aftësisë së kufizuar. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin “Reality Show “REAL TALK me Aventurierët”, datë 24.07.2020 në televizionin Top Channel, ka vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, personat që vuajnë nga sindroma doën në formën e shqetësimit.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

## ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit të shtetasve me sindromën down, në formën e shqetësimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e televizionit Top Channel.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, televizioni Top Channel, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës të distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi, cënon dhe prek dinjitetin e personave me sindromën down.

#### 44. I.Ç., kundër S.J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan

**VENDIM NR. 5, DATË 07.01.2020**

**Shkaku:** Aftësi e kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Zbatuar

I.Ç., është renditur në vendin e dytë në profilin “Histori”, në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2019-2020. ZVAP Elbasan i ofroi I.Ç., pozicionin vakant të punës (provizor) në Shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”. Drejtuesja e institucionit arsimor i zgjidh kontratën e punës, pasi ankuesi ka probleme me artikulationin e fjalëve.

#### ***FAKTET***

I.Ç., është renditur në vendin e dytë në profilin “Histori”, në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2019-2020. Në vijim, ZVAP Elbasan i ofroi I.Ç., pozicionin vakant të punës (provizor) në Shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, ofertë, e cila është pranuar nga aplikanti, i cili ka filluar punë si mësues historie pranë kësaj shkolle. Në datën 24.09.2019, Drejtorja e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan ka miratuar dhe nënshkruar vendimin për emërimin e përkohshëm të tij në punë.

Në datën 30.09.2019, ora 14:00, është mbledhur Këshilli i Prindërve në Shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas. Qëllimi i këtij takimi ka qenë dhënia e opinionit për mësuesin I.Ç., lidhur me performancën e tij në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor<sup>40</sup>. Në Relacionin e datës 01.10.2019, për mësuesin I.Ç., të nënshkruar nga prindërit e nxënësve, të klasës ku ai jepte mësim, shprehej shqetësimi i tyre, lidhur më vështirësinë që kishte mësuesi në shqiptim.

Relacioni i sipërpërmendur, shoqërohet me Aktin “Procesverbal i opinionit të Këshillit të Prindërve për mësuesin I.Ç., profili Histori – Gjeografi, Shkolla “Seit Pepa”, ku rezulton se opinionin e prindërve për mësuesin I.Ç., është cilësuar si i dobët, që është edhe vlerësimi minimal.

Menjëherë pas relacionit të sipërcituar, Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, ka nënshkruar Vendimin për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me I.Ç.

#### ***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

<sup>40</sup> Referuar shprehimisht Procesverbalit të datës 30.09.2019, mbi takimin e Këshillit të Prindërve.

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,
- Koment i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (miratuar ne Sesionin e 19 (14 Shkurt – 9 mars 2018), pika 20;
- Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për proçedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, pika 2;
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, pikat 4 e 5, të nenit 58.

## **KONKLUZIONE**

Komisioneri krijoi bindjen e arsyeshme se I.Ç., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe disfavorizuese si nga Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, e cila e ka ekspozuar ankuesin ndaj një qendrimi tepër diskriminues, që reflektohet në mënyrë evidente në veprimet e saj, kundër tij. Për sa kohë që, I.Ç., rezultoi fitues në “Portalin Mësues për Shqipërinë”, që njihet ligjërisht, si mënyra e punësimit në pozicionin e mësuesit në një profil të caktuar, asnjë titullar institucioni arsimor nuk mund të vërë në diskutim aftësitë e tij, për të cilat ai ka rezultuar fitues.

KMD çmoi se veprimet e ndërmarra nga S.J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, janë totalisht tendencioze ndaj I.Ç., që në fillim të marëdhënieve të punës së ankuesit në Shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan.

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se nuk ekzistonte asnjë ankesë me shkrim të prindërve të nxënësve të kësaj shkolle mbi ankuesin. Gjithashtu, në Proçesverbalin e Këshillit të Prindërve të mbajtur në takimin e datës 30.09.2019, nuk rezultonte asnjë arsytim i këtij Këshilli mbi vlerësimin e kryer ndaj këtij mësuesi. Arsyetimet dhe justifikimet përkatëse rezultojnë të jenë dhënë vetëm në aktet e hartuara nga titullarja, e cila nuk ka kryer asnjë monitorim të drejtpërdrejtë në orët e mësimit të zhvilluar nga mësuesi I.Ç., si dhe asnjë testim të nxënësve, të cilët marrin mësim nga ky mësues, por është mbështetur vetëm në argumentime të pambështetura në asnjë dokument.

Një element rëndues për pozitën e titullarës së këtij institucioni arsimor është edhe fakti i mosbashkëpunimit me institucionin e KMD-së, ndërkohë që ndodhet në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

I.Ç., pavarësisht faktit se nuk disponon një Vendim të KMCAP Elbasan, që të vërtetojë aftësinë e kufizuar, sërisht ai është perceptuar, si individ me aftësi të kufizuara, nga Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, por edhe nga Zyra Vendore Arsimore Elbasan. Ndjesinë e të perceptuarit si individ me aftësi të kufizuar e ka patur edhe ankuesi, lidhur me mënyrën se si është përshkruar në relacionet e Drejtoreshës.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të I.Ç., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga S.J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan.

Konstatimi i mosdiskriminimit të I.Ç., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Zyra Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.

ZVA Elbasan të marrë masat e nevojshme, për punësimin e I.Ç., si dhe të njoftojë KMD-në mbi rezultatet përkatëse, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni mbi këtë vendim.

#### **45. K.F., kundër Zyrës Vendore Arsimore Korçë-Pustec dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë**

**VENDIM NR. 11, DATË 24.01.2020**

**Shkaku:** Aftësia e kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Arsim  
**Statusi:** I zbatuar

Fëmijës së mitur me aftësi të kufizuara në dëgjim, i cili ndjek klasën e parë në një shkollë publike, nuk i ofrohet asistencë me mësues ndihmës.

#### ***FAKTET***

Ankuesja K.F., është e nëna e një djali, të quajtur D.F., i datëlindjes 23.01.2013. Ankuesja dhe familja e saj janë banorë në Barç, Korçë. Djali i ankuseses, është diagnostifikuar me *Hypoacusis neurosensoriale profunde* dhe bazuar në këtë diagnozë fëmija ka ulje neurosensoriale të thellë të dëgjimit dhe për rrjedhojë ai nuk dëgjon dhe nuk flet. Fëmija D.F., ka përfunduar frekuentimin e kopshtit (grupi i tretë).

Në datën 09.07.2019, Komisioni Multidisiplinar, pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, ka vlerësuar nevojat për arsim të fëmijës D.F. Ky komision ka vlerësuar se fëmija mund të ndjekë shkollën e zakonshme dhe se për të siguruar në mënyrë efektive të drejtën për arsim fëmija ka nevojë për mësuese ndihmëse përgjatë 2-dy orëve mësimore çdo ditë. Më datën 13.09.2019, ankuesja i është drejtuar me një kërkesë DAR Koçë, duke kërkuar që djalit të saj t'i mundësohej asistencë me mësues ndihmës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar.

Fëmija D.F, është regjistruar në klasën e parë të shkollës 9-vjeçare “Stavri Themeli”, Korçë dhe ka filluar vitin shkollor 2019-2020, pa i'u siguruar një mësues ndihmës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Fëmijëve, pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë (DRAP Korçë). Komisioni i Vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën 9 vjeçare “Stavri Themeli” është mbledhur dhe ka vlerësuar nevojat e fëmijës D.F., në muajin tetor 2019. Bazuar në vlerësimin e fëmijës është hartuar Plani i Edukimit Individual (PEI), i datës 15.10.2019. Po në datën 15.10.2019, Shkolla 9-vjeçare “Stavri Themeli” i është drejtuar ZVA Korçë – Pustec me një kërkesë për mësues ndihmës për të mbështetur nevojat e fëmijës, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar. Në përgjigje të kësaj kërkesë të bërë nga ana e shkollës, ZVA Korçë-Pustec, ka bërë deklaratë se ka mungesë në portal të mësues ndihmës. Këtë deklaratë ia ka përcjellë shkollës, duke e informuar se në listën e fituesve të portalit “Mësues për Shqipërinë” nuk ka asnjë fitues për këtë profil dhe i ka rekomanduar shkollës që në bazë të Dispozitive



Normative, fëmija të asistohet nga prindi deri në krijimin e hapësirave ligjore për emërimin e mësuesit ndihmës.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, neni 24 dhe Rekomandimi
- Konventa e OKB-së “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, neni 28,
- Konventa e UNESCO *Kundër Diskriminimit në Arsim*, neni 1,
- Komenti i Përgjithshëm Nr.13 (1999) “Mbi të drejtën për arsim”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 (2016) “Mbi të drejtën për arsim gjithëpërfshirës”, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, 3 neni 7, Neni 17
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63-65,
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar” (DN), nenet 93-101.

### **KONKLUSIONE**

Ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, garanton të drejtën për mësues ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar se kanë nevojë për mbështetje nëpërmjet një mësuesi ndihmës, në mënyrë që të realizohet në mënyrë efektive e drejta e tyre për arsim. Mbështetja nëpërmjet një mësuesi ndihmës është një ndër format, por jo forma e vetme e mbështetjes që duhet të ofrohet në mënyrë që të garantohet pa diskriminim e drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Fëmija i ankueses, pra nxënësi D.F është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar se për të realizuar në mënyrë cilësore arsimimin e tij, e për rrjedhojë edhe zbatimin efektiv të Planit Edukativ Individual (PEI) që është përgatitur për të, është e nevojshme mbështetja me anë të një mësuesi ndihmës. Pra, përgatitja e PEI dhe sigurimi i mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara janë detyrime të ndërlidhura, por nuk janë e njëjta gjë, janë dy detyrime të ndryshme nga njëra tjetra dhe të detyrueshme për autoritetet përgjegjëse për të garantuar të drejtën për arsim të individëve.

Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi kanë përcaktuar se është Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë ZVAP-ve që do të përcaktojë nevojën arsimore të nxënësit, nevojën për mësues

ndihmës dhe numrin e orëve mësimore të nevojshme. ZVAP apo DRAP nuk kanë kompetencë të vlerësojnë nevojën arsimore të nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevojën për mbështetje me mësues ndihmës. Nëse Komisioni Multidisiplinar ka vendosur që mësimi i fëmijës dhe zbatimi i PEI duhet të realizohet duke siguruar mbështetjen me mësues ndihmës, atëherë autoritetet përgjegjëse për të siguruar arsimin parauniversitar në nivel vendor duhet të marrin masa për zbatimin e tij. Nëse arsimi i fëmijës nuk realizohet në përputhje me vlerësimet e Komisionit Multidisiplinar, kjo do të thotë se arsimimi i tij nuk po realizohet në mënyrë cilësore dhe në baza të barabartë me të tjerët, pasi i është mohuar mbështetja e duhur për të arritur cilësinë në arsim.

Mundësia që i është dhënë ankueses për të asistuar fëmijën e saj në klasë, nuk është një favor që i është bërë ankueses, por tregon për dështimin për të përmbushur detyrimin ligjor për të siguruar mësues ndihmës. Kjo është në fakt një dëshmi e nevojës që fëmija ka për mbështetje me mësues ndihmës në mënyrë që të marrë një arsim cilësor si gjithë fëmijët e tjerë. Detyrimi për të siguruar mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara nuk duhet të kalojë mbi familjen, pasi është një detyrim ligjor i institucioneve përgjegjëse, pa mohuar këtu detyrimin për të bashkëpunuar me prindërit apo familjen e fëmijës.

Në lidhje me pretendimin e ZVA Korçë-Pustec se, mësuesi ndihmës do të caktohej në rast se do të njohë gjuhën e shenjave, Komisioneri vlerësoi se, njohja e gjuhës së shenjave nga mësuesi ndihmës do të përbënte ndihmën më të mirë për fëmijën, por duke vlerësuar nevojën për mbështetje të menjëhershme dhe faktin se është në interesin më të lartë të fëmijës që të marrë mbështetje nga një mësues profesionist dhe jo të asistohet nga prindëri gjatë orëve të mësimi, caktimi i mësuesit ndihmës duhet të bëhet në mënyrë të menjëhershme edhe pse ai nuk e njih gjuhën e shenjave. Në vijim autoritetet përgjegjëse duhet të maksimalizojnë përpjekjet e tyre për të siguruar arsimimin e fëmijës në gjuhën e shenjave.

Fëmija D.F.N ka ndjekur kopshtin (grupin e tretë). Ky fakt tregon se ai është një fëmijë që ka qënë i identifikuar nga strukturat përgjegjëse vendore të arsimit parauniversitar ZVA Korçë-Pustec dhe DRAP Korçë. Gjithashtu procesi i identifikimit të fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë, siç është fëmija D. F, është një proces që fillon kohë më parë fillimi i vitit shkollor dhe përfshin një angazhim dhe koordinim të shumë institucioneve, bazuar në urdhrin e përbashkët nr. 292 datë 28.05.2019 *“Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”*, e Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrisë të Brendshëm dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar midis tri ministrive në vitin 2018. Mungesa e koordinimit dhe monitorimit të procesit nuk mund të shërbejë si justifikim për mungesë fondesh, kur këto institucione kanë detyrimin që të sigurojnë arsim cilësor dhe të barabartë për të gjithë nxënësit në juridiksionin e tyre.

Komisioneri vlerësoi se fëmija i ankueses, ishte trajtuar në mënyrë më të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë në raport me fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara, pasi duke mos iu siguruar mbështetja me mësues ndihmës atij nuk i është siguruar një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta. Ky trajtim diferencues dhe i pafavorshëm është i lidhur pikërisht me faktin se fëmija D.F., është një fëmijë me aftësi të kufizuara. Thënë kjo, nuk nënkupton që ka qënë qëllim i autoriteteve përgjegjëse për të bërë një trajtim të tillë, por se ata kanë dështuar për hequr pengesat dhe për të ofruar mbështetjen e parashikuar nga ligji. Vendosja në kushte më pak të favorshme ka si bazë aftësinë e kufizuar, pasi në mungesë të saj D.F., nuk do të kishte nevojë për mbështetje. Komisioneri vlerësoi se fëmija D.F., ishte diskriminuar në të drejtën e tij për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të fëmijës D.F., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyres Vendore Arsimore Korçë-Pustec.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, të marrin masa të menjëhershme për sigurimin e mësuesit ndihmës për nxënësin D.F., sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec, të marrin masa që në një kohë sa më të shpejtë të sigurohet arsimimi i nxënësit D.F., në gjuhën e shenjave shqipe duke përfshirë edhe një mësues ndihmës që njeh gjuhën e shenjave shqipe.

**46. B.K., kundër Zyrës Vendore Arsimore Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë**

**VENDIM NR. 32, DATË 07.04.2020**

**Shkaku:** Aftësia e kufizuar  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Arsim  
**Statusi:** I zbatuar

I mituri, i diagnostifikuar me çrregullim të spektrit autik, frekuentues në kopësht publik, nuk i ofrohet asistenca me mësues ndihmës, duke iu mohuar e drejta për arsim.

***FAKTET***

Ankuesi B.K., është babai i të miturit, O.K., duke pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të djalit, nga institucionet përgjegjëse. I mituri O.K., është diagnostikuar me çrregullim të spektrit të autizmit dhe është vlerësuar, nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), Tiranë, si fëmijë me aftësi të kufizuara, grupi i parë, i cili ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi. Fëmija ka filluar frekuentimin e kopshtit publik, në Tiranë, në vitin shkollor 2018-2019. Komisioni multidisiplinar, i ngritur pranë DAR Tiranë, ka vlerësuar rastin në Janar 2019 dhe ka dalë me Rekomandimin se fëmija duhet të asistohet çdo ditë, në kohën e mësim-dhënies, me mësues ndihmës. Edhe pse ky rekomandim i është komunikuar për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, në mars, rezultoi që i mituri nuk është asistuar me mësues ndihmës përgjatë gjithë vitit shkollor 2018-2019.

Bazuar në Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Komisioni Multidisiplinar mbledhet 3 herë në vit: para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor, me synim që të garantojë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në arsimin parauniversitar, që në momentin e fillimit të vitit shkollor si dhe të mbulojë çdo ndryshim që mund të ndodh, me nevojat e fëmijëve, gjatë tij.

Për vitin mësimor 2019-2020, Komisioni Multidisiplinar ka vlerësuar të miturin O.K. më datë 24.10.2019, duke rekomanduar asistencën me mësues ndihmës 5 orë mësimore në javë, duke e shpërndarë këtë ngarkesë mësimore me 1 orë në ditë. Ky rekomandim i është përcjellë për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve, me 7 janar 2020. Me 4 mars 2020, pas kërkesës së Komisionerit për informacion shtesë, ZVA Tiranë informoi se, mësuesja ndihmës ofron asistencën për fëmijën O.K., çdo të premte, nga ora 8.00 -14.00.

***LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM***

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116

- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, neni 24 dhe Rekomandimi
- Konventa e OKB-së “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, neni 28,
- Konventa e UNESCO *Kundër Diskriminimit në Arsim*, neni 1,
- Komenti i Përgjithshëm Nr.13 (1999) “Mbi të drejtën për arsim”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 (2016) “Mbi të drejtën për arsim gjithëpërfshirës”, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, 3 neni 7, Neni 17,
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63-65,
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar” (DN), nenet 93-101,
- Rregullorja për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin Nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020 ka shfuqizuar urdhrin Nr. 343, datë 19.08.2013).

## **KONKLUZIONE**

Rezultoi e provuar se fëmijës së ankuesit, të miturit O.K., nuk i është siguruar mbështetja me mësues ndihmës, duke mos i garantuar arsim gjithëpërfshirës cilësor, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykoj se fëmija, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë e të favorshëm, duke cënuar të drejtën e tij për arsim.

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, ishte përgjegjëse për caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që frekuentojnë kopshtet publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Rezultoi se, me mosveprim, nuk ka zbatuar rekomandimet e Komisionit Multidisiplinar për të siguruar mësuesin ndihmës për të miturin O.K. Komisioneri gjykoj se, asistimi me mësues ndihmës vetëm një ditë në javë, çdo ditë të premte, është në kundërshtim me vlerësimin e Komisionit Multidisiplinar, sipas të cilit fëmija duhet të asistohet 5 orë mësimore në javë e shtrirë në 1 orë për çdo ditë, dhe në kundërshtim me Udhëzimin e të Ministrit të Arsimit Nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, i cili përcakton qartë se është Komisioni Multidisiplinar, që bën vlerësimin e nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe përcakton ndër të tjera numrin e orëve.

Komisioneri vlerësoi se autoritetet përgjegjëse kanë dështuar për të marrë masat për të adresuar diskriminimin, i cili është konsumuar njëkohësisht si nëpërmjet mosveprimit në kohë nga ana e ZVA Tiranë, ashtu edhe mosveprimit nga ana e DPÇK, Bashkia Tiranë, sjellje të cilat kanë gjeneruar një situatë në të cilën fëmijës O.K., i është kufizuar e drejta për të marrë një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta me fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara. Kjo nuk nënkupton që ka qenë qëllim i autoriteteve përgjegjëse për të bërë një trajtim të tillë, por se ata kanë dështuar për hequr pengesat dhe për të ofruar mbështetjen e parashikuar nga ligji.

Komisioneri vlerësoi se i mituri O.K., është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme në raport me fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara, duke mos iu siguruar një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta. Ky trajtim i pafavorshëm është i lidhur dhe ka si bazë faktin që O.K., është një fëmijë me aftësi të kufizuara, pasi në mungesë të saj O.K., nuk do të kishte nevojë për mbështetje.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të fëmijës O.K., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për të asistuar me mësues ndihmës fëmijën O.K., me 5 orë mësimore në javë, duke e shpërndarë këtë ngarkesë mësimore me 1 orë mësimore në ditë.

Zyra Vendore Arsimore Tiranë të mos ndërpresë asistencën me mësues ndihmës që ofron aktualisht për fëmijën O.K., deri në ofrimin e saj nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe asistenca me mësues ndihmës të ofrohet me 1 orë mësimore çdo ditë, në përputhje me rekomandimin e komisionit multidisiplinar.

Zyra Vendore Arsimore Tiranë të marrë masa për mbledhjen e komisionit multidisiplinar tri herë në vit, në respektim të Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin Nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

## ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË

47. E.D., B.D., B.Gj., A.Gj., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.,

**VENDIM NR. 145, DATË 26.10.2020**

**Shkaku:** Përkatësia në një grup të veçantë  
**Forma:** Diskriminim i drejtëpërdrejt, mosdiskriminim, pezullim  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Subjektet ankues kanë parashtuar fakte se që prej shpalljes publike të themelimit të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB), Shoqëria Albchrome ka nisur kundër përfaqësuesve të sindikatës një fushatë intensive masash presioni me qëllim diskriminimin e tyre për shkak të anëtarësisë në sindikatë dhe pjesëmarrjes në veprimtari sindikale.

### **FAKTET**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 14, datë 15.10.2019, vendosi regjistrimin e organizatës sindikale me emërimin Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB) me objekt veprimtari përfaqësimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të të gjithë anëtarëve të sindikatës të cilët janë punëmarrësit e sektorit minerar, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datë 18.11.2019.

Njohja dhe regjistrimi i SMBB është shpallur publikisht, në datë 17.11.2019<sup>41</sup>, në qendër të qytetit të Bulqizës, me anë të një tubimi, ku kanë marrë pjesë minatorë, të punësuar pranë Albchome sh.p.k.

Kryetari i SMBB i është drejtuar Shoqërisë AlbChrome me shkresë “Kërkesë për ndalimin e ndërhyrjes në veprimtarinë e SMBB” me datë 25.11.2019, të dërguar nëpërmjet shërbimit postar me Nr. RR609749013AA, për të cilën Shoqëria AlbChrome ka marrë dijeni në datë 26.11.2019 me anë të lajmërim marrje poste Nr. RR607581244AA. Nëpërmjet kësaj shkrese E.D., është ankuar kundër pushimit diskriminues dhe ka kërkuar anulimin e vendimit të zgjidhjes së kontratës së punës me të dhe ndalimin e veprimeve të ndërhyrjes në aktivitetin e sindikatës që vazhdonte dhe me thirrjen në takime të dy anëtarëve të Këshillit Sindikal, të B.Gj., dhe B.D.

<sup>41</sup> <http://top-channel.tv/2019/11/17/protesta-e-minatoreve-ne-bulqize-do-te-krijojme-sindikate-te-re/>,  
<https://www.reporter.al/minaret-e-bulqizes-themelojne-nje-sindikate-te-re/>

1. E.D., ka filluar punë pranë Shoqërisë AlbChrome në datë 06.03.2014<sup>42</sup>. Me shkresën nr. 1081, datë 25.04.2019 i është dhënë masa disiplinore: *“Paralajmërim për pushim nga puna dhe ndryshim i pozicionit të punës nga transporti i brendshëm në Qafë Buall”*, për arsye: *“Sjellje jo korrekte në punë duke kryer veprime që paraprijnë krijimin e pasojave të rrezikshme në lidhje me sigurinë në punë dhe gjithashtu pengojnë ecurinë normale të veprimtarisë së minierës”* dhe është njoftuar se dokumenti do mbahet në dosjen personale të E.D., për një kohë prej 12 muajsh. Lidhur me masën disiplinore, në datë 26.04.2019 është mbajtur procesverbali mes palëve në të cilën ankuesi ka komentuar se masën po e merr pa të drejtë, nuk e meriton dhe nuk i pëlqen spostimi i vendit të punës. Në datë 22.11.2019 me shkresën e Shoqërisë AlbChrome *“Për zgjidhjen e kontratës së punës”* është vendosur zgjidhja e kontratës së punës së E.D., për shkelje të disiplinës si rezultat i mungesave në punë dhe masës disiplinore të marrë në datë 25.04.2019.

Lidhur me masën disiplinore të zgjidhjes së kontratës së punës, Komisioneri vlerëson se duke iu referuar kronologjisë së fillimit të procedurës së masës disiplinore, në datë 15.11.2019 dhe duke iu referuar faktit se (në rrugë shkresore) punëdhënësi ka marrë dijeni se E.D., është kryetar i sindikatës, në datë 26.11.2019, faktohet se punëdhënësi nuk ka qenë në dijeni se ankuesi ka qenë Kryetari i SMBB. Gjithashtu dhe gjatë takimit të zhvilluar mes palëve në datë 19.11.2019, ankuesi nuk ka ngritur një pretendim të tillë që të kërkonte të drejtat dhe mbrojtjen ligjore që përfiton nga veprimtaria sindikale të parashikuar në nenin 181 të Kodit të Punës. Komisioneri gjykon se nga ana e Shoqërisë AlbChrome, nuk është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë dhe në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

2. B.D., ka filluar punë pranë Shoqërisë AlbChrome në datë 15.02.2007<sup>43</sup>. Me shkresën nr. 1083, datë 25.04.2019 i është dhënë masa disiplinore: *“Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna dhe ndryshim pozicion pune nga transporti i brendshëm në nivelin XVII”*, për arsye: *“Sjellje jo korrekte në punë duke kryer veprime që paraprijnë krijimin e pasojave të rrezikshme në lidhje me sigurinë në punë dhe gjithashtu pengojnë ecurinë normale të veprimtarisë së minierës”* dhe është njoftuar se dokumenti do mbahet në dosjen personale të B.D., për një kohë prej 12 muajsh. Lidhur me masën disiplinore, në datë 26.04.2019 është mbajtur procesverbali mes palëve në të cilën ankuesi ka komentuar se prej 13 vitesh që është i punësuar në shoqëri, nuk është kritikuar asnjëherë por ka bërë koment se shqetësimin kryesor e ka kundër sindikatës (FSPISH<sup>44</sup>) dhe jo kundër kompanisë.

<sup>42</sup> Referuar shkresës Nr. 1202, datë 15.11.2019 “Njoftim për takim” të Shoqërisë AlbChrome.

<sup>43</sup> Referuar shkresës Nr. 1218, datë 19.11.2019 “Njoftim për takim” të Shoqërisë AlbChrome.

<sup>44</sup> Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë.



Me shkresën Nr. 1208, datë 19.11.2019 ankuesi është njoftuar për takim me punëdhënësin me qëllim diskutimin e etikës në vendin e punës dhe duhej të paraqiste dokumente për të justifikuar mungesat në vendin e punës.

Në datë 25.11.2019 është mbajtur takimi mes palëve për të diskutuar për masën disiplinore dhe në procesverbalin e mbajtur, punëdhënësi ka komentuar: *“Arsyeja e takimit lidhet me mungesat pa arsye në vendin e punës. Mungesat klasifikohen si shkelje të disiplinës në punë si dhe referuar paralajmërimet/masës disiplinore të mëparshme të datës 25.04.2019, përbëjnë arsye të qenësishme për humbjen e besimit të punëdhënësit ndaj tij dhe si rrjedhojë bëjnë pjesë në shkaqe për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës”*, ndërsa ankuesi ka komentuar se: *“Është vonuar në takimin e programuar për tu zhvilluar në orën 10.30 pasi ka qenë në protestë. Lidhur me mungesat kompania duhet ta informonte që në minierë”*.

Me shkresën Nr. 1228, datë 02.12.2019 “Për zgjidhjen e kontratës së punës” është vendosur zgjidhja e kontratës së punës së B.D., për shkelje të disiplinës në punë dhe si rrjedhojë e kushteve të kontratës në mënyrë të përsëritur.

Është fakt i njohur se punëdhënësi ka qenë në dijeni, që në datë 26.11.2019, se B.D., ishte anëtar i Këshillit Sindikal të SMBB dhe se nga data 26.11.2019 deri në datë 02.12.2019 ankuesi dhe shumë punonjës të tjerë kanë zhvilluar protestë<sup>45</sup> përpara mjediseve të minierës kundër largimit nga puna të kryetarit të sindikatës si dhe rishikimit të kontratës kolektive.

Shoqëria AlbChrome duke qenë se ishte vënë në dijeni se punonjësi B.D., ishte anëtar i Këshillit Sindikal të SMBB-së që në datë 26.11.2019 dhe vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës është bërë në datë 02.12.2019, në respekt të legjislacionit në fuqi, duhet të ishte konsultuar me SMBB-në për marrjen e masës disiplinore.

Në këtë kontekst, është e qartë se B.D., në tagrin e Përgjegjës të Thesarit dhe të një prej drejtuesve kryesorë të SMBB, nuk duhej ti zgjidhej kontrata e punës pa pëlqimin dhe diskutimin me SMBB.

Komisioneri vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës, është masë jo proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar dhe nuk mund të përbënte shkelje të natyrës së rëndë që të justifikonte zgjidhjen e kontratës së punës, për më tepër që ankuesi kishte 12 vjet që punonte në minierë dhe nuk kishte vlerësime pune negative.

Për sa më lart, shihet qartë se sjellja e padrejtë ndaj ankuesit, finalizuar me largimin e tij përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas bërjes publike të veprimtarisë së tij sindikale.

---

15. <https://www.reporter.al/protesta-e-minatoreve-ne-bulqize-inspektoriati-i-punes-nis-hetim-per-shkarkimin-e-kreut-te-sindikates/>, <https://www.reporter.al/protesta-e-minatoreve-ne-bulqize-policia-shoqeron-kater-protestues/>

3. B.Gj., ka filluar punë pranë Shoqërisë AlbChrome në datë 01.04.2002<sup>46</sup>. Me shkresën Nr. 1219, datë 19.11.2019 ankuesi është njoftuar për takim me punëdhënësin me qëllim diskutimin e etikës në vendin e punës dhe duhej të paraqiste dokumente për të justifikuar mungesat në vendin e punës. Në datë 25.11.2019 është mbajtur takimi mes palëve për të diskutuar për mungesat e paarsyetuara në vendin e punës dhe në procesverbalin e mbajtur, punëdhënësi ka komentuar: *“Arsyeja e takimit lidhet me mungesat pa arsye në vendin e punës, shkelje kjo që përbën thyerje të disiplinës/etikës në punë”*, ndërsa ankuesi ka komentuar se: *“Gjykon që kjo çështje nuk është kryesore por ky proces bëhet për lidhjen e tij me sindikatën e re”*.

Me shkresën Nr. 1229, datë 02.12.2019 është njoftuar lidhur me masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” me arsyen *“Shkelje të disiplinës në punë, të orarit zyrtar”*. Me shkresën Nr. 1239, datë 12.12.2019 ankuesi është njoftuar për takim me punëdhënësin me qëllim diskutimin e mungesave të pajustificuara në vendin e punës si dhe duhej të paraqiste dokumente për të justifikuar mungesat. Në datë 17.12.2019 është mbajtur takimi mes palëve për të diskutuar për mungesat e pajustificuara në vendin e punës dhe në procesverbalin e mbajtur, punëdhënësi ka komentuar: *“Mungesat pa arsye për më shumë se 7 ditë përbëjnë shkelje që justifikojnë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, për më tepër që është dhënë dhe një masë tjetër disiplinore”*, ndërsa ankuesi ka komentuar se: *“Mungesat janë bërë gjatë një aktiviteti sindikal dhe mendonte se e gjithë situata është për shkak të veprimtarisë sindikale”*.

Me shkresën Nr. 1239/1, datë 20.12.2019 “Për zgjidhjen e kontratës së punës” është vendosur zgjidhja e kontratës së punës së B.Gj., për mungesa pa arsye dhe braktisje të vendit të punës, pa shkaqe të arsyeshme, dhe pa njoftuar për më shumë se 7 ditë.

Komisioneri gjykon se transferimi i ankuesit dhe masa disiplinore e zgjidhjes së kontratës së punës, janë masa jo proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar. Shpjegimi i ankuesit se ka munguar në punë pasi ka qenë duke protestuar në mbrojtje të lirisë sindikale nuk përbënte shkelje të natyrës së rëndë që të justifikonte zgjidhjen e kontratës së punës, për më tepër që ankuesi kishte 17 vjet që punonte në minierë dhe nuk kishte vlerësime pune negative.

Pra, subjekti ankues, duket se është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Shoqërisë AlbChrome, sa i takon transferimit dhe zgjidhjes së kontratës së punës, në raport me parashikimet ligjore që duhet t’i siguronin një mbrojtje efektive sa i takon qënies së tij si anëtar i Këshillit Sindikal të SMBB.

Për sa më lart, shihet qartë se sjellja e padrejtë ndaj ankuesit, finalizuar me largimin e tij përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas bërjes publike të veprimtarisë së tij sindikale.

---

<sup>46</sup> Referuar shkresës Nr. 1219, datë 19.11.2019 “Njoftim për takim” të Shoqërisë AlbChrome.

4. A.Gj., ka filluar punë pranë Shoqërisë AlbChrome në datë 09.04.2015<sup>47</sup>. Me shkresën Nr. 1242, datë 16.12.2019 ankuesi është njoftuar për takim për braktisje të vendit të punës si dhe duhej të paraqiste dokumente për të justifikuar mungesat. Në datë 20.12.2019 është mbajtur takimi mes palëve për të diskutuar për mungesat e pajustificuara në vendin e punës dhe në procesverbalin e mbajtur, punëdhënësi ka komentuar: *“Mungesat pa arsye për më shumë se 7 ditë përbëjnë shkelje që justifikojnë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”*, ndërsa ankuesi ka komentuar se: *“Nga data 26.11.2019 deri në datë 06.12.2019 ka qenë në grevë me vullnetin e tij të plotë”*.  
Me shkresën Nr. 1290, datë 24.12.2019 “Për zgjidhjen e kontratës së punës” është vendosur zgjidhja e kontratës së punës së A.Gj., për mungesa pa arsye dhe braktisje të vendit të punës, pa shkaqe të arsyeshme, dhe pa njoftuar për më shumë se 7 ditë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë nga ankuesi pranë Komisionerit gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në datë 09.07.2020, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>48</sup>, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga A.Gj., për trajtim të paligjshëm duke i zgjidhur marrëdhëniet e punës për shkak të veprimtarisë sindikale, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Në kërkesë padinë e paraqitur ankuesi shprehet se: *“Në procesverbalin e takimit, A.Gj., ka mohuar se ka kryer mungesa pa arsye në punë dhe ka pohuar se mungesat janë bërë gjatë ushtrimit të veprimtarisë sindikale dhe përkatësisht grevës së mbajtur nga data 26 nëntor në 6 dhjetor”*, si dhe: *“AlbChrome duhet të sqarojë nëse pjesëmarrja e punëmarrësit A.Gj., në një grevë, pra përmbushja e një të drejte kushtetuese nga ky punëmarrës, konsiderohet nga AlbChrome një rrethanë e rëndë që nuk lejon, AlbChrome të vazhdojë marrëdhënien e punës me punëmarrësin A. Gj.”*.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pezullon shqyrtimin e pretendimit të ankuesit A.Gj., të bërë në ankesën Nr. 03, datë 16.01.2020, deri në momentin që Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 50, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*

<sup>47</sup> Referuar shkresës Nr. 1242, datë 16.12.2019 “Njoftim për takim” të Shoqërisë AlbChrome.

<sup>48</sup> Referuar Dëftesës së Kominikimit Nr.Regj.Them1 9688 viti 2020, datë 01.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 korrik 2006, “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit”. Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 204, dt. 26. 7. 2006, f. 23-36.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 37, 181, 184 dhe 186 .
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 2, 3, 7, 12,13, 32 dhe 33.

## **KONKLUZIONE**

Komisioneri vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës, është masë jo proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar dhe nuk mund të përbënte shkelje të natyrës së rëndë që të justifikonte zgjidhjen e kontratës së punës, për më tepër që ankuesit kishin shumë vite që punonin në minierë dhe nuk kishin vlerësime pune negative. Pra, subjektet ankues, duket se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Shoqërisë AlbChrome, sa i takon zgjidhjes së kontratës së punës, në raport me parashikimet ligjore që duhet t’i siguronin një mbrojtje efektive sa i takon qënies së tyre si anëtarë të Këshillit Sindikal të SMBB. Për sa më lart, shihet qartë se sjellja e padrejtë ndaj ankuesve, finalizuar me largimin e tyre përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas bërjes publike të veprimtarisë së tyre sindikale.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria AlbChrome, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Respektimin e procedurës së transferimit të ankuesit B.Gj., dhe se ky i fundit kishte dhënë pëlqimin për ndryshimin e pozicionit të punës.
- Marrjen e pëlqimit nga SMBB për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesit.

Shoqëria AlbChrome jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm për transferimin dhe zgjidhjen e kontratës të punës së ankuesit por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se shtetasi B.Gj., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, nga ana e Shoqërisë AlbChrome, trajtim i cili ka ardhur për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtarinë sindikale të SMBB-së.

## ***VENDIMI***

Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit E.D., nga ana e Shoqërisë AlbChrome sh.p.k., për shkak të përkatësisë në organizatë sindikale.

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit B.D., nga ana e Shoqërisë AlbChrome sh.p.k., për shkak të përkatësisë në organizatë sindikale.

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit B.Gj., nga ana e Shoqërisë AlbChrome sh.p.k., për shkak të përkatësisë në organizatë sindikale.

Pezullimin e shqyrtimit të pretendimit të shtetasit A.Gj., të bërë në ankesën Nr. 03, datë 16.01.2020, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në momentin që vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë.

#### **48. Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptar kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.,**

##### **VENDIM NR. 107, DATË 11.09.2020**

**Shkaku:** Përkatësia në një grup të veçantë  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptar (SRNSH) një organizatë sindikale kombëtare që përfaqëson interesat e naftëtarëve, pretendoi se vendimi i Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, i cili në situatën e shkakuar nga pandemia Covid 19, kishte vendosur shkurtimin e pagave vetëm për punonjësit e administratës, ishte diskriminues.

#### ***FAKTET***

Me vendimin Nr. 6, datë 29.04.2020 Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë Albpetrol sh.a ka vendosur, reduktimin e pagave të punëmarrësve të shoqërisë Albpetrol sh.a me 60 % për punëmarrësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të cilat vazhdojnë punën në zyrë, për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë. Sipas këtij vendimi, punëmarrësit e terrenit, ata të cilët lidhen drejtpërdrejtë me prodhimin nuk do të prekeshin nga ky vendim dhe do të vazhdonin të përfitonin të njëjtat të drejta në pagë, ndërsa punonjësit të cilët do të qëndrojnë në shtëpi, sipas grafikut të miratuar nga administratori do të trajtoheshin me me pagën e luftës. Ky vendim i shtrinte efektet financiare nga data 01.04.2020.

Si bazë ligjore për marrjen e vendimit nr.6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikqyrës është referuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”. Referuar këtij vendimi, në pikën 2 të tij, Këshilli i Ministrave ka vendosur kufizimin e disa të drejtave të garantuara nga Kushtetuta, ku ndër të tjera edhe të drejtën e parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës, pra të drejtën për punë. Sipas VKM Nr. 243/24.03.2020, e drejta për punë mund të kufizohet deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

Në muajin prill 2020 punonjësit e administratës së qendrës dhe administratës në qendrat në varësi të cilët kanë vazhduar punën normalisht, janë paguar me pagë të reduktuar në masën 60 % , ndërkohë që punonjësit të cilët janë kategorizuar si punonjësit e terrenit janë paguar me pagë të plotë. Në muajin maj 2020 rezulton se janë paguar me minus 60% të pagës vetëm punonjësit e administratës në qendër, ndërsa punonjësit e administratës në qendrat në varësi janë paguar me pagë të plotë sipas nivelit të pagave të miratuar për vitin 2020.Rezulton se, gjatë muajit prill 2020 janë paguar me pagë të reduktuar në masën 60 % gjithsej rreth 508 punonjës të administratës qendrore dhe administratës në qendrat e varësisë. Në muajin maj

2020 janë paguar me pagë të reduktuar në masën 60 % vetëm punonjësit e administratës qendrore, 148 punonjës gjithsej.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18 dhe 49 ,
- Vendimi Nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 14 dhe Protokolli 12,
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 2, 6,7
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, nenet 1, 3, 7, 12, 33
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, neni 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 9, 33,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24.03.2020 “*Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore*”.

### **KONKLUZIONE**

Vendimi Nr. 6, datë 29.04.2020 i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a ka vendosur uljen e pagës për kategorinë e punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave jo si rezultat se kjo kategori punonjësish për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 do të duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe të mos punojë, duke e vendosur punëdhënësin në kushtet përjashtuese të parashikuara nga neni 129/3 të Kodit të Punës. Sipas këtij vendimi punonjësit e administratës të cilët për shkak të situatës nuk do të zihen me punë dhe do të qëndrojnë në shtëpi do të trajtohen me pagën e luftës. Sipas vendimit, punonjësit e administratës të cilët do të pësojnë ulje të pagës bazë me 60 % do të vazhdojnë normalisht punën në zyrë. Punonjësit e administratës (qendrore dhe qendrat e varësisë) kanë vazhduar të punojnë njësoj sikundër punonjësit e terrenit. Për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se punonjësit e administratës qendrore dhe administrata e qendrave të varësisë, që ka vazhduar punën janë në kushte të ngjashme me punonjësit e terrenit të cilët gjithashtu kanë vazhduar punën, por nuk kanë pësuar reduktim të pagës në masën 60 %.

Komisioneri arriti në përfundimin se punonjësit e administratës qendrore të cilët janë paguar edhe në muajin maj 2020 me pagë të reduktuar në masën 60 % janë në kushte të ngjashme me punonjësit e administratës së qendrave të varësisë dhe punonjësit e terrenit të cilët kanë vazhduar punën, por nuk kanë pësuar reduktim të pagës në masën 60 %. Për punonjësit e administratës që për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19 nuk janë zënë me

punë, pra ata punonjës të cilët kanë qendruar në shtëpi dhe nuk kanë punuar, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës ka parashikuar se ata nuk do të paguhen me pagën e pozicionit të punës, por do të paguhen me pagë luftime. Kjo kategori e punonjësve të administratës nuk është në të njëjtat kushte me punonjësit të cilët kanë vazhduar punën normalisht.

Reduktimi i pagës me 60 % për grupin e punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të varësisë kishte si shkak situatën e vështirë financiare e shkaktuar si pasojë e pandemisë Covid -19. Sipas vendimit kjo masë do të zbatohet për një afat të pacaktuar deri në rikthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë. Shoqëria Albpetrol sh.a gjatë shqyrtimit të ankesë nuk dha asnjë shpjegim se cili ishte qëllimi i ligjshëm për vendosjen e një kufizimi të tillë. Nga përmbajtja e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës dhe relacionit të tij shoqëruar të hartuar nga administratori, rezultoi se me anë të marrjes së kësaj mase shoqëria Albpetrol sh.a ka synuar ruajtjen e stabilitetit financiar të shoqërisë në situatën e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia. Komisioneri vlerësoi se ruajtja e stabilitetit financiar të shoqërisë në situatën e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-2019 përbën padyshim një qëllim të ligjshëm. Megjithatë, duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Shoqëria Albpetrol sh.a., nuk kishte realizuar konsultime paraprake me SRNSH në cilësinë e punëmarrësit, referuar kontratës kolektive të nënshkruar midis tyre. Shoqëria Albpetrol sh.a., ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme kontratën dhe marrëdhënien e punës me punonjësit e saj dhe ky ndryshim i njëanshëm është me pasoja negative për kategorinë e punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave në varësi, të cilët edhe pse kanë punuar janë paguar me 60 % të pagës. Shoqëria Albpetrol sh.a nuk vuri në dispozicion ndonjë analizë konkrete që i kishte bërë gjendjes financiare të shoqërisë dhe se cilat do të ishin rrugët apo mjetet që do të përdorte ajo për të ruajtur stabilitetin financiar. Në mungesë të analizës financiare që shoqëron marrjen e këtij vendimi, nuk mund të vlerësohet se çfare efekti dhe peshe mund të këtë patur një masë e tillë në gjendjen e përgjithshme të shoqërisë.

Komisioneri vlerësoi se, vendimarrja e shoqërisë Albpetrol sh.a për uljen e pagës me 60 % të punonjësve të administratës, nuk mund të konsiderohet në përputhje me kufizimet e miratuara me VKM Nr. 243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”. Ulja e pagës së punonjësve me 60 % në kushtet kur ata kanë punuar çdo ditë në zyrë, pra nuk kemi mbyllje të aktivitetit të shoqërisë, nuk është një masë e marrë me qëllim ruajtjen e shëndetit të shtetasve. Pra, kjo masë nuk është e përshtatshme për arritjen e qëllimeve për të cilat lejohen kufizimet e të drejtës për punë sipas këtij akti. Dhënia e efekteve prapavepruese vendimit nr.6, datë 29.04.2020 e bën akoma më abuzive vendimarrjen e shoqërisë Albpetrol sh.a., e cila me një vendim të marrë në datën 29.04.2020 i shtrin efektet e një vendimi i cili cënon rëndë të drejtat e punës dhe interesat ekonomike të punëmarrësve që në datën 01.04.2020.



Konsultimi dhe vendosja e dialogut social merr një rëndësi të madhe në situata krize të çfarëdolloji. Krijimi i një klime besimi, të ndërtuar nëpërmjet dialogut social është thelbësore në zbatimin e masave për të adresuar situatën e pandemisë Covid 19 dhe efekteve të saj. Është shumë e rëndësishme që punonjësit të mbahen të informuar dhe të konsultohen në lidhje me efektet që mund të kenë në kushtet e marrëdhënies së tyre të punësimit si dhe për të marrë masa për mbrojtjen e vetes së tyre. Shoqëria Albpetrol sh.a në situatë pandemie dhe në mënyrë të njëanshme, pa informim dhe konsultim paraprak, nëpërmjet reduktimit të pagës në masën 60 % për kategoritë respektive të punonjësve të administratës, ka cënuar ndjeshëm të drejtat e tyre të punës dhe ka cënuar interesat ekonomikë dhe mirëqënien e tyre dhe familjeve. Padyshim që në kushtet e vështirësisë dhe pamundësisë financiare shoqëria mund të rishikojë pagat e punonjësve, por ky rishikim duhet të bëhet duke respektuar procedurat dhe duke informuar dhe konsultuar me punëmarrësit dhe organizatat e tyre përfaqësuese, në mënyrë të veçantë kur bëhet fjalë për një ulje të tillë të konsiderueshme në masën 60 % dhe në një situatë të vështirë të shkaktuar nga Covid-19. Shoqëria Albpetrol sh.a nuk arriti të tregojë se reduktimi i pagave ishte mjete i fundit në dispozicion dhe që cënon më pak interesat e punonjësve.

Komisioneri vlerësoi se nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet masës/mjetit të përdorur, reduktimit të pagës në masën 60 % për grupin e punonjësve të administratës (qendrore dhe qendrave të varësisë) të cilët kanë punuar normalisht dhe qëllimit të synuar, atij të ruajtjes së stabilitetit financiar të shoqërisë në kushtet e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Covid 19. Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i grupit të punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të varësisë së shoqërisë Albpetrol sh.a nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm duke konstatuar se grupi i punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të varësisë së shoqërisë Albpetrol sh.a është diskriminuar për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, në të drejtën për punësim dhe se Shoqëria Albpetrol sh.a ka shkelur Ligjin Nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të grupit të punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të varësisë së shoqërisë Albpetrol sh.a, në të drejtën për punësim, për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Në referim të pikës 1, Shoqëria Albpetrol sh.a të marrë masa për:

- Ndalimin e menjëhershëm të mbajtjes së shumave nga pagat e punonjësve të administratës të shoqërisë Albpetrol sh.a., të cilët janë prekur nga vendimi nr.6, datë 29.04.2020;
- Anulimin e vendimit Nr. 6, datë 29.04.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a.;



- Kthimin e shumave të mbajtura nga paga për punonjësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të varësisë së shoqërisë Albpetrol sh.a, të cilët janë prekur nga vendimi Nr. 6, datë 29.04.2020.

## ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR ÇDO SHKAK TJETËR

### 49. H.H., kundër Galerisë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë

**VENDIM NR. 57, DATË 03.06.2020**

**Shkaku:** Çdo shkak tjetër/ankimimi për diskriminim në gjykatë  
**Forma:** Diskriminim në formën e viktimizimit  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Galerisë Kombëtare të Arteve për rreth 10 vite. Pas ndërrimit të titullarit të institucionit, ai ka marrë masë disiplinore të cilën e ka ankimuar në gjykatë. Menjëherë pas ankimit për diskriminim në gjykatë, drejtori ka ndërmarrë veprime të tjera ndaj tij, duke e larguar nga zyra që kishte dhe duke e vendosur në një mjedis tjetër pune, i cili deri në atë moment kishte shërbyer si magazinë, dhe nuk plotësonte as kushtet minimale për një ambjent pune.

### **FAKTET**

Nga kronologjia e ngjarjeve dhe këqyrja e dokumentacionit, rezultoi se:

Nëpërmjet shkresës me nr.330 prot., datë 20.12.2018 të drejtorit të GKA, ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.

Me datë 23.01.2019 subjekti ankues i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një kërkesë-padi nëpërmjet të cilës ka paditur drejtorin e GKA për diskriminim.

Ndërkohë, në fillim të muajit Shkurt 2019 (fakt i pranuar nga të dyja palët) ankuesi është urdhëruar të largohet nga zyra e tij dhe është vendosur në një ambjent tjetër pune, ambjent i cili deri në atë moment kishte shërbyer si magazinë e institucionit.

Eshtë fakt i pranuar nga të dyja palët, që ambjenti aktual ku punon ankuesi nuk përmbush asnjë kriter për të qenë “zyrë/ambjent pune”: nuk ka dritare për ajrosje apo ndriçim natyral, nuk ka ngrohje, në ndryshim me të gjitha ambjentet e tjera/zyrat e këtij institucioni.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 346/2 Prot., datë 19.11.2019 “Urdhër Nr. 204”, drejtori i GKA ka marrë ndaj ankuesit masën e dytë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, më pak se një vit nga dhënia e masës së parë disiplinore, të cilën ankuesi e kishte kundërshtuar gjyqësisht, njëherësh duke paditur drejtorin për diskriminim ndaj tij.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>49</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002).
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

## KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se nga ana e GKA nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit nuk kanë ndodhur pas ankimimit të tij për diskriminim të drejtorit, në gjykatë, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuara dhe objektive.
- Përkundrazi, u provua e kundërta, që ankuesi është urdhëruar të akomodohet në një ambient punë të papërshtatshëm (pa dritare, pa ndriçim natyral, pa ngrohje) në ndryshim nga të gjithë ambientet/zyrat e punonjësve të tjerë të institucionit, duke bërë që trajtimi i tij lidhur me kushtet e punës, të ishte i ndryshëm, i pabarabartë dhe i pafavorshëm, krahasuar me ta.
- Pretendimi i GKA se kjo ka ardhur në kuadër të riorganizimit, nuk qëndron, pasi riorganizimi ka ndodhur rreth 5 muaj pasi ankuesi kishte kaluar tek ambjenti i ish-magazinës.
- Ndaj tij nuk duhej të ishte ndërmarrë një masë e dytë disiplinore, e njëjtë me të parën<sup>50</sup> “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, ndërkohë që po shqyrtohej

<sup>49</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>50</sup> Pavarësisht përmbajtjes së tyre, në thelb të dyja masat janë “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, (masë disiplinore e parafundit përpara masës ekstreme) “Largim nga puna”. Kështu të dy këto urdhra: Urdhri

gjyqësisht pretendimi i tij për diskriminim nga ana e drejtorit. Dhënia e kësaj mase ngre dyshime të arsyeshme për tendencë ndaj ankuesit, si pasojë e ankimit të tij në gjykatë, për diskriminim nga ana e punëdhënësit; për më tepër kur kjo masë është e padrejtë dhe e pabazuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor<sup>51</sup>.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijoi bindjen dhe vlerësoi se H.H., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e Galerisë Kombëtare Tiranë, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas ankimit për diskriminim në gjykatë.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit në formën e viktimizimit, të H.H., nga ana e Galerisë Kombëtare të Arteve (GKA), për shkak të ankimit për diskriminim në gjykatë.

Galeria Kombëtare e Arteve, të marrë masa për ndalimin e trajtimit diskriminues ndaj H.H., si dhe për sistemimin e tij në një ambjent pune që përmbush kriteret e domosdoshme të të qenit ambjent i përshtatshëm pune.

---

Nr. 330, datë 20.12.2018 dhe Urdhri Nr. 204, datë 19.11.2019, janë masa disiplinore me paralajmërim për largim nga puna.

<sup>51</sup> Shih argumentimin e KMD në faqen 11 të vendimit.

## 50. F.GJ., kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT)

### VENDIM NR. 68, DATË 10.07.2020

**Shkaku:** Çdo shkak tjetër/ankimimi për diskriminim në gjykatë  
**Forma:** Diskriminim në formën e viktimizimit  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune si pedagog/lektor, me detyrën personel akademik “Profesor”, pranë Departamentit të Prodhimit Shtazor të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në UBT, që prej vitit 1989. Me datë 19.12.2019 ankuesi është njoftuar nga UBT për nisjen e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e UBT, për shkak të prezumimit të tij si i fajshëm për veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, pa vendim gjykate të formës së prerë, pasi largimi i tij nga puna ka ardhur pas ankimimit në gjykatë të urdhërit të pezullimit të tij, nga ana e Rektorit të UBT.

### **FAKTET**

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune si pedagog/lektor, me detyrën personel akademik “Profesor”, pranë Departamentit të Prodhimit Shtazor të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, në UBT, që prej vitit 1989.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur procedimin penal Nr. 5005, datë 25.09.2013, në ngarkim të tij, si i dyshuar për veprën penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Në përfundim të procedimit penal, Gjykata e Apelit Tiranë, nëpërmjet vendimit Nr. 2184, datë 15.10.2018, ka vendosur: “Prishjen e vendimit Nr. 2897, datë 25.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes për të ankuesin”.

Subjekti ankues, pas shpalljes së vendimit të formës së prerë, nëpërmjet shkresës me Nr. 2591 Prot., datë 23.11.2018, i është drejtuar Rektorit të UBT-së, duke i kërkuar që të rikthehej në punë, pasi pengohej nga Urdhëri i pezullimit, (nxjerrë nga Rektori deri në përfundim të procesit gjyqësor, lidhur me procesin penal në ngarkim të ankuesit).

Ndërkaq, nëpërmjet shkresës me Nr. 2914/4, datë 19.12.2019 “Urdhër Nr. 102”, të Rektorit të UBT, ankuesi është njoftuar për nisjen e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Ankuesi ka pretenduar se është viktimizuar për shkak të ankimimit në gjykatë të urdhërit të pezullimit të tij, nga ana e Rektorit të UBT.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 44, 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolle 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së (“*Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*” (GC) paragrafi 147, “*Timishev kundër Rusisë*” (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39, “*D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*” [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178).
- “*Karta Sociale Evropiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 10, 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

## **KONKLUSIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, vlerësoi se:

Të ndodhur para situatës së prezumimit të diskriminimit nga UBT kundrejt ankuesit, si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, UBT duhet të provonte se pretendimi i ankuesit ishte i pabazuar në fakte e prova dhe se veprimet e tyre ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale, të arsyeshme dhe të justifikuara objektivisht.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e UBT nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit nuk kanë ndodhur pas ankimimit të tij në gjykatë, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuara dhe objektive.
- Përkundrazi, bazuar në shkresën me Nr. 60 Prot., datë 11.12.2019, u provua e kundërta: UBT ka marrë dënimin për Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipër cituar, me datë 10.12.2019.
- Menjëherë, pas komunikimit të këtij vendimi, UBT nëpërmjet Urdhrit Nr. 102, datë 19.12.2019<sup>52</sup>, ka filluar procedurën e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me ankuesin.

Nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektit ankues nga ana e UBT, i kanë ardhur menjëherë pas ankimimit të tij në gjykatë dhe shprehjes së kësaj të fundit me vendim. Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri krijoi dyshimin e arsyeshëm dhe vlerësoi se ankuesi, ishte ekspozuar ndaj një

<sup>52</sup> Shkresa me Nr. 2914/4 Prot., datë 19.12.2019 e UBT-së.

trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës, trajtim i cili kishte ardhur si pasojë direkte e ankimit të tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>53</sup>.

### ***VENDIMI***

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, në formën e viktimizimit, nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), për shkak të ankimimit të tij në Gjykatë.

---

<sup>53</sup> Për analogji citojmë Vendimin Nr.177, datë 16.12.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



## 51. H.H., kundër E.SH., Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve

### VENDIM NR. 105, DATË 10.09.2020

**Shkaku:** Ankimi për diskriminim tek KMD-ja  
**Forma:** Diskriminim në formën e viktimizimit  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:**

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune pranë GKA-së, që në datë 05.10.2009 në pozicionin, Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun dhe pas datës 28.04.2014 në pozicionin e punës, Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë. Pas ankimimit për diskriminim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

#### **FAKTET**

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune pranë GKA-së, që në datë 05.10.2009 në pozicionin, Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun<sup>54</sup> dhe pas datës 28.04.2014 në pozicionin e punës, Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë<sup>55</sup>.

Kjo marrëdhënie pune rezulton e formalizuar nëpërmjet disa Kontratave Individuale të Punës dhe kontrata e fundit mes palëve është me Nr. 205/3, datë 28.08.2019 e lidhur me afat një vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën Nr. 158, datë 16.12.2019 të H.H., kundër GKA-së në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e viktimizimit të ardhur për shkak të ankimimit të tij për diskriminim në gjykatë.

Referuar shkresës Nr. 92/28, datë 27.04.2020 “Memo mbi incidentin e ndodhur në datë 24.04.2020”, konstatohet se në datë 24.04.2020 punonjësja A.K., ka deklaruar se rreth orës 11.00 në mjediset e zyrës i është zhdukur telefoni celular dhe një shumë prej 2000 lekësh.

Me shkresën Nr. 205/12, datë 04.06.2020 të GKA-së, Urdhër Nr. 46, datë 04.06.2020 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, është njoftuar H.H për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me datë 28.08.2020, kur përfundon afati i kontratës individuale të punës.

Pra, për sa i takon pasojave negative në marrëdhëniet e punësimit të H.H., nga ana e punëdhënësit, rezulton e provuar se në rend kronologjik ato kanë ardhur gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionerit dhe menjëherë pas komunikimit të vendimit

<sup>54</sup> Referuar Kontratës Individuale të Punës Nr. 394, datë 05.10.2009.

<sup>55</sup> Referuar Kontratës Individuale të Punës Nr. 175, datë 28.04.2014.

sipër cituar të Komisionerit, GKA-ja ka dërguar shkresën për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me H.H.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>56</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”.
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rosisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 7, 12,13, 15, 32 dhe 33.

### **KONKLUZIONE**

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se nga ana e GKA nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit nuk kanë ndodhur pas ankimimit të tij tek Komisioneri, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuara dhe objektive.

<sup>56</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

- Ndaj ankuesit nuk duhej të ishte ndërmarrë veprimi i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ndërkohë që ankesa po shqyrtohej tek Komisioneri me pretendimin për diskriminim nga ana e drejtorit. Mosrinovimi i kontratës së punës së ankuesit ngre dyshime të arsyeshme për tendencë ndaj ankuesit, si pasojë e ankimit të tij tek Komisioneri.

Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga GKA-ja kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, GKA-ja duhet të provonte se pretendimi i ankuesit ishte i pabazuar në fakte e prova dhe se veprimet e tyre ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale, të arsyeshme dhe të justifikuara objektivisht.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, krijon dyshimin e arsyeshëm dhe vlerëson se shtetasi H.H., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e Galerisë Kombëtare të Arteve, trajtim i cili ka ardhur si pasojë e ankimit të tij pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e cila nëpërmjet Vendimit nr. 57, datë 03.06.2020 ka vendosur konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të shtetasit H.H., nga ana e Galerisë Kombëtare të Arteve (GKA), për shkak të ankimimit të tij tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## 52. I.Xh., dhe J.K., kundër Shoqërisë Bconnect sh.p.k.,

**VENDIM NR. 168, DATË 17.11.2020**

**Shkaku:** Çdo shkak tjetër/ Statusit si “*përfaqësues të punëmarrësve*”  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesit I.Xh., dhe J.K., janë larguar nga puna si pasojë e kërkesës operacionale të punëdhënësit për shkak të epidemisë Covid 19, e cila ka çuar në riorganizim dhe ulje të sasisë së punës, duke nisur nga fillimi i pandemisë, në muajin mars, të vitit 2020. Pavarësisht se zgjidhja e kontratës së punës për shkak të kërkesave operacionale të shoqërisë përbën një shkak të ligjshëm, rezultoi se procedurat e ndjekura nga shoqëria për përzgjedhjen e punonjësve të cilët nuk do të vazhdonin punën nuk ishin të mirëpërcaktuara dhe transparente.

### **FAKTET**

Ankuesi I.Xh., ka filluar punë pranë shoqërisë BConnect sh.p.k., në datën 05.12.2016 bazuar në kontratën me afat të pacaktuar. Marrëdhënia e punës ka zgjatur deri në datën 27.06.2020. Në lidhje me arsyen e zgjidhjes së kontratës, shoqëria BConnect sh.p.k., deklaroi se: *“Arsyeja e zgjidhjes së kësaj kontrate është e ndikuar dhe për pasojë të kërkesës operacionale të punëdhënësit për shkak të epidemisë Covid 19 dhe që kanë çuar në riorganizim dhe ulje të sasisë së punës në Shoqërinë BConnect sh.p.k., duke nisur nga muaji mars i këtij viti”*.

Ankuesi J.K., ka filluar punë pranë shoqërisë BConnect sh.p.k., në datën 23.11.2015 dhe marrëdhënia e punës ka zgjatur deri në datën 30.05.2020. Fakt ky që rezulton i provuar nga librezat e punës. Marrëdhënia e punës midis ankuesit dhe shoqërisë Bconnect sh.p.k., për sa i përket kohëzgjatjes, është lidhur për një afat kohor të pacaktuar. Në lidhje me arsyen e zgjidhjes së kontratës, shoqëria BConnect sh.p.k., deklaroi se: *“Arsyeja e zgjidhjes së kësaj kontrate është e ndikuar dhe për pasojë të kërkesës operacionale të punëdhënësit për shkak të epidemisë Covid 19 dhe që kanë çuar në riorganizim dhe ulje të sasisë së punës në Shoqërinë BConnect sh.p.k., duke nisur nga muaji mars i këtij viti”*.

Të dy ankuesit kundërshtojnë arsyen e largimit nga puna, e cila rezulton të jetë e njëjtë për të dy ankuesit, duke pretenduar se zgjidhja e kontratës së punës ka si shkak pjesëmarrjen e tyre në krijimin e sindikatës së punonjësve pranë Shoqërisë BConnect sh.p.k., dhe jo kërkesat operacionale dhe nevojën për reduktimin e punonjësve, sikundër pretendohet nga punëdhënësi.

Nga aktet e administruara rezultoi se ankuesit së bashku me punonjës tjerë të shoqërisë ishin në procedura për themelimin dhe regjistrimin e një organizimi sindikal, por procedurat e regjistrimit ishin ende në proces.

Punonjësit e shoqërisë për shkak të mosmarrëveshjeve me shoqërinë, në lidhje me respektimin nga ana e kësaj të fundit të të drejtave të punës, kryesisht në lidhje me pagesën e orëve shtesë dhe pagesën në ditën e festave zyrtare. Për zgjidhjen e këtyre problematikave punonjësit kishin paraqitur ankesa pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Sigurimeve Shoqërore (ISHPSSH). Ankuesit I.Xh., dhe J.K., ishin ndër punonjësit që kishin mbajtur korrespondencën me SHPSSH. Në datën 17.01.2020, ankuesit kanë marrë në takimin tre palësh të realizuar midis përfaqësuesve të ISHPSSH, përfaqësuesve të shoqërisë Bconnect sh.p.k., dhe përfaqësuesve të punonjësve të shoqërisë, të realizuar me qëllim zgjidhjen e problematikave të punonjësve.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollit 12 i saj.
- Raste të GJEDNJ-së: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, Sidabras dhe Džiautas kundër Lituaniës
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ratifikuar me ligjin Nr. 7511 datë 08.08.1991, neni 2/2 dhe 6,
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996
- Konventa e Përfundimit të Punësimit, Nr. 158, viti 1982, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,
- Konventa e Përfaqësuesve të Punëtorëve Nr. 135, viti 1971, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 82
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9, 10, 184, 186.

### **KONKLUSIONE**

Rezultoi se, Shoqëria BConnect sh.p.k., nuk kishte zbatuar kritere të mirëpërcaktuara dhe transparente në përzgjedhjen e punonjësve me të cilët do të ndërpriteshin marrëdhëniet e punës për shkak të kërkesave operacionale në kushtet e uljes së sasisë së punës në situatën e shkaktuar nga Covid 19. Mungesa e kritereve të përcaktuara dhe transparente nuk mundëson

vlerësimin e procedurës së ndjekur nga punëdhënësi në përzgjedhjen e punonjësve të cilët do të largohen. Komisioneri arriti në përfundimin se, Shoqëria BConnect sh.p.k., e cila kishte barrën e provës, nuk arriti të provonte se arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me ankuesit I.Xh., dhe J.K., kishte si shkak kërkesat operationale të ndërmarrjes.

Komisioneri, vlerëson se, organizimi i punonjësve dhe materializimi i vullnetit të tyre, siç është hartimi i akteve themeluese dhe procedurat e ndjekura përpara Gjykatës, janë veprime konkrete paraprake që tregojnë për pjesëmarrjen e ankuesve në krijimin e sindikatës. Veprimet paraprake për krijimin e sindikatës janë elementë që tregojnë bashkimin e punonjësve në një organizatë sindikale. Këto veprime i paraprijnë krijimit të sindikatës sipas parashikimeve ligjore. Në kuadër të garancive ligjore që ligji ofron për lirinë sindikale, momenti i krijimit të saj gëzon mbrojtje të veçantë. Pavarësisht mosfitimit të personalitetit juridik të sindikatës nëpërmjet regjistrimit të saj me vendim gjykate, Komisioneri vlerëson se, pjesmarrja e ankuesve si anëtarë themelues dhe veprimet paraprake për krijimin e sindikatës, duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi. Do të ishte në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji, nëse veprimtaria paraprake për krijimin e sindikatës nuk do të mbrohej pasi do të cënonte vet thelbin e mbrojtjes ligjore që i bëhet lirisë sindikale.

Por, gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua asnjë provë që të tregonte se Shoqëria BConnect sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit kishte dijëni, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, për angazhimin e ankuesve në krijimin e sindikatës. Jo detyrimisht punëdhënësi ka dijëni për çdo veprimtari apo organizim të punonjësve, për më tepër kur aktivitetet apo takimet e punonjësve zhvillohen jashtë ambienteve të punës. Në ankesën në shqyrtim nuk rezultoi që ndonjë prej takimeve që mund të jenë mbajtur ndërmjet anëtarëve themelues të jetë zhvilluar në ambientet e punës. Për rrjedhojë nuk mund të prezumohet se punëdhënësi duhet domosdoshmërisht të ketë dijëni për organizimin e punonjësve për të krijuar sindikatën. Komisioneri, arriti në përfundimin se pretendimi për diskriminim i ankuesve për shkak të pjesmarrjes në organizim sindikal, nuk ishte i bazuar.

Komisioneri çmoi të marrë në konsideratë dhe të analizojë veçmas nga pjesmarrja në organizim sindikal, pretendimin e ankuesve se ata kanë vepruar si përfaqësues të punëmarrësve. Në këtë përfundim Komisioneri arriti, në mënyrë të veçantë, duke mbajtur në konsideratë faktin se, pranë kësaj shoqërie nuk funksionon asnjë organizim sindikal për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punonjësve. Komisioneri vlerësoi se përfaqësuesit e punëmarrësve, pavarësisht se nuk veprojnë në kuadër të një organizimi sindikal duket të gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi, në mënyrë të veçantë në kushtet kur pranë subjektit punëdhënës mungon organizimi sindikal. Komisioneri vlerësoi të provuar pretendimin e ankuesve se kanë vepruar si “përfaqësues të punonjësve” dhe se diferencat në trajtim bazuar në statusin e personit si “përfaqësues i punëmarrësve” duhet të gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi. Rezultoi e provuar se ankuesit kanë vepruar si “përfaqësues të punëmarrësve” dhe se shoqëria BConnect sh.p.k., ka patur dijëni për këtë status të tyre.

Komisioneri theksoi se, fakti që nuk janë larguar nga puna të gjithë punonjësit që kanë marrë pjesë në takimin e datës 17.01.2020 në cilësinë e përfaqësuesve të punëmarrësve të shoqërisë BConnect sh.p.k., nuk është një fakt që hedh poshtë pretendimin e diskriminimit. Largimi i disa prej përfaqësuesve të punëmarrësve, si në rastin konkret i ankuesve, të cilët rezultojnë që të kenë qenë aktivë në mbrojtje të të drejtave të punonjësve edhe përpara këtij takimi duke u ekspozuar personalisht, mund të jetë mjaftueshëm frikësuese për punonjësit e tjerë të cilët mund të perceptojnë se, duke u organizuar apo duke përfaqësuar dhe dalë në mbrojtje të interesave të punëmarrësve, mund të rrezikojnë të humbasin vendin e tyre të punës. Largimi qoftë edhe i disa prej punëmarrësve që janë ekspozuar si përfaqësues të punonjësve, mjafton për të demotivuar punëmarrit për t'u organizuar në mbrojtje të të drejtave të tyre të punës.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se zgjidhja e kontratave të tyre të punës ishte kryer për shkak të faktit se, ankuesit kishin vepruar si “përfaqësues të punëmarrësve”. Në këto kushte shoqëria BConnect sh.p.k., e cila kishte barrën e provës, dështoi që të provonte se kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm për veprimet e shoqërisë BConnect sh.p.k., i vetmi shpjegim për zgjidhjen e kontratave respektive të punës për ankuesit I.Xh., dhe J.K., mbetet shkak i diskriminimit dhe përfundimisht Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesit I.Xh., dhe J.K., ishin diskriminuar në të drejtën e tyre për punësim.

### ***VENDIMI***

Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesve I.Xh., dhe J.K., në të drejtën për punësim, për shkak të *pjesëmarrjes në organizim sindikal*, nga ana e Shoqërisë BConnect sh.p.k.

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit I.Xh., dhe ankuesit J.K., në të drejtën për punësim, për shkak të *statusit të tyre si “përfaqësues të punëmarrësve”*, nga ana e Shoqërisë BConnect sh.p.k.

**53. M.Gj., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel (I.E.V.P Burrel)**

**VENDIM NR. 157, DATË 03.11.2020**

**Shkaku:** Çdo shkak tjetër/ Statusi si punonjës në periudhë prove  
**Forma:** Diskriminim i drejtpërdrejtë  
**Fusha:** Punësim  
**Statusi:** Në gjykatë

Ankuesit me detyrë “Punonjës i rolit bazë në policinë e burgjeve”, në periudhë prove, i zgjidhet kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme, për shkak se u konsiderua i papërshtatshëm për të punuar në policinë e burgjeve, bazuar në vërtetimin e besueshmërisë të lëshuar nga autoriteti vendor i policisë së shtetit, pa i’u dhënë mundësia për t’u kundërshtuar.

***FAKTET***

Ankuesi M.Gj., ka qenë në marrëdhënie pune pranë I.E.V.P Burrel në pozicionin “Punonjës i rolit bazë”. Ankuesi është emëruar në këtë detyrë në datë 20.12.2018, me urdhër të të Drejtorit të Përgjithshëm, të DPB. Bazuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPB, ka dalë urdhri datë 20.12.2018 i Drejtorit të IEVP Burrel për emërimin e ankuesit në pozicionin punonjës i rolit bazë në regjimin e jashtëm, pranë IEVP Burrel. Në të njëjtën ditë është lidhur kontrata individuale e punës midis ankuesit dhe IEVP Burrel.

Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe IEVP Burrel kanë vijuar normalisht dhe pa ndërprerje deri në datën 21.08.2019. Gjatë kohës që kanë zgjatur marrëdhëniet e punës ndaj ankuesit nuk ishte marrë ndonjë masë disiplinore dhe se punëdhënësi nuk kishte ndonjë pakënaqësi në lidhje me punën e kryer nga ankuesi. Në datën 19.08.2019, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, të DPB është urdhëruar largimi i ankuesit nga detyra e punonjësit të rolit bazë pranë IEVP Burrel me motivacionin “*i papërshtatshëm për të punuar në Policinë e Burgjeve*”. Në datë 21.08.2019, drejtori i IEVP Burrel ka nxjerrë urdhrin për largimin nga detyra të ankuesit me motivacionin që referohet në urdhrin e largimit të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i DPB. Ankuesi nuk ka patur asnjë njoftim paraprak në lidhje me procedurat e zgjidhjes së kontratës deri në njoftimin për urdhrin e largimit nga detyra të drejtorit të IEVP.

Rezultoi e provuar se shkak për largimin nga puna të ankuesit ishte një informacion konfidencial i Komisarariatit të Policisë Mat dërguar IEVP Burrel, datë 22.05.2019, sipas të cilit ankuesi ishte i evidentuar nga seksioni i krimeve si person me precedentë kriminal për tendencë vjedhje transformatorësh dhe ishte aktiv. Në këtë akt Komisarati i Policisë shprehej se, për rrjedhojë ankuesi e gëzonte të plotë besueshmërinë, pasi kishte pengesa ligjore dhe nuk është i përshtatshëm për të punuar në IEVP Burrel. Ky informacion ishte përgatitur në bazë të kërkesës që IEVP Burrel i kishte dërguar Komisarariatit të Policisë në datë 09.01.2019.



Ky dokument nuk përmbante asnjë bazë ligjore lidhur me procedurat dhe mënyrën hartimin e tij dhe të drejtën e ankimit të personit që çënohej nga ky akt. I EVP Burrel ia ka përcjell këtë informacion DPB në datë 13.08.2019.

Ankuesi pretendoi se ishte diskriminuar për shkak se ishte konsideruar si person i dyshuar në një ngjarje penale/kriminale”.

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- *Raste të GJEDNJ-së: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë;*
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ratifikuar me Ligjin Nr. 7511 datë 08.08.1991, neni 2/2 dhe 6;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996 dhe Rekomandimi Nr. 111 *Diskriminimi (Punësim dhe profesion);*
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3, 7, 12, 33.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 82;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9;
- Ligji Nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, 17;
- Rregullore “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhëniet e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve”, miratuar me urdhrin Nr. 3125/1, datë 04.09.2009, të Ministrit të Drejtësisë, neni 13.

### **KONKLUSIONE**

Komisioneri vlerësoi se, pavarësisht se ankuesi ishte në periudhë prove ai duhet të gëzojë të njëjtat të drejta sikundër punonjësit e tjerë të rolit bazë që e kanë kaluar periudhën e provës të policisë së burgjeve, në lidhje me momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës. Periudha e provës për punonjësit e policisë së burgjeve nuk ka të bëjë me vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit por me aftësinë e tij për të kryer detyrën. Në rastet kur punonjësi i policisë së burgjeve konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar detyrën për shkak se dyshohet për përfshirjen e tij në aktivitet kriminal, nuk duhet të bëhen diferenca në trajtim që bazohen në faktin nëse punonjësi ka kaluar apo jo periudhën e provës.

Ligji Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij nuk kanë parashikime në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në situatën kur konstatohet papërshtatshmëria e punonjësit të policisë së burgjeve për shkak se është cënuar besueshmëria si pasojë e një akti administrativ, siç edhe është vërtetimi i personalitetit i hartuar nga Komisariati i Policisë Mat.

Ndryshe nga punonjësit në periudhë prove besueshmëria e të cilëve për të kryer detyrën është cënuar, për punonjësit e tjerë të policisë së burgjeve të cilët e kanë kaluar periudhën e provës, në rast se besueshmëria e tyre çënohet si rezultat i fillimit të ndonjë procedimi penal në ngarkim të tyre, ata nuk largohen nga puna por pezullohen deri në përfundim të procesit. Pra ankuesi punonjës i policisë së burgjeve në periudhë prove rezulton të jetë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme duke mos iu dhënë mundësia të mbrohet dhe duke u larguar në mënyrë të menjëhershme nga puna, ndërsa punonjësit e tjerë të policisë së burgjeve të cilët e kanë kaluar periudhën e provës nuk largohen në mënyrë të menjëhershme nga puna. Ankuesi nuk ka patur mundësi që të mbrohet në lidhje me dyshimet e ngritura për përfshirjen e tij në aktivitet kriminal, për sa kohë që ai është larguar në mënyrë të menjëhershme dhe pa patur mundësi që të kundërshtojë vërtetimin e personalitetit, para se marrëdhëniet e punës të ndërpriteshin. Ndërsa kategorisë tjetër të punonjësve të policisë së burgjeve duke u pezulluar nga detyra, i’u jepet mundësia që të mbrojnë interesat e tyre dhe ata largohen vetëm në rast se dënohen me vendim penal të formës së prerë.

Komisioneri konsideroi se, për sa i përket vlerësimit të besueshmërisë dhe përshtatshmërisë për të ushtruar detyrën si punonjësi i policisë së burgjeve, nuk ka asnjë dallim për t’u bërë midis të punonjësve që janë në periudhë prove besueshmëria e të cilëve vihet në diskutim dhe punonjësve besueshmëria e të cilëve vihet në diskutim për shkak të fillimit të procedimit penal, të cilët e kanë kaluar periudhën e provës. Në këtë kontekst, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesi ndodhej në pozita të ngjashme me punonjësit e policisë së burgjeve të cilët e kanë kaluar periudhën e provës besueshmëria e të cilëve vihet në diskutim për shkak se ndaj tyre ka filluar procedim penal.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstatoi se, kufizimi i vendosur në nenin 13, të Rregullores nr. 3125/1, datë 04.09.2009, të Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me verifikimin e përshtatshmërisë dhe marrjen e vërtetimit të personalitetit nga strukturat përkatëse të policisë, është në tejkallim të parashikimeve që behen nga neni 17, i Ligjit Nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, i cili vendos si kriter vetëm kushtin që kandidati për punonjës të policisë së burgjeve nuk duhet të jetë i dënuar penalisht me vendim gjykatë të formës së prerë. Në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk vendoset kufizimi për të marrë vërtetime personaliteti nga ana e strukturave të policisë, sikundër vendoset në Rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 3125/1, datë 04.09.2009.

Komisioneri konstatoi se, kur ndaj punonjësit të policisë së burgjeve ka filluar procedimi penal, jemi në kushtet kur besueshmëria e tij është çënuar pasi ai dyshohet për përfshirje në veprimtari kriminale. Në logjikën e DPB dhe I EVP Burrel të ndjekur në rastin e ankuesit, punonjësi duhet të largohet në mënyrë të menjëhershme nga puna si i papërshtatshëm për të punuar në policinë e burgjeve. Por në fakt punonjësi ndaj të cilit ka filluar procedim penal nuk largohet, por pezullohet deri në përfundim të procesit penal. Kur ndaj një personi fillon procedimi penal në ngrakim të tij, do të thotë se faktet e provat e administruara janë të atij niveli që krijojnë dyshime shumë herë për të larta për përfshirjen e personit të aktivitete kriminale, se sa në rastin kur dyshimet bazohen vetëm në vërtetimin e personalitetit të hartuar nga strukturat e policisë. Vërtetimi i personalitetit mbi bazën e të cilit është konsideruar si i papërshtatshëm për të kryer detyrën ankuesi është një akt administrativ, për të cilin ankuesi duhet të ishte njoftuar paraprakisht dhe t'i ishte dhënë mundësia që t'a kundërshtonte dhe jo të largohej në mënyrë të menjëhershme.

Komisioneri nuk arriti të identifikojë se cili është qëllimi legjitim për trajtimin e diferencuar të ankuesit i cili ishte në periudhë prove në kushtet e cënimit të besueshmërisë për shkak të dyshimeve për përfshirje në aktivitet priminal, duke patur parasysh se në rastin e fillimit të procedimit penal dyshimet janë të një niveli më të lartë. Edhe pse dyshimet janë të një niveli më të lartë në rastet e fillimit të procedimit penal, punonjësit që e kanë kaluar periudhën e provës dhe ndaj tyre fillon procedim penal, ata prezumohen të pafajshëm dhe nuk largohen, por pezullohen, ndërsa ankuesi në kushtet e një niveli dyshimi më të ulët konsiderohet i përfshirë në aktivitet kriminal dhe i papërshtatshëm për të ushtruar detyrën, duke mos gëzuar mbrojtjen e garantuar nga prezumimi i pafajsisë. I EVP Burrel e cila për pothuajse 3 muaj ka lejuar ankuesin të vazhdojë punën, por pa i dhënë atij asnjë mundësi për të marrë dijeni në lidhje me aktin që çënon interesat e tij të punës dhe të kishte mundësi që ta kundërshtonte atë.

Komisioneri arriti në përfundimin se, trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankuesit nuk kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe se ankuesi ishte diskriminuar bazuar në faktin se ai është një punonjës i rolit bazë në policinë e burgjeve besueshmëria e të cilit është çënuar gjatë periudhës së periudhës prove, duke i'u çënuar e drejta për të gëzuar mbi baza të barabarta me punonjësit e tjerë që e kanë kaluar periudhën e provës, të drejtën për punë.

Drejtori i I EVP Burrel nuk ka të drejtë vendimarrje për largimin nga puna të ankuesit si punonjës i rolit bazë në policinë e burgjeve, por është vetëm në rolin e propozuesit. Komisioneri vlerësoi se autoriteti përgjegjës për largimin nga detyra të ankuesit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila për rrjedhojë është përgjegjëse për diskriminimin e ankuesit.

## **VENDIMI**

Konstatimin e diskriminimit të ankuesit M.Gj., në të drejtën për punësim, për shkak të statusit të tij si punonjës i rolit bazë në policinë e burgjeve në periudhë prove, nga ana e Drejtorisë së



Përgjithshme të Burgjeve.

Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin M.Gj., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit M.Gj., nga ana e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel.